

BLIOTEKA
SHTEIT

H-32

198

ORRITTE



NOVELE

EVQET MUSARAJ


854-32

14198

SHEFQET MUSARAJ

D R I T Ë ...

(Novelë)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DRITË...

PROLOG

Po i hyj një valleje që s'e kam hequr ndonjëherë. Dua të qëndis një libër me historira nga fshati im. Vetëm se druaj mos më japin ndonjë kopaçe nga ato që të futin në dhé, në vend të luleve që u jepen disave. Se — t'jua them hapët, — unë, emrin vërtet e kam Kalem, po kalemi s'më vjen fare përdorësh. Jam një anëtar i kooperativës së bashkuar «Burimi», 50 e ca vjeç burrë, me emrin Kalem Asllani, me shtatë klasë shkollë fillore dhe me zanat fruktulturën, që e kam fituar me praktikë. M'u shkrep t'i hyja kësaj valleje vetëm e vetëm se kam vënë re që njerëzit, në të katër anët, shkruajnë për kooperativat e tyre, për minierat e fabrikat, për jetën në ushtri ose në aksione e bile edhe për dashuritë midis të rejave e të rinjve që s'para përmendeshin gjer disa kohë më parë, kurse për fshatin tim, që ka edhe ai një histori të tërë me të mirat dhe të metat e tij, s'është kujtuar njeri të shkruajë. Në këtë pikë bashkohem me kryetarin tonë, shokun Faslli, që thotë se kjo është një padrejtësi që duhet raportuar lart. Dhe tani... urdhroni e dëgjoni...

DRITË NË ZONAT E THELLA...

Kapitulli I

Fshati im, Krekëza, ka histori të vjetër, por kjo që do t'ju tregoj nis aty nga mesi i vitit 1965. Gjer atë vit në asnjë nga fshatrat malore që përbëjnë tani kooperativën e bashkuar «Burimi», s'kishte dritë elektrike. Gazetat e revistat shkruanin dendur për të mirat e elektrikut dhe për iniciativat e shumë fshatrave të Republikës që ndërtonin me forcat e tyre hidrocentrale të vogla dhe bëheshin me dritë, por ne, fshatarëve të Krekëzës, që fshim atëhere kooperativë më vete, nuk na bëhej vonë. Kaq është e vërtetë kjo sa, edhe një herë që na e ngriti këtë çështje një instruktor i komitetit të partisë të rrethit në një mbledhje të madhe që patëm për problemet e një jete më të mirë në fshat, asnjëri nga ne nuk i dha rëndësi fjalës së tij. Pse? Se nuk na mbushej mendja t'ia dilnim vetë në krye një pune të tillë.

Instruktori e kuptoi këtë nga bisedimet tona dhe me zgjuarësi të madhe, kur mori edhe një herë fjalën aty nga fundi, na e përmendi përsëri pu-

nën e elektrikut. Këtë radhë ai e lidhi çështjen me ato fjalët që ka thënë Lenini që elektrifikimi dhe pushteti sovjetik bëjnë komunizmin dhe na e shpjegoi mirë se si elektriku do të na ndihmonte pa masë edhe në përpjekjet që u zotua të bënim për të ndryshuar jetën tonë. Ai shtoi më në fund me qëllim që të na bindte se fshati ynë e kishte më lehtë nga çdo fshat tjetër punën e hidrocentralit për arësye të një përroi që na shkon pothuaj në prak të derës dhe që ne s'ia dinim vlerën.

Po, të themi të drejtën, edhe pas gjithë atij shpjegimi, nuk vramë shumë mendjen. Bile, për të mbyllur muhabetin, — se mbledhja zgjati nja katër orë të mëra dhe shumë nga shokët e shoqet kishin lënë kush ujët në arë e kush të prashiturat përgjysmë — kryetari i kooperativës, Faslli Guri, që drejtonte mbledhjen, premtoi se do t'ia shtronte çështjen kryesisë dhe se do të dilte me një farë propozimi për asamblenë.

Mbledhja mori fund me kaq.

Pas asaj mbledhjeje shumica e kooperativistëve filluan të interesoheshin më shumë për një jetë më të kulturuar siç ishte, fjala vjen, ajo e të fjeturit në shtrat e jo për tokë, e të ngrënit nëpër pjata veç e veç dhe jo në një sahan të gjithë bashkë e të tjera e të tjera, po, përsa i takonte sjelljes së elektrikut në fshat, nuk e kujtua më njeri. Vetë kryetari, ca kohë më pas, kur përgjegjësi i rinisë, Gëzim Pronjoja, i përmendi zotimin që pat marrë përpara instruktorit se do ta shtronte çështjen në kryesi, ia ktheu si pa të keq:

— Lërna, more djalë, mos na hap punë. Fshatra malësie jemi ne. Nuk jemi keq hëpërhë edhe

me këto drita që kemi. Po ti nuk e ke njohur, more bir, tymin e pishës e të kandilit që na ka nxjerrë sytë ne, pleqve. Ke parë dritat e qytetit dhe kërkon të bëhet që sivjet edhe këtu si atje. S'të mjaftojnë këto llambat me pasqyrë e me qelqe, që janë lule ndanë çirakut e pishës?

Përgjegjësi i rinisë, sado i gjykuar e me mend që është, u nxeh shumë dhe iu kthye kryetarit me një breshër fjalësh që e mbërthyen në vend. I kujtoi radion që do të na lidhte orë e çast me Tiranën; i kujtoi punishten e frutave që do të ngrihej menjëherë porsa të na vinte drita dhe do të ngopte kooperativën me të ardhura nga fiqtë e rrushtë që na shkojnë dëm; i kujtoi makinën e miellit, për të cilën kemi shumë nevojë dhe sharrat që do të na mbushnin me lëndë ndërtimi nga pyjet matanë lumit; ia kujtoi të gjitha, po kryetari as që e prishi gjakun. Pranoi të gjitha kritikën që i bëri përgjegjësi i rinisë dhe e mbylli çështjen me një premtim tjetër si atë që i pat dhënë instruktorit të partisë. Kështu, puna e dritës elektrike mbeti kur t'i vinte ndonjëherë koha.

E keqja që se edhe ne, pleqtë e tjerë të fshatit, që jemi pak a shumë në një moshë me kryetarin, nuk morëm anën e djalit, megjithëse e kuptonim që mendimet e tij ishin me vend. Këtë nuk e bëmë për gjë tjetër, por vetëm e vetëm se nuk donim që t'i binte rëndësia kryetarit përpara një të riu njëzetvjeçar siç ishte, fundi i fundit, Gëzim Pronjoja...

I vetmi që mori anën e tij ishte Riza Hodoja, sekretari i organizatës së partisë, afër dyzet vjeç burrë, që ne e hinqim si të radhës sonë, se ishte i pjekur e i matur në çdo punë. Po edhe Rizai, sado

që ishte në një mendje me djaln, s'e la këtë pa e kritikuar për sjelljen e tij të rrëmbyer. «Kritika e Gëzimit është me vend, tha, po duhet të ketë taktin e saj edhe ajo».

Ç'është e vërteta, Gëzimin e çmojmë dhe e nderojmë të gjithë si një ndër djemtë më të zgjuar e më të dashur të fshatit tonë. Dashuri të veçantë për të ka sidomos rinia, që nuk e ka zgjedhur kot përgjegjës të saj. Ai s'ka hequr vetë në kurriz vuajtjet e mundimet që ka hequr në të kaluarën familja e tij, se lindi e u rrit në këto kohëra, kur njerëzit s'e kanë vrarë mendjen për krodhën e bukës e reckën e kurrizit. Po prapë, nuk është nga ata të rinj, që s'duan të dinë për urinë dhe mjerimin që kemi njohur ne, brezi i së kaluarës. Përkundrazi ai ushqen urrejtje të madhe për atë të kaluar, ua kujton gjithnjë të rinjve në fjali-
met e tij dhe lufton me mish e me shpirt që ajo e kaluar të mos kthehet kurrë. Edhe pse bëri shkollë të mesme, atë që bënë vetëm djemtë e agallarëve njëherë e një kohë, prapë nuk iu rrit mendja të kërkonte punë zyre në qytet siç bëri një takëm, po erdhi e u ngul këtu dhe i vuri gjoksin punës bashkë me ne si kooperativist i thjeshtë. Për të gjitha këto Gëzimin e çmojmë dhe e nderojmë shumë edhe ne, të shkuarit nga mosha. Po ja që edhe ai ka të metat e tij. Merr zjarr shpejt dhe, për gabimin më të vogël që mund të bësh, të nxjerr bojën pa pyetur fare se cili je, i ri, plak, i luftës, apo ballist. Veçanërisht atë vit që u ngrit çështja e elektrikut, na e pat prishur shumë qejfin me qëndrimin e tij kundrejt Fasllit. Faslliu, s'do mend, kishte shumë kusure, po edhe t'i rrije me çekan në kokë siç i rrinte Gëzimi e t'ia bëje jetën skëterrë duke

ia hedhur dita-ditës në sy këto kusure, nuk kishte hije.

— Kritikë! Kritikë! — bërtiste Gëzim Pronjoja. — Pa kritikë nuk ndreqen gabimet.

— Kritikë, more djalë, kritikë. S'të thotë njeri të mos kritikosh. Po edhe kritika e ka një farë kufiri. Jo kështu fare, si vepron ti, që po e bën të ziun Faslli të lozë nga mendja.

Po ec ta zije në fjalë Gëzim Pronjon. Në majë të gjuhës ta kishte përgjegjen për çdo gjë, dhe jo përgjegje dosido, po nga ato që të mbërthejnë në vend, se bazohen në dokumentat e Partisë dhe në fjalimet e shokut Enver, që Gëzimi i di përmendsh. Kaq i zhdërvjellët është i uruari, sa edhe Riza Hodoja, që ka bërë një vit shkollë partie dhe është rrahur me vaj e me uthull dhjetë vjet me radhë në këto punë si sekretar organizate, nuk e ka lehtë kur hahet në fjalë me të. Sidoqoftë, me shokun Riza, Gëzimi pajtohet më shumë se me ne, jo se ka ndonjë urrejtje për pleqtë, (këtë s'e thotë dot njeri) po se në mendimet tona gjen gjithnjë nga një kleçkë ku mund të kapet.

Kështu edhe me kryetar Faslliun. Kleçka më e madhe që i gjeti kryetarit Gëzimi ishte ajo e dritës elektrike. Të paktën kështu dihej në fshat. Kurse disa nga ne të brendshmit (si unë, Alush Bocëngu, që është plaku më i mençur e më i nderuar i fshatit, shoqja Mjaftime si kryetare e gruas, Rizai e Kanani, i pari si sekretar i organizatës dhe i dyti si kryetar i këshillit) dinim që Gëzimi nuk e kishte hallin vetëm tek ajo sorollatja që i bënte kryetar Faslliu çështjes së dritës elektrike, po edhe te një «kleçkë» tjetër, të cilën ai, për shumë arsye, s'kishte guxuar t'ia përmendte kryetarit në sy të

popullit. «Kleçkë» të kryetarit Gëzimi quante fejesën e vajzës së Fasllit dhjetë vjet të shkuar me një djalë nga fshati fqinj, Xhevahir Ramizin. Për ne, pleqtë, dhe për shumicën e fshatit, kjo nuk ishte kleçkë, por një fejesë me vend dhe e gjykuar mirë. Faslli Guri, bile, si vajzë të vetme që e kishte Festimen, kish bërë edhe dasmën e fejesës, ku pat ftuar më shumë se gjysmën e fshatit dhe në dasmë s'pati njeri të thoshte çerek fjalë kundër kësaj fejesë. Po Gëzimi ishte i vogël atëhere — i binte maces me lugë, si-i thonë fjalës — dhe nuk i di të gjitha këto.

Festimja vërtet është vajzë me cilësi të rralla, po edhe djali që i ka zgjedhur i ati për bashkëshort nuk ka të sharë. Lëre pastaj të atin e djalit, Nexhip Ramizin, nikoqir i mirë, i luftës dje dhe i punës sot, i lidhur si mishi me thoin me pushtetin. Ç'kërkon më shumë Gëzim Pronjoja? Kërkon që fejesa të ishte bërë drejtpërdrejt midis vajzës e djalit dhe jo me ndërmjetësinë e prindërve. Dhe, duke qenë se vajza s'kishte mbushur atëhere as njëmbëdhjetë vjeç dhe s'ishte në gjendje të gjykonte, Faslli duhej të priste sa të rritej vajza dhe jo të bënte «mbroçkullën» që kishte bërë.

Me një fjalë, Gëzimi kërkon që njerëzit, edhe dhjetë ose njëzet vjet të shkuar, të vepronin ashtu siç e kërkon koha sot, kur kanë ndryshuar edhe zakonet, edhe mendja e njerëzve. E ku ta dinte i gjori Faslli, ku ta dinim të gjithë ne, se koha do të sillte kaq shpejt ndryshime që as na shkonin në mendje?

«Nuk e pengon gjë kryetarin që ta ndreqë këtë gabim, mendon Gëzim Pronjoja. Të prishë fejesën dhe ta lërë vajzën ta gjejë vetë fatin e saj».

Po si mund ta bëjë Faslli Guri një punë të tillë? Janë dhjetë vjet këta që ai hyn e del në shtëpinë e krushkut si në shtëpinë e tij, ashtu sikundër hyn e del edhe krushku në shtëpinë e Faslliut. Krushku, bile, aq në kimet e ka Faslliun sa, kur është rasti për të bërë bé, nuk bën bé për kokë të djalit, po për kokë të Faslliut. Ec tani të vërë mendjen e Gëzim Pronjos Faslliu, e t'i thotë krushkut: «Më fal, o mik, po unë s'ta jap dot çupën që kam fejuar me tët bir. Prandaj, këtej e tutje, krushqia jonë është e prishur dhe secili të shikojë punën e tij».

Unë, për vete time, ja ku po jua them copë, s'do kisha s'uxim as t'i dëlja në sy krushkut, e jo më t'ia jepja me gojën time këtë mandatë. E marr me mend se si do ta priste Nexhip Ramizi një mandatë të tillë. Edhe dyfekun, siç bëhej njëherë e një kohë në këto raste, mund të rrëmbente për të larë turpin. Jo për të vrrarë Faslliun, se kjo do ta ngarkonte me një turp edhe më të madh për kohën e sotme, po për të vrrarë veten që të mos i dëgjonin veshët thashethemet e qesënditë e botës.

Dhe kishte ca arësye, sipas mendjes sime, që të vepronte kështu. Dhjetë vjet me radhë kishte punuar ai për këtë krushqi. Sado që i shkuar në moshë dhe me djalë e grua në gjendje që i siguronin familjes mbi 300 ditë pune secili në kooperativë, nuk i prapsej punës në vapën e korrikut e të gushtit, as në llohët e borërat e dimrit. «Mjaft, de, se u këpute! Ç'është kështu me ty?» mendohej ta ndalonte e shoqja, që ishte nja 15 vjet më e re. Po ishte e kotë të hyje në këtë muhabet me Nexhipin. «Jo, jo, përgjegjej e qeshte nën buzë. Të

futim një herë brenda atë thëllëzën e Faslliut, pas-taj shohim e bëjmë».

Sigurisht që Nexhipi, si njeri i luftës dhe i nderuar nga pushteti, e bënte këtë edhe për t'u dhënë shembull të tjerëve se si duhet punuar në kooperativë dhe për këtë kushedi sa herë i kishte dalë emri e fotografia në tabelën e nderit, po ma merr mendja që në këtë zell e përpjekje të tij hynte edhe gëzimi i nuses që do të sillte në shtëpi.

«Kot e ke, e ngacmonte e shoqja me shaka. Nuset e sotme, sado të mira e të sjellshme që të jenë, nuk ia bëjnë dot vjehrrit e vjehrrës ato shërbime që ëndërron ti.»

Nexhipi i vërsulej tërë inat: «Nuk jam i prapambetur unë që të mendoj ashtu si thua ti. S'kam nevojë për shërbim, as për ndihmë ekonomike nga nusja e djalit. Kam nevojë për dritë e për gëzim. Dhe drita e gëzimi do të ma mbushin shtëpinë kur të më hyjë ajo në derë».

* * *

Kishin kaluar nja dhjetë muaj nga ajo grindja e parë e Faslliut me Gëzim Pronjon për punën e dritës elektrike. Nexhipi me Faslliun tani, pa fjalë e pa bujë, kishin prerë edhe ditën e martesës. E kishin lënë për prillin e ardhshëm. Papo gjithë kohën që e ndante nga dita e atij gëzimi të madh, Nexhip Ramizi e bëri edhe natën ditë. Ky ishte viti i njëzetepesëvjetorit të Partisë dhe s'do mend që puna dyfish e Nexhipit u quajt si punë e jashtzakonshme për nder të jubileut. Ai e kishte edhe

këtë qëllim, sigurisht, por ja që bashkë me punën e tij e të familjes në kooperativë, nuk la mënjanë punën private. Natën me fenerë, i ndihmuar edhe nga një brigadë muratorësh e tavanxhish që i dha kryesia e kooperativës, ngriti shtëpi të re me plan si ato të qytetit, solli nga qyteti karrige, krevate e dollapë me pasqyra, shtroi oborrin me pllaka dhe e rrethoi jo me mur si ne, të tjerët, po me gardh të bukur prej shufrash teli të lyera me bojë argjendi. Jashtë oborrit, në një cep të kopshtit individual, ngriti shtallë për lopën dhe për të dhjetë dhentë që i lejon statuti. Shpuri edhe ujin me tuba gjer brenda në shtallë, gjë që s'e kishte bërë njeri gjer atëhere në fshatin e tij.

— Sikur e teprove, xha Nexhip! — i hidhnin nga një thumb ata të rinisë. — Po borgjezohesh...

— Nuk borgjezohem, paçi uratën! — ua priste ai gjakftohtë e i buzëqeshur. — Jam brenda vijës unë. Partia na i dha mundësitë që të ngremë e të rregullojmë jetën tonë edhe këtu në fshat brenda interesit të përgjithshëm dhe në rrugën që na mëson ajo. A kam dalë unë një majë thoi nga kjo rrugë? Kurrën e kurrës. Dhe, në qoftë se këto që bëj unë bien në sy në krahasim me gjendjen e një takëmi familjesh në kooperativën tonë, fajtor s'keni pse të më quani mua, po vetë ato familje, të cilat, siç e dini, nuk e bëjnë qejfin qeder për punën e përbashkët në kooperativë, po e shkojnë në hije të tendës vapën e verës dhe pranë vatrës me zjarr të ftohtët e dimrit.

Kështu e shpjegonte çështjen Nexhip Ramizi dhe kishte të drejtë. Se, të themi atë që është, kush na pengon ne, të tjerët, që të punojmë e të fitojmë për të rregulluar jetën ashtu si ai, pa cë-

nuar punën kolektive dhe interesin e përgjithshëm, po përkundrazi, duke i vënë këto mbi të gjitha dhe duke i shpënë përpara? Nga kjo niseshin edhe kryesia e kooperativës e organizata e partisë në fshatin e Nexhipit që e mbronin këtë nga thasethemet dhe e ndihmonin për të rregulluar jetën e tij. Dhe kjo i dha krahë Nexhipit të shpinte gjer në fund, ashtu siç ia kishte ënda, përgatitjet për martesën e të birit.

Thuhej se edhe i biri, i shtyrë ndoshta nga fjalët e shokëve e shoqeve të tij, ishte kundër gjithë këtyre përgatitjeve, po ish një nga ata të rinj të drojtur e të ndrydhur ai që, edhe pse janë me mish e me shpirt për të renë, nuk ua prishën dot qejfin prindërve edhe kur këta bëjnë gjëra që s'pajtohen me frymën e të rinjve. I shikonte të gjitha dhe s'ndihej. «Është i turpshëm, thoshte me vete plaku. Kështu ishim të gjithë kur na fejonin baballarët. Nuk shfaqeshim te të tjerët, po përbrenda digjeshim zjarr nga gëzimi».

Dhe vazhdonte të shkrihej në punë, ditën në kooperativë, natën rreth e rreth shtëpisë. Në një dëfter të vogël, që e mbante gjithnjë me vete, shënonte edhe ato gjërat më të vogla që do t'i duheshin për dasmë. S'kishte ndër mend të bënte ndonjë dasmë kushedi se çfarë, (këtë e dinte mirë Nexhipi, se s'e lejonin rregullat e reja të shoqërisë) po edhe ashtu fare, siç bëjnë disa, që i futin nuset në shtëpi pa e marrë vesh njeri, nuk do ta bënte. Kishte llogaritur të ftonte gjithsej nja njëzet veta nga miqtë e farefisi dhe nja shtatë a tetë veta nga kryesia dhe organizatat e fshatit. Do t'i duheshin kështu nja tri shqerra të mira dhe 20 kiloraki rrushi, shqerrat i kishte të siguruara nga tufa

e tij, (i kishte ndarë që tani nga tufa dhe u bënte shërbim të veçantë) kurse për rakinë ishte marrë vesh me kryesinë e kooperativës dhe ajo i kish premtuar t'ia ruante nga prodhimi i ardhshëm i punishtes. Për të tjerat — shëndoshë MAPO-ja, që i ka të gjitha kur t'i duash dhe si t'i duash. Mjart ton të të ketë xhepi. Dhe xhepi i Nexhip Ramizit ishte gjithnjë plot, sidomos këtë vit kur të ardhurat e familjes nga kooperativa kishin arritur që në gjashtë muajt e parë shumën e gjithë vitit që shkoi.

I kënaqur nga të gjitha punët që i ecnin si sahat, Nexhipi priste tani ditën e gëzimit të tij të madh, martesën e djalit të vetëm me atë çapkënen e Faslli Gurit, që i kishte hyrë aq shumë në zemër.

Nga ana tjetër, edhe Faslliu, që dukej sikur s'e vinte fare ujët në zjarr për atë punë, prapë aty e kishte mendjen edhe kur copëtohej më të djathtë e më të mëngjër në punët e kooperativës sonë. Si për çdo prind, edhe për atë ish gjë e hidhur që do të ndahej nga e bija, por gëzimi që ajo do të shkonte në shtëpi të mirë dhe miqësia e ngushtë me Nexhip Ramizin, me të cilin ishte bërë, siç e dinim të gjithë, dy kufomë e një shpirt, i jepte zemër. Kishte bërë e po bënte edhe ai përgatitjet e tij. Si vajzë të vetme që e kish Festimen, nuk i bënte zemra ta niste të bijën, si i thonë fjalës, me ç'kishte veshur, aq më tepër që ajo gjithë të ardhurat e saj nga puna në kooperativë ia dorëzonte të atit. Faslliu kishte vënë mënjane të hollat që duheshin për një dhomë gjumi dhe për veshmbathje e çikërrime të tjera të nusëvisë. Kishte menduar pastaj edhe për shpenzimet e

dasmës që do të bënte. Ai ishte kundra dasmave dhe për këtë ish grindur kushedi sa herë me kooperativistët që e tepronin në të tilla raste, por rasti i tij ishte ca si i veçantë, sepse ky ish gëzim i tij i parë dhe i fundit në familje. Tek e fundit nuk do të bënte dasmë që të habiste botën, po një dasmë të thjeshtë, pak a shumë si atë që kishte bërë kur kishte fejuar vajzën, me pije e karamеле për ata që do të vinin të uronin, domethënë për gjithë anëtarët e kooperativës, me të mëdhenj e të vegjël, dhe një drekë të ngushtë me shokët e kryesisë dhe me njerëzit më të afërm të familjes.

Faslliu kishte atë të mirë që nuk binte në sy me përgatitjet që bënte. Ish këshilluar për të gjitha vetëm me krushkun e me krushkën dhe as vajzës s'i kishte thënë çerek fjalë, duke menduar, si na thotë mendja gjithë ne, të vjetërve, se ajo, nga turpi, s'do të kish gojë të fliste për gjëra që kishin të bënin me martesën e saj. Bile as ne, vërsnikëve dhe shokëve të tij më të afërm, nuk na ish hapur Faslliu, dhe ne i kishim rënë në të vetëm nga ndonjë fjalë që i shpëtonte padashur kur bisedonte për punë të ndryshme të kooperativës.

Kështu që rasti një ditë, tek po bisedonim me të për hallin e disa familjeve që s'kanë krahë pune.

— Ti s'ke pse ankohesh — u hodh e i tha xha Alushi. — Ke vajzën që punon sa për tre.

Faslliu nuk rrudhi vetullat, siç e ka zakon kur s'është në një mendje me tjetrin, po përku-ndrazi vuri buzën në gaz e tha:

— Ajo është e botës, o Alush. E kam a s'e kam edhe një vit në shtëpi.

— Ashtu hajde për hair! Domethënë ia paske prerë ditën.

— Ja kam prerë — u detyrua të pohonte Faslliu. — Tani e ka radhën xhepi. Se, sado hollë që ta heq, prapëseprapë do më duhet të bëj ca shpenzime. Nuk e nxjerr dot vajzën lakuriq nga shtëpia. Ka punuar e gjora dhe ka të drejtën e saj.

— E kërkon puna — i bëri qejfin xha Alushi. — E ke vajzë të vetme dhe përveç kësaj ke të bësh me familje, ku e ke të fjetur mendjen.

— Ashtu është. Të falem nderit! — u çel më shumë në fytyrë Faslliu dhe sytë e tij shkëlqyen sikur buronin dritë e gëzim.

* * *

Gjer këtu kishte arritur puna gjatë kohës që Gëzim Pronjoja s'e linte të qetë kryetarin për çështjen e dritës elektrike. Dhe ish e ditur tani se, po të trashej më shumë grindja, ai s'do rrinte pa ia nxjerrë në shesh Faslliut edhe çështjen e fejesës së vajzës si «mbroçkullën» e tij më të madhe.

Dhe ja! Një ditë të bukur, tek po hahej vetëm për vetëm me Faslliun për atë të uruar dritë elektrike, s'di si qenkësh trashur fjala dhe, në zemërim e s'për, ia paske përplasur hapët fare kryetarit:

— Dëgjo, shoku kryetar! Ti ke pasur një biografi të mirë, nga e cila duhej të merrnim shembull ne, të rinjtë. Por tani, jo vetëm në çështjen e elektrikut, po edhe në ca çështje të tjera, po bëhesh pengesë për revolucionin dhe kjo t'i rrëzon të gjitha meritat...



Hap sytë e lë mendjen i varfëri Faslli:

— Folë mirë, more djalë! Pse u bëkam pengesë unë për revolucionin?

— Se s'po e prish fejesën e Festimes me djalin e Ramizajve...

Faslliu u përpoq në fillim që t'i mbushte mendjen me të urtë se kjo ishte një punë e vjetër dhe s'kishte asnjë mundësi që të ndreqej tani. Ta prishje këtë miqësi, do të thoshte të bëheshe armik me gjithë fafëfisën e krushkut dhe veçanërisht me krushkun vetë, Nexhip Ramizin, goxha burrë. Lëri pastaj të tjerat...

Mirëpo s'kishte burrë që të mbushte mendjen e përgjegjësit të rinisë. Ai ish më avokat nga Faslliu dhe më në fund arriti t'i kanosej plakut — të paktën kështu e dimë ne — edhe me ndonjë thumb në revistën «Hosteni», duke shtuar se për këtë çështje ishte këshilluar edhe me sekretarin e organizatës së partisë, shokun Riza.

S'do mend që Faslliu, me kokën tym nga kjo e pabërë që po dëgjonte, ia la djaloshit fjalën pa mbaruar dhe u derdh fill e flakë për te sekretari i organizatës, që kishte shkuar të kontrollonte punën e traktoristit nja dy orë të mira larg fshatit.

E gjeti Rizain tek merrej vetë, në sy të diellit, me rregullimin e traktorit, që kishte ngecur në një vend gropë ku, nga avra e madhe, s'merrje dot as frymë. Po Faslliu, ashtu si e kishte punën, s'desh të dinte fare dhe, pa i thënë as «puna mbarë» siç është zakoni, iu vërsul me këmbët e para:

— T'i paça borxh, more Riza Hodoja, këto komplete që po më ngre...

— Ç'ka ndodhur? — e pyeti i habitur sekretari.

— Kanë ardhur me urdhër tënd të më rrë-

mbejnë çupën dhe ta japin, jo atje ku dua unë, f
atë, që i kam bërë kokën, po atje ku ta ka ënda
ty me atë bukuroshin e rinisë.

Siç e shikoni, shoku Faslli, megjithëse s'i ka
zakon gënjeshtër, shtoi shumë gjëra nga vetja e
tij në krahasim me ato që mund të kishte thënë
përgjegjësi i rinisë.

Rizai përplasi përtokë ca hekurishte që kishte
në duar dhe iu kthye i nevrikosur:

— Folë, more, mirë! Ç'janë këto që më thua?

Faslliut i dëlnin shkëndija nga sytë, kaq ish
ndezur nga dëshpërimi dhe s'ia priste fjala fjalën:

— Kam kohë që kam filluar të zbardhem,
kurse ti je i ri akoma, megjithatë, të kam pasur
gjithnjë mbi krye e sipër dhe të kam respektuar
si burrë të ndershëm dhe veçanërisht si sekretar
partie që të kemi, por më paska gënjyer kjo e
shkretë...

Ai i ra kokës me grusht dhe, nga vreri që i
ishite mbledhur e bërë xhëng në grykë, mezi vazhdoi:

— Nuk më shkante ndër mend. Shoku sekre-
tar, që ti të merrje mendjen e axhamive dhe të
më nxije faqen në këtë moshë. Ti ndoshta ke
edhe ndonjë udhëzim që të sillesh kështu me ne,
anëtarët e vjetër të partisë, që e hëngrëm barin,
por unë s'bindem për këtë dhe do ta kërkoj të
drejtën time gjer atje tek ma lejon statuti.

Domosdo që kjo mënyrë të folur e një burri
të shkuar nga mosha, që njihej njëkohësisht edhe
si ndër më të respektuarit në fshat, i ra rëndë
shokut Riza dhe e vuri në mendim, aq më tepër
si sekretar partie.

Rizai i kishte të rrallë shokët si nga puna,
ashtu edhe nga sjellja. I nderonte shumë shokët e

luftës dhe ish aq i matur e i duruar me ta kur binin më ndonjë gabim, sa s'mund ta bënte njeri tjetër atë që bënte ai. Në këtë pikë ndahej shumë nga Gëzim Pronjoja, që ishte i hedhur dhe donte t'i rrëzonte lisat me një të rënë sëpate.

«Unë e quaj oportunist të këtyre qëndrimin tënd me të tjerët», i thoshte shpesh Gëzimi sekretarit të organizatës. Po Riza Hodoja nuk e prishte gjakun. Qeshte nën buzë e përgjegjej: «S'është ashtu, Gëzim. Pa mendo një herë se nga ç'botë vijnë ata. Edhe në gabojnë, nuk e bëjnë këtë me ndonjë qëllim të lig, por ngaqë ashtu e mendojnë të mirën e përbashkët».

Durimi i Rizait e kishte burimin që nga koha e luftës. Ai që i vogël atëhere dhe bëri vetëm detyrën e kaçiatorit, po kishte një vëlla të madh, Ramo Hodon me derte, komisar batalioni, me të cilin mburrehim të gjithë. Dhe ja, tamam këtij kapedan djali na i ngjau ajo që mos i ngjafte njeriut. E pse? Sepse nuk u tregua dot i duruar e gjakftohtë, siç e kërkonte puna, me një partizan të thjeshtë të batalionit të tij. Partizani kishte dashur të sqarohej nëse u duhej prerë apo jo koka gjithë agallarëve kur të çlirohej Shqipëria. Ramoja thoshte se duhej të ishin të matur në ato çështje, se kishte agallarë e agallarë dhe secili duhej të paguante sipas bëmeve të tij. Kurse partizanit nuk i mbushej mendja. Kishte ngrënë dru e përbuzje tërë jetën e tij te çdo aga ku kishte punuar dhe s'qe e mundur të bindej që agallarët s'ishin të gjithë njësoj. I zemëruar nga shpjegimet e komisarit, atij i shpëtoi nga goja një fjalë që s'duhej. Kjo i nxehi gjakrat dhe puna arriti gjer aty sa komisar Ramoja e humbi durimin. Nxori re-

volverin dhe u mat të shtinte kundër partizanit. «Vramë! i tha ky. Unë s'e dua jetën në qoftë se është ashtu si thua ti».

Komisar Ramoja mbeti me revolver në dorë dhe nuk i shkoi gabimit gjer në fund. Po edhe aq mjaftoi. Afër darkës partizani ishte hedhur nga shkëmbi. Ndoshta jo me qëllim, po ashtu u mor.

Në celulë Ramon e kritikuan rëndë dhe ai i pranoi të gjitha duke kërkuar vetë që t'i jepej dënimi më i madh. Celula që mori shumë gjëra parasysh që e matur në dënimin e saj, po për Ramon s'kishte dënim më të rëndë se brenga që i la në zemër ai i shkretë gabim i tij. Dy ditë më pas, në ndeshjen më të parë që pati batalioni i tij me gjermanët, u vërsul i pari dhe u vra.

Riza Hodoja, që e tregon me lot në sy ngjarjen edhe sot pas 20 e ca vjetësh, ishte ndodhur aty ato ditë. E kishin dërguar nga fshati, /si kaçiator që ish, me një letër e ca ilaçe për batalionin, po kishte filluar operacioni dhe shokët nuk e kishin lënë të kthehej. I pa me sy të gjitha dhe i qau njësoj si të vëllain, ashtu edhe partizanin.

Ja, kështu qëndronte puna e durimit të madh që tregonte Rizai me njerëzit. Në një fshat me Fasliun kishte lindur e ishte rritur Rizai dhe po u afrohej të dyzetave, po s'e kish parë ndonjëherë këtë burrë të tërbohej kaq shumë. E zemëruan, sidomos, ato fjalët e Fasliut: «Kanë ardhur me urdhër tënd të më rrëmbejnë çupën»... E si mund të jepte Rizai një urdhër të tillë? Dhe përnjëherësh i shkoi mendja te një bisedë e shkurtër që kish pasur ato ditë me përgjegjësin e rinisë për çështjen e ca fejesave të padrejta që ishin bërë në fshat. Por i kujtohej më mirë që s'kishte ardhur

me të në asnjë përfundim, vetëm se e kishte porositur të interesohej ca, në mënyra të tërthorta natyrisht, se si ishte gjendja e fshatit me fejesa të tilla, kështu që, më vonë, të shikonin se ç'mund të bëhej. Mos vallë ai djall Gëzim e kishte marrë tjetër për tjetër porosinë dhe ia kish plasur në surrat Faslliut gabimin e njëherë e një kohe? «S'më besohet», mendoj me vete.

E digjte shumë veç dëshira e papërmbajtur e djaloshit që ajo goxha Festime — Faslliu e kish të bukur e të zgjuar vajzën, dhe mbi të tëra të zonjën e punës dhe të lidhur ngushtë me problemet e rinisë — të mos merrte për shok jete një djalë që t'u përshtatej cilësive të saj dhe me të cilin ta lidhnin jo urdhërat e babait, por ndjenjat e dashurisë së saj, pra një nga shokët e rinisë së fshatit, me të cilin ajo të kishte punuar e të ishte njohur.

Rizai, bile, kish mësuar atë ditë nga shoku Gëzim edhe diçka që djaloshi ia tha si me të ruajtur se mos hapej fjala e ngatërrohej puna që zemra e asaj vajze na rrahkësh për një levend tjetër të rinisë së fshatit, Bejkush Alemin, të cilin e kish në brigadën e saj dhe e çmonte si shok me shumë cilësira, vetëm se, duke ia njohur kokën babait, nuk guxonte të hapte gojë.

Këto mendonte Riza Hodoja, ndërsa kryetari lëshonte në drejtim të tij fjalë pas fjale nga më të pakontrolluarat, dhe e pa veten në gjendje me të vërtetë të vështirë sa s'dinte ç't'i përgjegjej.

Ju afrua Faslliut dhe, duke bërë buzën në gaz, ngaqë s'i lejohej të sillej ndryshe, ia nisi urtë e butë:

— Pa dale, more shoku Faslli, të marr edhe

unë vesh një herë se ku qëndron puna. Pastaj shtrohemí e bisedojmë.

— S'është nevoja, jo! — u ngrys edhe një herë më shumë Faslliu. — Ke Gëzim Pronjon ti, që t'i shpjegon të gjitha, s'ke më nevojë për shokun Faslli.

— Komunistët nuk e kanë kështu — tundi kokën e buzëqeshi përsëri Rizai duke i zgjatur dorën.

— As prapa krahëve sí vepron ti nuk e kanë komunistët — ulëriti me të njëjtin tërbim Faslliu dhe, pa dëgjuar më asnjë fjalë të shokut, që me dorën zgjatur i lutej e i falej që të merrej vesh, çau e iku si furtunë.

* * *

U panë përsëri në mbrëmje pas darke, në shtëpi të Faslliut. Këtij i kishte rënë tani ai inati i mesditës dhe nuk e priti me këmbët e para Rizain që, kuptohej vetiu, kishte ardhur qëllimisht për të gjetur fjalën duke sjellë me vete edhe përgjegjësin e rínisë, Gëzimin.

Biseduan gjer në mes të natës dhe ish herë e parë që ía zbrazën njëri-tjetrit të gjitha gjërat që kishin në bark. Pranoi secili edhe ndonjë gabim a të metë të tij, po, kur erdhi fjala te fejesa e vajzës së Faslliut, ky rrudhi vetullat e ua preu shkurt:

— Vetëm në këtë pikë nuk lë njeri të futë hundët. Ajo është ime bñjë dhe mbaroi.

— Po kanë ardhur të tjera kohëra, more Faslli — desh ta zgjaste muhabetin Rizai.

— Kohërat kanë ardhur për të tjerë, jo për mua. E njoh unë çupën time. S'është nga ato çupa ajo që të lërë në turp babain e saj.

S'mund të thoshe se Faslliu fliste në hava duke treguar kaq besim te vajza. Ajo kishte marrë pjesë në çdo punë të fshatit bashkë me djem; jo vetëm, po kish shkuar vullnetare edhe në aksione të tjera jashtë rrethit tonë, ku kishte jetuar në mes të djemve të botës dhe prapë s'kishte dhënë as shenjën më të vogël të ndonjë dashurie me tjetër djalë. Kuptohej që ajo e kish fjetur mendjen me atë fejesë që i kish bërë i ati.

Kaq prerë e kundërshtoi Faslliu çështjen e vajzës, sa ish gatí të prishej përgjithnjë me të dy shokët sikur ata të vazhdonin «agjitacionin» e tyre.

Deshën, s'deshën, të dy shokët u tërhoqën nga ky muhabet me shpresë që, më tutje, të gjenin rast më të përshtatshëm e t'ia shtronin çështjen më hapët Faslliut. Po shoku Faslli u vuri si kusht, dhe ata u detyruan të pranonin, që kësaj çështje t'i vinin kapak. Dhe, ç'është e vërteta, asnjë njeri në fshat, përveç ne, katër a pesëve, që ishim si më të brendshëm, nuk dinte të ish biseduar ndonjëherë me kryetarin për fejesën e së bijës, tjetër që tutje e tëhu kishte ndonjë thashetheme.

Dhe shkaku që Faslli Gurí e kish thikë e brisk punën me përgjegjësin e rinisë duhej të ish, pa-tjetër, ndonjë nga këto thashetheme që do t'i kishte rënë në vesh. Ai s'kish si të mos e lidhte këtë me ç'kish ndodhur kohë më parë midis tij dhe Gëzim Pronjos. Po i bluante të gjitha përbrenda dhe as me ne, shokët e tij të ngushtë, nuk guxonte të hapej.

Vetëm me një njeri, nga sa kuptohej, fliste e

qante hall Faslliu për këto punë. Ky ishte llogaritar Tosuni, që nuk gëzonte ndonjë simpatë të veçantë në fshat, por që Faslliu e mbante pranë dhe i dilte në mbrojtje sa herë që e kritikonin për ndonjë të metë. Se ç'e lidhte Faslliun me llogaritar Tosunin, këtë s'e kishim kuptuar dot as ne, të afërmit e tij. Të thoshje se në këtë mes kishte ndonjë dallavere abuzimi në llogari, ku të kishte gisht edhe vetë Faslliu, këtë nuk e thoshte dot njeri. Të gjithë vënim duart në zjarr që Faslli Guri ish njeriu më i drejtë, veçanërisht për sa i takonte qëndrimin ndaj pasurisë së përbashkët. Bile ishim të bindur të gjithë se Faslliu e donte dhe e mbronte. Tosunin, pikërisht pse ky ishte shumë i rregullt në llogari.

Tosuni, nga ana e tij, ishte aq i heshtur me të tjerët për çështjet që bisedonte me kryetarin, sa, me të drejtë mund ta quaje «gur varri», ashtu siç e quante shumica e fshatit.

Kapitulli II

Kështu qëndronin punët edhe pas dhjetë muajsh nga mbledhja e madhe me instruktorin e partisë, kur u ngrit, për të tretën herë çështja e elektrikut. Këtë radhë ndodhi një gjë e papritur, që e nxori edhe një herë në shesh davanë e vjetër të elektrikut dhe që u bë shkak të fillojë prapë grindja, bile më e ashpër, në mes të kryetarit dhe përgjegjësit të rinisë.

Fshati fqinj, që bën pjesë tani bashkë me në kooperativën e bashkuar «Burimi» domethënë fshatit i krushkut të Faslliut, kishte rregulluar ato ditë pa bujë, ca me ndihmën e deputetit të zonës, ca me ndihmën e një reparti ushtarak, një turbinë të përdorur dhe një sasi qyngjesh që mezi gjenden dhe kish ngritur shpejt në përrua një hidrocentral të vogël. Shtyllat e nevojshme i kishin prerë vetë fshatarët, me lejen e seksionit të pyjeve të komitetit ekzekutiv të rrethit, kishin gjetur ca andej, ca këtej edhe telin, filxhanët, çelësat e vegla të tjera dhe, një ditë të bukur, një pjesë e fshatit që i kishte shtëpitë afër qendrës, u bë me dritë elektrike. Drita i kish gëzuar pa masë fshatarët, po më shumë se drita i kish gëzuar një radio e madhe që e kishin vendosur në vatrën e kulturës dhe e mba-

nin hapët mëngjez e mbrëmje. Radioja, jo vetëm që u kishte gjetur zemrën fshatarëve me këngë nga të gjitha llojet, por jepte edhe lajme disa herë në ditë, mbante edhe konferenca për punët e bujqësisë nga ato që u mësojnë njerëzve se si të kryejnë më mirë detyrat e tyre.

Përgjegjësi i rinisë, që e kishte dëgjuar i pari radion e fshatit fqinj, erdhi me një frymë te kryetari dhe ia përplasi gjithë inatin që kish:

— Ti je prapanik! — i tha në sy të dhjetë a pesëmbëdhjetë fshatarëve që ndodheshin për halle të ndryshme në zyrën e kryetarit. — Nuk ecën me kohën!

Domosdo që kryetarit i ra rëndë fjala «prapanik», se, të flasim drejt, ai ka bërë shumë përpjekje që të ecë me kohën. Mjafton të dini që, kur mbaroi lufta, ai kishte vetëm tri klasë shkollë. Por, meqë pat luftuar si partizan trim dhe populli nga besimi që pati në të e zgjodhi në fillim kryetar të këshillit popullor, pastaj të kooperativës, nuk la kusur që të shtonte dituritë e tij. Sado që kish njëqind e një telashe me punët e fshatit, bëri si bëri dhe e mbaroi shtatëvjeçaren. Jo vetëm, po la edhe gruan e vajzën në hall të tyre dhe vazhdoi një vit kurs bujqësie në Tiranë, kështu që, kur u kthye, merrte vesh mirë nga punët e bujqësisë dhe nuk i ndodhte më si në të kaluarën, kur ngrinte duart lart përpara ndihmësagronomit edhe kur ky fliste gjepura. Ca kohë më pas i vdiq gruaja nga një sëmundje, së cilës nuk iu gjend dot shërimi, megjithëse shkoi edhe në Tiranë. Gruaja i preu duart Faslliut, se e la me çupën nëpër këmbë, që s'kish mbushur atëhere as dy-

mbëdhjetë vjeç, po prapë nuk u dha dhe punën e kryetarit u përpoq ta kryente me nder.

— Unë s'jam prapanik, more djalë... — ia ktheu përgjegjësit të rinisë dhe i përmendi disa nga meritat e tij. — E di më mirë nga ti rëndësinë e elektrikut, ashtu siç e kam të qartë edhe përparimin që do të sjellë ai. Po e kam pasur vështirë dhe akoma vështirë e kam të vendos, se kam njëqind halle të tjera mbi kokë, halle që s'presin fare. Mjafton të përmend zotimin që kemi marrë për të siguruar bukën në vend. Zotim i vogël të duket ty të sigurosh bukën në një fshat si yni, ku ha pula strall?.. Nuk jam prapanik, jo! Fute në xhep atë fjalë, ti, djalë i mirë.

— Prapanik që ç'ke me të — ulëriti i riu. — Ato merita që ke ti i dimë të gjithë dhe s't'i mohon njeri. Po ato janë merita të një kohe tjetër, s'janë të kohës së sotme. Sot kërkohen të tjera cilësi, shoku kryetar. Duhet të pohosh këtu, në sy të popullit, se ajo mendja jote na ka lënë kot pa dritë elektrike. Thuaje troç! Je kënaqur vetëm me ato llambat me pasqyrë që zunë vendin e pishës e të kandilit dhe mbete aty, megjithëse partia dhe rinia të kishin thënë që duhet ecur përpara.

Kaq fort nguli këmbë përgjegjësi i rinisë në të tijën me ca shembuj që solli, sa shumë nga shokët e shoqet që u ndodhën aty i dhanë të drejtë, kurse kryetarit iu mbyll goja fare. Vetëm se, në të mbaruar të bisedës, ngaqë kooperativistët prisnin mendimin e tij, u detyrua e tha:

— Lërmëni ta mendoj sonte këtë çështje me shokët e kryesisë dhe nesër ju jap përgjegje.

* * *

Të nesërmen në mbledhjen e përgjithshme të fshatit Faslliu erdhi shumë i mërzitur. Ndzite e shuante cigare pas cigareje dhe meazallah se këmbente fjalë me njeri. Kur doli në presidium bashkë me sekretarin e organizatës dhe përgjegjësen e gruas, Mjaftimen, nuk zuri vend në mes, siç bënte gjithnjë, po u ul në cep.

Të gjithëve u bëri përshtypje ky qëndrim i tij dhe, andej-këtej, nëpër sallë, sidomos nga ajo anë ku kishin zënë vend të rinjtë, filluan pësh-pëshet me njëri-tjetrin.

Thuhej se në mbledhjen që kishte pasur mbrëmë kryesia dhe që kish vazhduar gjithë natën, na kish ardhur papritur edhe një nga nënkryetarët e komitetit ekzekutiv të rrethit, ai që merret më shumë me punët e arësimit e të kulturës. Nënkryetari kish ardhur për tjetër punë, po kryetar Faslliu kish dyshimet e tij. Ai ishte i bindur se kjo ish një punë e organizuar me qëllim nga ai «shejtan» përgjegjës i rinisë, që s'le dy gurë bashkë. Dhe në mbledhje kishte krisur kritika hapët fare, si në kohën e luftës. Faslliu i kishin dalë edhe të meta të tjera aq sa, duke mos ditur se ç'të përgjegjej, e kish shkelur fare me një fjalë të pëshuar që kish lëshuar në inat e sipër: «Unë, fundi i fundit, jam kryetar dhe bëj si të më thotë mendja».

E merrni me mend se si i qenë vërsulur pas-taj që nga nënkryetari i komitetit e gjer te përgjegjësja e gruas, e cila s'e kishte ngritur asnjëherë zërin kundër tij. Dhe Faslliu, që ish i bindur tani se të gjitha ato kritikant e mbrëmshme në

kryesi do t'ia bënin edhe përpara fshatit, grihej e shqyhej përbrenda dhe nuk ish në gjendje të mbante veten.

Dikujt i vinte keq për të dhe ngarkonte me faj përgjegjësin e rinisë, që u bë shkak e arriti puna gjer në këtë shkallë. Dikush tjetër thoshte se kish ardhur koha që kryetari t'ia linte vendin ndonjë të riu që sheh më larg dhe që ka fuqi e dituri për të çarë përpara.

— Unë mendoj që të bashkëpunojnë të dy palët, se të dyja një qëllim kanë — tha më plaku i kooperativës, Alush Bocëngu.

Ndryshe nga të tjerët që flisnin vesh më vesh, plaku i tha këto fjalë fort. Kryetar Faslliu, ashtu i mërzhitur siç ish, hodhi sytë nga xha Alushi dhe tundti kokën duke buzëqeshur sikur donte t'i thoshte: «Mirë thua ti, xha Alush, po ja që me këta të rinjtë s'u gjendka lehtë fjala.»

Plaku, si t'ia kishte blerë mendjen kryetarit, vazhdoi fjalën:

— Të themi atë që është... Vërtet që ne, pleqtë, nuk i tresim dot shumë nga të bëmet e rinisë, po ama ajo ka të drejtë që i sheh çështjet pakëz më ndryshe nga ne. Fundi i fjalës, edhe ne, kur ishim në moshën që është ajo sot, ndryshe i shikonim punët nga baballarët tanë; tjetër që s'hapnim dot gojë, se lëvonte druri. Kurse tani drurin e kemi vetëm për armikun dhe s'e përdorim dot as në djaln, as në gruan, se s'të lë ai kapedani atje.

Plaku tregoi një fotografi të madhe të shokut Enver që ishte varur në faqen e murit, prapa prësidiunit.

Disa të rinj qeshën me këtë mënyrë të foluri

të plakut, kurse kryetar Fasliu, i cili ndoshta priste që, të paktën plaku, të thoshte ndonjë fjalë të mirë për të, u thartua ca në fytyrë dhe filloi të lëvizte me nervozitet në karrigen ku kishte zënë vend.

Xha Alushi e vuri re dhe s'e pëlqeu këtë lloj qëndrimi:

— Që të themi atë që është... - nisi përsëri plaku dhe u ngrit më këmbë, por kryetarja e gruas, që kish zënë vend në mes të shokëve të presidiumit dhe me sa kuptohej do të drejtonte mbledhjen, ia preu fjalën:

— Folë më pastaj, xha Alush, kur të hapet mbledhja. Ti e sheh që s'kemi filluar akoma.

— E shoh, e shoh. Po, që të themi atë që është, unë nuk e shoh të udhës që të mos jetë aty në presidium edhe përgjegjësi i rinisë. Ka fjalën e tij edhe ai.

Edhe kjo iu desh kryetar Fasliut që të tërbohej:

— Përgjegjësi i rinisë s'ka nevojë për avokat — thirri duke iu hakërruar plakut.

— Unë them që të jetë në presidium, pa ti merre si të duash — nguli këmbë plaku.

Anëtarët e presidiumit këmbyen nga një vështrim me njëri-tjetrin. U kuptua që ata ishin të një mendje me plakun, po prisnin ç'do të thoshte kryetari. Ky ngriti supet e mermëritit me një farë moskokëçarje:

— Ne s'kemi qenë ndonjëherë kundër rinisë, po s'i shkoi ndër mend asnjërit ta kishim sjellë në presidium.

Shoqja Mjaftime u kthye nga salla e pyeti:

— Jeni dakord që, përveç ne, të treve, të bëjë pjesë në presidium edhe shoku Gëzim?

U dëgjua përnjëherësh një varg duartrokitjesh nga ana e majtë e sallës, ku ishte grumbulluar me përgjegjës në mes shumica e të rinjve.

Xha Alushi tundí kokën e buzëqeshi i gëzuar:

— Ashtu, ju marça të keqen, ashtu.

Pastaj iu kthye llogaritarit të kooperativës, Tosunit, që e kishte më të djathtë:

— Zjarr, për besë, zjarr i kemi këta të rinjtë. Le të thotë ç'të dojë kryetari.

Llogaritarit síkur nuk iu duk me vend ky entuziazëm i plakut. Nduku buzën si të donte të thoshte që plaku e shkeli shumë me atë qëndrimin e tij dhe, duke ulur zërin që të mos dëgjohej nga të tjerët, i pëshpëriti:

— Të gjitha i besoja, xha Alush, po, që të prisheshe ti me shokun Faslli, këtë s'ma merrte mendja. Ç'djall ju ka pështyrë në çorbë? Ju shkonit aq mirë me njëri-tjetrin!.

Plaku mblodhi vetullat dhe e shikoi me vërej-tje:

— Kush të tha ty që qenkam prishur me Faslliun?

— S'ka nevojë të ma thotë njeri, e thotë puna vetë. Vetëm ti në gjithë këta njerëz po ngrihesh kundër tij...

— Unë s'e kam kundër Faslliut, mor djalë — u nevrikos plaku. — E kam kundër asaj mendjes së tij që anon shumë nga e djeshmja dhe s'i dëgjon të rinjtë që vështrojnë përpara.

Llogaritari shikoi edhe një herë rreth e rrotull dhe e afroi më shumë kokën nga plaku:

— Sidoqoftë, Fasliu e ka punën pfsk këtë

radhë dhe vetëm përkrahja e ne, miqve të tij, që e njohim, mund ta shpëtojë.

— Jo, more! — i tha me qesëndi xha Alushi.

— Domethënë të ecim me tarafe, thua ti...

— Nuk më kuptove, xha Alush, nuk më kuptove — desh ta ndreqte fjalën tjetri, po plaku nuk e la të vazhdonte:

— Të kuptova që ç'ke me të. Ti do që t'ia mbuloj shokut Fasllë të metat, se e kam shok. Po s'është asi burri Alush Bocëngu jo. Ishin të tjera kohëra ato kur ne, fakir fukarenjtë, ia mbulonim kusuret njëri-tjetrit. Sot, t'i mbulosh gjynahet shokut, do të thotë t'i bësh të zezën popullit, vetes sate dhe shokut.

Desh, s'desh, llogaritari s'e zgjatí më, ndoshta edhe pse në tribunë që ngritur shoqja Mjaftime dhe po hapte me një fjalë të shkurtër mbledhjen.

Ajo tha se mbledhja kishte për qëllim të bisedojë propozimin e organizatës së rinisë së kooperativës për ngritjen e një hidrocentrali që do t'i jepte dritë fshatit tonë, si dhe disa qëndrime të gabuara të shokut Fasllë në detyrën e tij si kryetar.

— E dëgjon? — pëshpëriti nën zë llogaritari duke i rënë lehtë me bërryl xha Alushit.

Plaku e shikoi vëngër një copë herë dhe nuk u përgjegj. Vetëm se u pa qartë që atij i bëri shumë përshtypje ky interesim i veçantë i llogaritarit për kryetarin. Xha Alushit i kishte zënë nja dy herë veshi disa fjalë për kryetar Fasllëun që i besonte shumë llogaritarit, po nuk u kishte dhënë rëndësi. Llogaritari ish i një moshe të pjekur, mbí 35 vjeç, dhe vinte nga një familje e varfër e fshatit. Ishte rritur me të keq dhe më keq do të kish përfunduar, sikur të mos e kish nxjerrë në dritë

Partia, ashtu si nxori gjithë të varfërit e të shtypurit e vendit. Kur erdhi Partia në fuqi, ai kishte vetëm dy klasë fillore. Po shpejt i erdhi radha për ushtar dhe atje mësoi diçka më tepër. Pas ushtrisë u caktua me punë zyre me kusht që të vazhdonte natën shkollën, dhe kështu bëri. Kur mbaroi shtatë vjeçaren, fshati që ishte bërë kooperativë, ndërmjetësoi ta futnin në një shkollë në Tiranë, ku të dilte llogaritar. Atje bëri ca çapkenllëqe, se u përzje — thuhej — me ca djem të prapë dhe humbi një vit, por përsëri, duke marrë parasysh se ishte i ri dhe, veç kësaj, vinte nga shtresë e varfër, u rregullua puna dhe ai e mbaroi shkollën.

Tani po mbushte dhjetë vjet në detyrën e llogaritarit të kooperativës dhe, ç'është e vërteta, me ndonjë përjashtim të vogël, fshati s'kishte shfaqur ndonjë ankim. Qenë hapur dikur ca thashetheme për shtëpinë e re me dy dhoma e kuzhinë që ngriti pa filluar mirë nga puna, po ai vërtetoi se shtëpinë e kishte ngritur me të hollat që kish marrë borxh nga një miku i tij, dhe thashethemet u mbyllën. Kooperativistët e kishin inat, më tepër se për çdo gjë tjetër, për dy a tri pena stilografike që mbante në xhepin e jashtëm të xhaketës si ata memurët e kohës së Zogut. Edhe ato fjalë që ishin pëshpëritur se kryetari ka besim të tepëruar në të, nuk ishin fjalë që e rëndonin me faj. Fundi, kryetari e kishte provuar që ish i rregullt në llogari dhe prandaj i besonte.

Po ja që xha Alushit tani i lindi një farë dyshimi dhe filloi të humbte në ca mendime të tij, ndërsa Mjaftimja po i jepte fjalën shokut Fasli.

«S'ankohen kot këta të rinisë, vazhdonte të

wriste mendjen plaku. S'ka dy muaj që edhe vetë çupa e Faslliut, kur u ndanë të ardhurat e vitit, i bëri gjithë ato kritika llogaritarit dhe s'do të ish ndarë mirë me të, sikur të mos kish hyrë në mes shoku Faslli. Pa shih! Pa shih!»

Ktheu kryet nga llogaritari me qëllim që t'i hidhte ndonjë thumb, po ky ia kishte mbërthyer sytë Faslliut, që sapo kishte marrë fjalën, dhe dukej sikur e kish humbur fare. Faslliu nuk ish më ai serbesi i herëve të tjera. Fliste pa shkruar, po mezi i delte fjala dhe sytë s'i ngrinte për kiamet nga tryeza që kish përpara.

«Ja edhe një shenjë tjetër që Faslliu duhet të ketë shkelur në dërrasë të kalbur, tha me vete plaku. Njeriu që flet e s'të shkikon në sy, e ka një shejtanllëk...»

Plaku i mendonte këto me një farë zemërimi për Faslliun, po, thellë-thellë, nuk donte të besonte që ai të kish bërë ndonjë të pabërë në detyrën e tij si kryetar dhe i vinte keq për të.

«Do ta ketë futur në lak ky pispillin», mendoi dhe përsëri ktheu kryet me përbuzje nga llogaritari.

Faslliu kishte më shumë se dhjetë minuta që po fliste dhe, megjithatë, s'kishte thënë asgjë nga ato që prisnin kooperativistët. Vinte nga vinte, përsëri kthehej te koha e luftës dhe tek ato vështirësitë e viteve të para të çlirimit. Mjaftimja i bëri nja dy herë shenjë që të hynte në temë, po ai, me sa dukej, qe mbërthyer s'i me gozhdë në ato mendimet e tij dhe s'po lëvizte.

Përgjegjësi i rinisë, që rrinte në të majtë të Mjaftimes, mbante njërën dorë në faqe dhe me sytë ulur diç shkarraviste në një copë letër që kishte përpara. Veçse, po t'i vëreje mirë, i rrihnin

tëmthat nga inati dhe dukej sikur mezi priste çastin që të shpërthente.

— Si thua ti, Gëzim? — e pyeti në vesh shoqja Mjaftime.

Ai hoqi dorën nga faqja, ngriti pakëz supet dhe buzëqeshi:

— Ç'të them! Vepro si të dish vetë. Salla, veç, siç e shikon, po gogësin.

Dhe me të vërtetë shumicën e njerëzve po e zinte gjumi. Edhe disa që lëviznin nëpër karrige, e bënë këtë nga mërzia. Nja dy djem nga grupi i të rinjve tundnin herë pas here kokën me një pakënaqësi që dukej sheshit. Njëri nga këta, Bejkush Alemi, vetullzi e flokëdredhur me një bluzë doku të prerë alla partizance, kthehej dendur prapa nga vajza e kryetarit, Festimja, dhe, me ca shënja që i bënte, dukej sikur i thoshte: «Ç'bën kë-shtu ky babai yt? Të takon ty ta vësh në rrugë». Kurse ajo ulte sytë e mundahej të buzëqeshte, por kuptohej që këtë e bënte nga e keqja. Si më i interesuar nga të gjithë dukej xha Alushi, që mbante kokën lart, e, me vetullat shtrënguar, shikonte kryetarin, sikur po matej t'i bërtiste: «Do flasësh si burrat ti, apo të ngrihem i të ikim?»

Kurse llogaritari, me trupin përgjysmë nga plaku, kishte kthyer njërin vesh nga tribuna dhe dëgjonte me vërejtje.

Mjaftimja e pa gjendjen dhe iu drejtua shoqut Faslli:

— Më fal që po ta pres fjalën, shoku kryetar, po më duket se u zgjate shumë për të kaluarën, kurse shokët e shoqet që kanë lënë punën për të ardhur në këtë mbledhje, duan që ti t'u

flasësh edhe për të sotmen, bile më tepër për të sotmen.

—Do të vij edhe tek e sotmja — tha shkurt dhe ca si i prekur kryetari. Fërkoj pakëz ballin me dorë si të donte të mblidhte mendimet që ia shpërndau ajo ndërhyrje e shkurtër e shoqes Mjaftime dhe, si nuk i mblodhi dot, iu kthye kësaj: — Ti shoqe s'bën mirë që flet pa respekt për të kaluarën.

— Unë flas pa respekt për të kaluarën?! — tha aty për aty Mjaftimja, e habitur.

Po kryetar Faslliu, pa ia vënë veshin, vazhdoi:

— Ajo e kaluara, që thua ti, shoqe, është burimi i gjithë të mirave që gëzojmë sot. Është si ai themeli i fortë me hekur e çimento, mbi të cilin kemi ngritur një shtëpi të re dhe të bukur me dy-tri kate. A mund të qëndrojë një shtëpi e këtillë pa një themel të atillë?

U dëgjuan ca të qeshura nga ajo anë e sallës ku kishin zënë vend të rinjtë. Xha Alushi ktheu kokën prapa dhe desh t'i qortonte. «Në këtë pikë se ka keq Faslliu, tha me vete. Qeshin kot të rinjtë».

S'do mend që edhe kryetar Faslliut s'i bëri përshtypje të mirë ajo e qeshur e të rinjve dhe përfitoi nga rasti për të shfryrë inatin te përgjegjësi i tyre.

— Ja kush nuk më kupton mua! — iu drejtua Mjaftimes duke treguar me gisht grupin e të rinjve. — Punë është kjo që ata të qeshin me mendimet e mia? Të paktën të kishin respekt për moshën time në mos për të tjerat...

«Ashtu është», belbëzoi si me vete xha Alushi dhe përqëndroi gjithë vëmendjen te kryetari që

të mos i shpëtonte fjalë pa dëgjuar. Llogaritari, sikur këtë rast kishte përgjuar, iu afrua përsëri plakut:

— Unë aty e pata fjalën, xha Alush, kur të thashë që shoku Faslliu ka nevojë sot për përkrahjen tënde e timen. E kanë vënë përpara këta të rinjtë dhe s'është çudi që të kërkojnë edhe heqjen e tij nga kryesia...

— Hesht, more ti! — ia preu plaku, pa ia kthyer sytë. — E bën Faslliu edhe pa kolltuk, mos ia ki merakun. S'është si ti që ke mbështetur gjithë shpresën tek ato penat që më mban radhë-radhë në xhep si dekorata.

— Me leje? — u dëgjua zëri i përgjegjësit të rinisë. — Desha t'i drejtoja një pyetje shokut kryetar.

Në sallë filloi një farë lëvizje. Mjaftimja i bëri shenjë me kokë përgjegjësit të rinisë dhe ai u ngrit:

— Bukur e solli shoku kryetar atë shembullin e themelit me hekur e çimento, pa të cilin s'kishte si të qëndronte më këmbë godina trikatëshe që kemi ndërtuar këta 25 vjetët e fundit. Rinia është dakord me këtë. Por a mund të na thotë mendimin e tij shoku kryetar nëse ai themel do të kishte ndonjë vlerë pa godinën e re që u ngrit mbi të?

— Jo! — u hodh përnjëherësh kryetar Faslliu.

— Del atëhere pyetja e dytë: — buzëqeshi përgjegjësi i rinisë. — Përse shoku kryetar na foli një çerek ore për themelin me hekur e çimento dhe s'na tha asnjë fjalë për godinën?

— Se në ngritjen e godinës kemi gisht edhe ne, rinia — thirri fort një i ri.

«Filluan!», i çuçurití xha Alushit në vesh llogaritari.

— Le të fillojnë, more! — ngriti zërin plaku me të kanosur. — Të marrë vesh populli se si qëndrojnë punët. Zotrote, në ke ndonjë mendje tjetër, prit të të vijë radha dhe dël e thuaje fjalën tënde.

— Të takon ty të flasësh — vazhdoi përsëri me zë të ulët llogaritari.

— Unë kam kokën time, s'kam nevojë për këshilla...

Grindja e plakut me llogaritarin tërhoqi vëmendjen e sallës dhe një shumicë e madhe e kooperativistëve ktheu sytë nga ata duke pëshpëritur lloj-lloj fjalësh.

Mjaftimja i ra me kurriz të gishtit tryezës dhe kërkoi të mbahej qetësi.

Po kaloi një copë kohë gjersa u vu qetësia.

— Vazhdo — i tha atëhere kryetarit Mjaftimja.

Kryetar Fasllun e kishin mbuluar djersët dhe s'po e gjente fillin e mendimeve.

— Sa për godinën e re... — nisi më në fund duke shikuar më të rrallë nga përgjegjësi i rinisë — unë s'jam aq i pagdhundur që të mos di rëndësinë e saj. Ajo është gëzimi i ne, të gjithëve, dhe pa atë s'do të kishte kuptim as lufta që bëmë. Po ama, themeli është themel.

«Prapë te themeli u kthye ky burrë», psherëtitu xha Alushí dhe, meqë s'duroi dot më, u ngrit e thirri:

— Folë, more Faslli, edhe për këto punët e tanishme, se mjaft fole për themelin. Do flasësh, apo jo?

Faslliu shikoi me mëri nga plaku dhe, ndërsa nëpër sallë u dëgjuan të qeshura e pëshpëritje, afi fshiu djersën me shaminë e duarve.

— Do flas — tha pastaj gjakftohtë. — S'kam pse të mos flas edhe për të tanishmen, gjersa edhe në këtë kam gisht e pjesë. Se, që ta marrësh vesh ti, Alush, në qoftë se ne s'kemi pasur haber nga puna e inxhinierëve, të paktën drurin e gurin e çimenton që u desh për të ngritur këtë godinë, unë e ti i kemi mbartur në krahë. Pa jemi bërë edhe hamej, edhe muratorë, edhe tavanxhi, kur e ka kërkuar puna. Mbathës në minierë ishte ti, mban mend? Të këputej mesi në punë atje, po, edhe kur vije me pushime në fshat, nuk bëje pushim, po i bëje pash më pash fshatit dhe derdhje djersë aty ku e shihje që kishim nevojë. Bile, edhe tani që të ka nderuar partia me pension dhe mund të rrije rehat në shtëpinë tënde, s'të mban vendi në vend, po i vjen në ndihmë kooperativës herë pas brigadës së tavanxhive, herë me ata të kaminave që djegin gëlqere...

Në sallë s'ndihej as miza. Vetëm një grua ca si e shkuar nga moshja, që rrinte më të majtë të xha Alushit — ish gruaja e parë e fshatit ajo që s'çau kokën nga thashethemet, po veshi fustan në vend të çitjaneve dhe për këtë e kishte marrë edhe gazeta — vështroi nga plaku dhe diçka i pëshpëriti.

— Lërna, për kokën tënde, të dëgjojmë — ia ktheu nën zë plaku, i mërzhitur. — Vetëm të komplimentave nuk e ke Faslliu. E ka gjetkë të keqen afi. — Dhe ia nguli përsëri sytë tribunës.

— Punuam ne që ndërroi lëkurë fshati — vazhdoi kryetari. — E mban mend si ishte kata-

ndisur në mbarim të luftës? Gërmadhë fare ish katandisur. I varfër e i pocaqisur kishte qenë tërë jetën fshati ynë, po barbarët na i dogjën e na i shkretuan edhe ato kasolle kashte ku futnim kokën. Le pastaj bagëti e kafshë që s'na lanë në këmbë. As saç për të pjekur bukën e kotruve për të mbushur ujë nuk na lanë. Kurse tani flasin vetë odat me tavan e penxheret me xhame të shtëpive të reja, flet kopeja me lopë e bagëti të holla të kooperativës që tund malin, flet MAPO-ja që na i mbushi shtëpitë me tertipe dhe gratë e fëmijët tanë me veshje si të Evropës. Pa le traktori që s'i dinim as emrin kur ishim të rinj, e shtatëvjeçarja, e vatra e kulturës, e ndihmësagronomi që na vjen një herë në javë... Si u arritën këto?

— Me ndihmën e Partisë! — thirrri një i ri nga mesi i sallës.

— Domosdo që me ndihmën e Partisë, more djalë. Atë s'ma thua dot ti mua, se, pa atë, s'do kishim as kokën ne. Po u desh edhe djersa jonë, ama, djersa e popullit. Pyet xha Alushin të të thotë se si kemi punuar ne kur zotrote me ata shokët që ke aty përreth s'kishit lindur akoma.

— E teproi! — u dëgjuan në fillim ca të pëshpëritura të cilat erdhën duke u shtuar dhe, pak nga pak, pushtuan sallën, aq sa kjo i ra në sy edhe kryetar Faslliut, që preu përnjëherësh fjalën dhe i hodhi një sy hetues Mjafitimes, sikur donte të kërkonte ndërhyrjen e saj.

— Qetësi, shokë! — thirrri ajo me të madhe. — Po edhe ti, shoku Faslli, — iu kthye pastaj kryetarit — po zgjatesh shumë mbi gjëra që s'kanë të bëjnë me këtë mbledhje. Nuk është e mundur t'i biesh më shkurt?

— Atëhere, shokë, që të mos e zgjatim, — ndërroi më në fund pllakë Faslliu — duhet të them se edhe ne s'kemi qenë pa gabime. Unë, për shembull, s'kam bërë përpjekje të mjaftueshme për ngritjen time ideologjike dhe po ashtu në çështjet e bujqësisë dhe të ligjeve. U kufizova me atë vit kurs që bëra dhe s'e vura shumë ujët në zjarr për më tutje. Kisha vërtet shumë telashe që s'më linin të zija libër me dorë. Ju e keni parë vetë që, ku më zinte darka, s'më zinte mëngjezi. Po këto janë justifikime. Pastaj kam edhe atë të metën tjetër që s'u jap dot udhë shpejt kërkesave të kooperativistëve dhe, dua, s'dua, nganjëherë edhe i zvarrit. Prapë në këtë çështje duhet të shtoj se ka shokë e shoqe në kooperativën tonë që kërkojnë edhe qumësht dallëndysheje nga unë. Sidoqoftë, mund të isha sjellë më demokratikisht edhe me këta.

Faslliu u ndal pakëz sa u mbush një herë mirë me frymë dhe prapë vazhdoi:

— Punë të madhe pastaj më ka hapur, siç e d'ni, edhe mungesa e kryetarit të këshillit, shokut Kanan, që po mbush tre muaj në llixha e sanatoriume dhe s'dihet kur do të kthehet. Papo e merrni vetë me mend. Të gjithë më drejtohen mua edhe për punëra që s'më përkasin. Se, edhe ai shoku që zëvendëson kryetarin, nuk gjendet gjithnjë në fshat.

— Nuk gjendet, jo! — pohoi nga një kënd i sallës ku mezi dukej, gruaja më plakë e fshatit, nënë Zelka, që s'ishte parë ndonjëherë në këshillë. «Ka shkuar në lokalitet», thonë, sa herë që e kërkojnë.

— E shikoni? — u kënaq Faslliu nga ky pohim i plakës. Dhe, si nuk u përgjegj njeri, vazhdoi: — Sa për llogaritar Tosunin, ndoshta jam gabim, po unë vë duart në zjarr që ai është njeri i drejtë dhe për këtë marr përgjegjësi.

«Po llogaritari ç'hyn këtu? filloi përsëri të vriste mendjen xha Alush. Duhet t'i ketë dalë ndonjë kleçkë këtij bukuroshi në mbledhjen e mbrëmshme». Dhe shikoi vëngër llogaritarin që lëvizi nga vendi e hoqi në zemër i kënaqur nga ajo mbrojtje që i bëri kryetari.

— I paske krahët të shëndoshë ti, dialë — e thumboi plaku duke i mërmëritur në vesh.

Llogaritari bëri sikur nuk e kuptoi romuzin:

— Ç'është e drejta, kam punuar pa u kursyer, xha Alush... po vetëm shoku Faslli më çmon — iu ankua plakut.

Që të dyve u tërhoqi vërejtjen një e hequr në zemër e Faslliut që po vazhdonte autokritikën dhe u kthyen nga ai për të dëgjuar më mirë.

— Nuk jam pa gjynahe as në çështjen e bashkëpunimit me popullin — tha me zë të lodhur Faslliu. — S'pranoj kurrën e kurrës fjalën «kryeplak», siç më quajti mbrëmë në mbledhje njëri nga shokët (nga sa u mësua më vonë, këtë fjalë ia kishte thënë përgjegjësi i rinisë) po megjithatë, kam fajet e mia në këtë çështje; kam pandehur se do t'i zgjidhja më mirë punët vetëm me kokën time, se sa duke u këshilluar me të gjithë shokët. Po kështu edhe me shoqet, që, të them të drejtën, s'i kam pasur sa duhet në defter. Këtu e kanë arësytën edhe ca nga ato kundërshtimet e mia për punën fekaleve që duhej të përdreshin në vend të plehut ose për heqjen e tër-

kuzës nga kurrizi i gruas dhe sídomos për atë të shkretë hidrocentral që mund ta kishim filluar që një vit më parë...

— Domethënë i re mendjes që duhen dëgjuar edhe të rinjtë — e ndërpreu që nga larg xha Alushí.

Kryetari rrudhi ballin:

— Nuk ma merrte mendja, more Alush, se mund t'i dilej në krye kësaj pune. Dhe, që të rri shtrembër e të flas drejt, akoma s'jam i bindur. Do na nxjerrë avaze ajo punë. Pa do të dojë edhe shpenzime. Dhe të gjitha do të rëndojnë në të ardhurat për ditë pune... Lëre pastaj atë zotimín që kemi marrë të gjithë bashkë që ta sigurojmë bukën në vend. Shaka të duket ty? Do krahe pune hidrocentrali, s'do llafe... E di që ju do të ma mbyllni gojën me shembullin e fshatit fqinj, që ishte në konditat tona dhe u bë me dritë elektrike. Keni të drejtë, po ja që unë s'jam i zoti ta shpjegoj.

Kryetar Fasliu e mbylli fjalën duke premtuar se pas kësaj autokritike, që, sipas mendimit të tij, s'kishte se si të ishte më e thellë, do të përpiqej ta kryente detyrën më mirë dhe me më shumë mendje në kokë.

Ai u ul në karrige në cep të tryezës së presidiumit duke fshirë vazhdimisht djersët që i kishin mbuluar fytyrën. Mjaftimja shkoi orën e dorës dhe propozoi 15 minuta pushim. Koope-rativistët, duke u ngritur, u bënë grupe-grupe dhe filluan nga bisedimet me njëri-tjetrin.

— Mirë e nisi, po e shkeli pakëz aty nga fundi — u dëgjua zëri i xha Alushit.

— Si tha të gjitha, jo — kundërshtoi një tjetër.

— Le ta zëmë se i tha të gjitha. Sa para bën? — u hodh Bejkushi me ato vetulla të zeza e bluzë alla partizance, që kishte vrapuar të përçafonte xha Alushin për ato mendimet e tij prej plaku revolucionar. — S'bën asnjë para, — vazhdoi — në qoftë se nuk tregon se ku e kanë burimin gabimet e tij.

Xha Alushi e shikoi të riun pak si i menduar.

— M'u duk sikur e tha edhe burimin, more Bejkush.

— Nuk e tha, jo. Tha vetëm që ka rënë në gabime, se ka menduar gjithnjë që mund t'i kryente më mirë punët me kokë të tij, se sa duke u këshilluar me popullin, po, se ku e ka burimin ky lloj të menduari, nuk e tha.

Përsëri plaku ra në mendime.

— Po si thua ti, paç uratën, ku ta këtë burimin?

— Te mëndjemadhësia, xha Alush. Dhe mëndjemadhësia është sëmundje mikroborgjeze. Shoku kryetar duhet ta kuptojë dhe ta thotë troç se i është rritur mendja dhe se në kokën e tij ka mjaft lakra që duhen kositur... Ka, pastaj, edhe një gjë tjetër — vazhdoi djaloshi. — Populli është zgjuar shumë sot dhe rinia ca më shumë. Kryetar Faslliu e di si bukën që ha se, po t'i shtrojë e t'i bisedojë çështjet me të gjithë ne, do t'i dalin shumë avaze. Këtyre avazeve ai nuk u përgjegjët dot, se nuk ka ecur tamam me kohën, ka mbetur prapa në disa drejtime. Ballafaqimi me popullin do t'ia nxirrte kallain që ruan nën vete ndryshkun. Se populli është si zjarri dhe zjarri e shkrin shpejt kallain. Prandaj shoku kryetar gjen si rrugë më të mirë atë rrugën tjetër, i rri zjarrit larg që të mos i pësojë gjë kallai.

Plaku ia dha të qeshurit:

— Qenke piç ti, s'të paskam njohur. Pa hajde, pa hajde... — dhe e tërhoqi tutje, për në she-shin përpara vatrës së kulturës, ku kishte dalë pjesa më e madhe e kooperativistëve.

Në sallë kishin mbetur pothuaj nja dhjetë veta, përveç atyre të presidiumit që ishin hequr mënjandë e shkëmbenin mendime mbi mbledhjen.

— Sikur mori pak zjarr aty nga fundi — thoshte e kënaqur Mjaftimja.

— Është shpejt akoma, — kundërshtoi përgjegjësi i rinisë — s'kanë filluar të diskutojnë njerëzit. Edhe xha Alushi që i shkrepri një çikëz urët, e pati më tepër pyetje se diskutim. Duhet të diskutojnë, të diskutojnë, të thotë mendimin e tij secili. Vetëm kjo i shoshit punët.

«E paska bërë me vete xha Alushin shoku përgjegjës i rinisë», grihej me vete kryetar Faslliu, që rrinte pak si mënjandë dhe, me sytë gjetkë, dëgjonte e s'përzihej fare në bisedë.

— Si thua ti, shoku Faslli? — e përmendi Mjaftimja.

Ai s'e pati aty mendjen, përpoqi disa herë kapakët e syve si i hutuar dhe diç belbëzoi nëpër dhëmbë.

— S'më dëgjove si duket — qeshi Mjaftimja. — Të pyeta se si e mendon ti çëshjen e diskutimeve. Të diskutojnë të gjithë, apo...

— Të diskutojnë, moj kush i ndalon? — u hodh pa fshehur dot nervozitetin e tij kryetari. — Le të thonë çfarë të duan. Unë s'kam ngrënë kumbulla që të më mpihen dhëmballët.

— Nuk shtrohet çështja ashtu, shoku kryetar — ndërhyri buzëgaz përgjegjësi i rinisë.

Faslliu, sikur mezi kishte pritur rastin që të shfrente zëmërfimin e tij, i doli përpara djaloshit dhe, duke tundur gishtin e dorës me kanosje, iu vërsul:

— Epo qysh shtrohet çështja, thua zotrote? Që ti t'u futësh kunjat njerëzve dhe ata të ngrihen kundër meje e të më diskreditojnë? Që pas-taj ta kesh të lehtë të propozohesh ti në vendin tim?

— Atë e di masa, nuk e dimë unë e ti — ia ktheu seriozisht përgjegjësi i rinisë.

— Masa, masa, shoku përgjegjës i rinisë. Po ajo masa, që thua zotrote, bën edhe si t'i thonë.

Gëzimi u step. Si ishte e mundur që kryetari i kooperativës, me gjithë atë përgjegjësi që i kishte ngarkuar popullit, të shprehte të tilla mendime të pakontrolluara?!

— Ky është kulmi! — thirri pastaj i revoltuar. — Gjer në këtë shkallë paske arritur ti? Unë kam pasur bindjen dhe ta kam thënë shqip d'isa herë se kishe mbetur cazë prapa, por jo kaq sa po tregohesh tani. Me fjalë të tjera, ti je i mendjes se kjo, masa e popullit tonë, s'është gjë tjetër veçse një tufë delesh, të cilën mund ta drejtojë bariu nga të dojë. Ky është kulmi, kulmi. A ka mendim më reaksionar se ky?

Është pak të themi se kjo i ra kryetar Faslliut si ajo bomba që shpërthen në befasi dhe të errëson sytë e të merr vesh e gojë. I ra fytyrës me të dy pëllëmbët e duarve dhe u mbështet për muri, ngaqë, si dukej, as këmbët nuk e mbanin më. Kur mblodhi mendjen, e pa veten të rrethuar nga shokët e presidiumit që mundoheshin me

fjalën e tyre ta qetësonin, ndërsa Gëzimi ishte ulur në një karrige pak më tej dhe, me dorën në faqe, rrinte i menduar.

— Edhe reaksionar më bëre, more djalë? — belbëzoi duke vështruar nga djaloshi me ca sy të turbullt si të një të sëmuri me temperaturë të lartë. — Edhe reaksionar, ë? Ta paça hua!

Gëzimi nuk lëvizi nga pozicioni dhe as pëpëtititi më, ndërsa sekretari i organizatës, që i kishte hedhur dorën në krah Fasllit e po e tërhiqte mënjane, filloi ta merrte me të mirë:

— Nuk të tha reaksionar, shoku Faslli, po ty ashtu ta mori veshi. Gëzimi e pati fjalën tek ai mendimi i gabuar që të shpëtoi ty padashur, se demek populli bën si t'i thonë. «Ky është një mendim reaksionar», tha Gëzimi dhe këtë do të ta kisha thënë unë sikur të mos ish shpejtuar ai të ta thoshte. Po cili nga ne të gjithë nuk shfaqka nganjëherë, në muhabet e sipër, mendime të këtilla? Duhet të jesh i mbaruar që të mos të të shpëtojë asnjëherë ndonjë mendim i shtrembër.

Edhe Mjaftimja që nuk iu nda Fasllit dhe ishte e prekur shumë nga ajo që ngjau u mundua ta qetësonte:

— Pse e merr kështu ti, shoku kryetar? Mos që e paktë ajo që më ndodhi mua mbrëmë në mbledhjen e kryesisë me atë fjalën që më shpëtoi: «Gruaja është leshgjatë e mendjeshkurtër»? Ti nuk i vure re se si më shikoi nënkryetari i komitetit. Sikur do të më përpinte të gjallë më shikoi. Vetëm se mendoi që kishte të bënte me një grua në mes të gjithë atyre shokëve dhe e mbylli me dy fjalë: «S'të ka hije ty, shoqe, të flasësh kështu

për gruan». Dy fjalë qenë ato, po, kur i peshon, bien më rëndë nga ato që të tha ty Gëzimi.

Faslliu tundi kokën si me përtim, por kjo ishte shenjë që po bindej më në fund se me të vërtetë ai «axhamí djalë» e kishte fyer rëndë, por jo aq sa të kapërceje nga mendja.

Kjo i ra në sy edhe Mjaftimes që këtë priste për të vazhduar mbledhjen. Ajo pa kooperativistët që po hynin grupe-grupe në sallë dhe thirri e gëzuar:

— Vazhdojmë, shokë!

* * *

Unë isha i bindur se në pjesën e dytë të mbledhjes do të kërciste sherri dhe më vinte plasja, sepse e dija që kjo nuk ishte punë që nderonte kooperativën tonë. Por doli ndryshe. Dhe, të them të drejtën, aty kuptova unë se sa të zonjat janë këto gratë tona edhe në punë politike, sado që një takëm nga ne, si unë e Faslliu për shembull, nuk i kemi fort në defter.

Pa zënë mirë vend të gjithë anëtarët e presidiumit, Mjaftimja u ngrit e shpjegoi se si duhej të respektonim rregullat e mbledhjes, të diskutonim mbi ato çështje që ishin në rendin e ditës pa u sorollatur andej-këtej në gjëra që s'kishin lidhje me këtë rend dite dhe në diskutimet tona të ishim parimore, kështu tha ajo, domethënë të mos haheshim me njëri-tjetrin për ato çështje personale që s'të japin bukë, po të niseshim nga interesat e kolektivit.

Vura re që e tërë salla e dëgjonte me vë-

mendje. Kaq mirë fliste. Unë për vete time kisha kohë që s'e kisha dëgjuar, se ashtu e pata punën që u largova nga fshati për ca halle që më dolën dhe nuk di pse më dukej sikur nuk kisha përpara Mjaftimen që njihja, atë grua 45 vjeçe, që i ka bërë a s'i ka bërë gjashtë klasë të shtatëvjeçares, po një grua të mësuar që e kishte dërguar partia të na sqaronte mbi shumë gjëra. Femër të tillë që na pat mbërthyer në vend me ato fjalët zjarr dhe na dha të kuptonim se nuk e kishin gabim partizanët që u bënë thirrje edhe grave të rrëmbenit armët e të luftonin krah për krah me ta, mbaj mend vetëm një, në kohën e luftës, po ajo ishte vajzë dhe patjetër do të kishte qenë qytetare me shkollë të madhe.

Më lanë pa mend, sidomos, ato fjalët e reja që përdorte Mjaftimja, fjalë që m'i ka zënë veshi vetëm te njerëz me universitet, ose i lexoj nganjëherë nëpër gazeta e revista. Po kish një të mirë kjo shoqe, që, pas çdo fjale të tillë, shpjegonte edhe kuptimin, kështu që fjalimin e saj s'mbeti njeri pa e marrë vesh, as nënë Zelka, e vetmja anëtare e kooperativës sonë që s'ka mësuar të hedhë as firmën kur merr të ardhurat e vitit. Sa herë që Mjaftimja thoshte nga një fjalë të tillë, unë tundja kokën e shikoja nga xha Alushi, që, me sa kuptohej, edhe ai ishte në një mendje me mua, se mbante gojën hapur e veshët ngrehur, dhe i qeshte fytyra.

Mjaftimja foli nja pesë minuta, po mjaftuan ato të pesë minutat që njerëzit të mblidhnin mendjen e të dinin si të flisnin.

U ngrit i pari Gëzimi në emër të rinisë së kooperativës dhe të gjithë menduan se kushedi

çfarë bombash do të lëshonte kundër kryetarit, kurse ai nuk shkoi fare asaj ane. Foli përkundrazi për punën e hidrocentralit që duhej ngritur me çdo kusht duke shfrytëzuar ujët e përroit. Për shokun Gëzim dhe për rininë kjo ishte një çështje fare e thjeshtë, kurse për ne, të tjerët, ish punë që do na nxirrte shumë telashe. Këtë dyshim na e shtoi edhe më tepër vetë Gëzimi kur hyri në hollësira e tha se hidrocentrali nuk do të ngrihej brenda në përrua, për arsye se përroi ynë, sado që zbret tatëpjetë, s'ka asnjë ujvarë të përshtatshme për hidrocentral, po do të ngrihej brenda në fshat, ku do të sillej uji i përroit me anën e një kanali afër dykilometrash që duhej hapur në vijë të drejtë nga burimi i përroit rrëzë malit gjer në të hyrë të fshatit. Këtu pastaj duhej ndërtuar edhe një rezervuar i madh. Nën vendin ku do të ndërtohej rezervuari është një shkëmb i lartë («Shkëmbi me hundë» i themi ne) që, po të gdhendej ca, do të bëhej vendi më i përshtatshëm për të vendosur qyngjet që do ta lëshonin ujët me teftik ashtu siç e kërkon puna.

Ndërtimi i hidrocentralit brenda në fshat do të kishte dy të mira: E para që s'do të shpenzohim shumë tel e shtylla e filxhanë për shpërndarjen e dritës dhe e dyta që fshatit do t'i vinte ujë me bollëk si për pastrim, ashtu edhe për ujitjen e kopshteve që s'kanë parë ujë në jetën e tyre. Se, ç'është e drejta, ajo fjala që e kemi përroin afër, është një fjalë goje. Afër duket vërtet ai kur e shikon me sy tek i kalon fshatit për anësh, por fshatin e ndan prej tij një bokërrimë që të nxjerr shpirtin më të zbritur e më të ngjitur.

Pati ca kundërshtime në lidhje me hapjen e kanalit si punë që nuk i dilej dot mbanë, po Gëzimi na e mbushi mendjen duke sjellë si shembull kanalën e ujit që patën hapur po nga ky përrua, qindra vjet të shkuar, stërgjyshërit tanë në anën e përtejme të përroit për të vaditur nja 100 dynymë tokë buke që kemi nga ajo anë, dhe që numërohen si hambari i kooperativës sonë.

Çudi është për të bërë vërtet me punën e atij kanali. Është marrë në vijë të drejtë nëpërmes gurësh e shkëmbinjsh që nga vendi ku buron përroi gjer tutje në kufirin e fshatit fqinjë, gati tre kilometra e ca të thuash.

// — Se mos e kishin më lehtë ata të varfërit — tha Gëzimi. — Ata s'kishin as mjetet që kemi ne sot, as organizimin tonë, as diturinë tonë. Të na vijë turp që të mos bëjmë dot ne, të sotmit, një punë që ata e kanë bërë qindra vjet përpara.

Dhe me të vërtetë, si kanal, ne s'do të bënim më shumë nga ç'kishin bërë stërgjyshërit. Ata kishin kthyer ujin e përroit në faqen e malit përtej, ne do ta kthenim përkëtej. Tjetër që sjellja e ujit këtej kishte telashe të tjera, se traseja nga do të shkonte kanali në nja dy vende vinte ca si më të përpjetë. Po për këtë çështje Gëzimi ishte këshilluar me inxhinierë që i dinë mirë këto punë dhe na siguroi se ishte çështje që zgjidhej lehtë.

Pas gjithë këtyre Gëzimi dha edhe ca mendime se nga duhej filluar puna dhe ku mund të gjenim ndihmë për ato gjëra që s'i rregullonim dot vetë. E kishte fjalën, në radhë të parë, të një turbinë, pa të cilën ishte e kotë t'i hyje kësaj pune. Për turbinën ai kish folur me një shok të tij, agronom në rrethin e Korçës, i cili kish rastin

të blinte për llogari të kooperativës sonë, me një çmim fare të arësyeshëm, një turbinë të përdorur, por që me një meremetim të vogël mbaronte punë. Halli ish tani për nja tri a katër qyngje prej gize që mezi gjenden, se janë material që përdoret për punërat e mëdha të shtetit, po edhe këtyre do t'u bëhej dermani.

Sa për tel e filxhanë, kjo ishte punë që rregullohej.

Me një fjalë, përgjegjësi i rinisë i kish llogaritur të gjitha, me kalem në dorë, dhe kaq bukur e shtroi çështjen, sa u mahnitën gra e burra, me përjashtim të Fasliut, që kishte arësytet e tij, dhe të atij qerrata llogaritari që, djalli e dinte se pse, përtypej e gulçonte sa herë që njerëzit duartrokitnin fjalën e Gëzimit.

Ashtu si e shpjegoi punën Gëzimí, ngritja e hidrocentralit na dukej tani të gjithëve si një gjë fare e thjeshtë dhe secili nga ne filloi të ëndërronte se si do të na vinte së shpejti drita, si do të shpëtonim një herë e mirë nga llambat e kandilët me vajguri, si do të zienin radiot derë më derë nga këngët dhe nga lajmet e përditshme.

— Unë do të blej që tani edhe tenxhere me korrent që të mbaron punë — më pëshpëriti mësuesja e shkollës që kisha pranë.

Mësuesja ka lindur e është rritur në qytet, po ka ardhur bashkë me të shoqin, mësues edhe ai, për të bërë nja dy vjet jetë fshati për kalitje.

— Blije! — i thashë, megjithëse vetëm emrin i kisha dëgjuar kësaj lloj tenxhereje.

Mirëpo, kur nisën të tjerët të thoshin fjalën e tyre, nxori secili nga një kleçkë që për pak i rrë-

zuan të gjitha ato që Gëzimi i kishte shtruar si gjëra të sigurta.

Shumicës s'i ishte mbushur mirë mendja ashtu si e kish shpjeguar Gëzimi që ujët të ngjitej më të përpjetë siç ishte rasti në një a dy vende ku do të kalonte kanali.

Kryetar Fasliu, që e shikonte se në këtë pikë kish shumicën e kooperativistëve me vete dhe vinte me mend se kjo ish një arsye që çështja e kanalit të shtyhej edhe për ca kohë, ngriti dorën e kërkoi fjalën.

— Unë jam i mendjes — tha — që të mos nxi-tohemi, se druaj mos bëjmë të vëmë vetullat e nxjerrim sytë. Le të thonë ç'të duan shokët e rinisë, ujët më të përpjetë nuk ngjitet.

— Nuk ngjitet, jo! — u dëgjua një zë nga mesi i sallës, që m'u duk si zëri i Fasliut, i cili sapo kish mbaruar dhe ish ulur në vendin e tij. «Po kjo si bëhet? thashë me vete. Nga na doli ky Fasli në mes të sallës?» Hodha atëhere sytë nga salla dhe pashë që ishte Tosuni af që i përngjante aq shumë në zë Fasliut.

Edhe xha Alushi kish ngritur supet e shikonte i habitur Tosunin. Kuptohej që edhe ai, si unë, e kishte marrë për të Fasliut zërin e llogaritarit.

U ngrit atëhere Gëzimi e na sqaroi. Këtë mesele e paskëshin studjuar e zgjidhur prej shumë kohësh dijetarët. Na përmendi bile një dijetar të vjetër grek me emrin Arqimed, që qenka marrë me këtë çështje dhe paska lënë edhe ligjet e tij që këtu e 3 000 vjet të shkuar. Si shembull që na mbushi me të vërtetë mendjen dhe u mbylli gojën edhe Fasliut e Tosunit, Gëzimi solli punën e sha-

tërvanëve që e hedhin ujët njëzet metra per-pjetë.

Me kaq thamë se çështja mori fund. Kur ja, prapë, na del një mesele tjetër. Këtë radhë ish vetë llogaritar Tosuní që u ngrit për të turbulluar ujët.

«Përsëri ky surrat kërkon të prishë punë!» shfryu me vete xha Alushi. Atij i ishte mbushur mendja top tani se llogaritar Tosuni e kryetar Faslliu ishin lidhur në fjalë, kushedi për çfarë djall qëllimesh, që t'i dilnin kundër rinisë me çdo kusht dhe gati sa nuk e mbajti për paltoje Tosunin kur u ngrit të fliste. E pashë plakun tek mblodhi buzët e shikoi llogaritarin me kaq urrejtje, sa thashë se do t'ia ngjeshte me pëllëmbë dhe m'u desh t'i bëja shenjë nga larg që të mbante veten.

Mirëpo ai i mallëkuar Tosun ngriti një çështje që, sikur ta kish ngritur njeri tjetër, do të na kish bërë të ndërronim mendje edhe unë e Alushi.

Në fillim, si ne të dy, ashtu edhe shumë shokë e shoqe, po sidomos ata të rinisë, e morëm me inat dhe, me gjithë rregullat e prera që kishte vënë Mjaftimja, ia premë nja dy herë fjalën. Ne, ama, kishim të drejtë t'ia punonim kështu Tosunin, se zotëria e tij, duke qeshur e shtrembëruar buzët, e nisi diskutimin me lloj-lloj thumbash për shokun Gëzim. Dhe Mjaftimja, së cilës nuk ia ha qeni shkopin lehtë, bëri mirë që nuk e la të grinte:

— Ti, shok, — i tha — në qoftë se kërkon të diskutosh, diskuto si njeri dhe lëri thumbat e romuzet, se thumbat e romuzet janë mbeturina

mikroborgjeze. Ndryshe, masa e ka në dorë të ta heqë të drejtën e fjalës kur të dojë.

E pa atëhere Tosuni që me shoqen s'bëhej shaka dhe ia nisi shtruar:

— Unë, shokë, kam një vërejtje tjetër: Të gjithë jeni të mendimit, besoj, se pa dritë elektrike mund të bëjmë, siç e kanë bërë edhe pleqtë, por pa bukë nuk e bëjmë dot. Prandaj pyes: Në qoftë se do të shkojmë me mendjen e atij shokut atje — Tosuni tregoi me gisht Gëzimin, pa ia përmendur emrin — dhe t'ia ndërrojmë shtratin përroit, domethënë ta sjellim kësaj ane, si do t'u vejë halli atyre 100 dynymëve tokë buke që marrin ujë nga ky përrua?

Kaq qe pyetja e llogaritar Tosunit, po ajo i vuri në mendim njerëzit. Si djallin nuk i ra ndër mend asnjërit kjo çështje që ishte e para e të parave? Filluan tutje e tëhu pëshpëritjet dhe këto pëshpëritje nuk ishin kundër Tosunit, po vinin në vëshim ato që kishte shtruar aq mirë Gëzimi.

Edhe nja dy a tre që folën pas Tosunit morën anën e tij. Salla, pastaj, ra në heshtje. Disa i mbanin kokët ulur, të tjerë shikonin nga presidiumi dhe sytë ia kishin ngulur Gëzimit duke pritur se ç'përgjegje do t'i jepte ky llogaritar Tosunit. Po Gëzimi diç po shënonte me laps në blokun që mbante përpara dhe dukej sikur s'çante fare kokën për ato që pëshpëriteshin.

Heshtjen e prishi xha Alushi:

— Të themi atë që është — tha. — Pyetja që bëri ky kungulli këtu është pyetje me vend. Bile është një pyetje që duhej bërë që në fillim dhe duhej ta kishim bërë ne, të vjetërit, që ia dimë kimetin tokës më mirë se ky. Po ja që ky

doli më i zgjuar nga ne të gjithë. Tani le të na e shpjegojë Gëzimi: Është menduar apo s'është menduar puna e arave përtej përroit? Në qoftë se po, mirë. Përndryshe, është e kotë t'i futemi punës. Se, të themi atë që është, në qoftë se i heqim ujët tokës përtej përroit, ajo mbetet shterpë dhe ne lajmë duart prej saj. Se s'ka thënë kot ai i pari që toka pa ujë është si gruaja pa burrë. Sa për elektrikun, s'do mend që ai është i nevojshëm, po edhe pa bukë nuk e bëjmë dot. Vetëm në këtë pikë bashkohem unë me Tosunin, pa, sa për të tjerat, e di që ky i bie vrangallës.

Në sallë ia dhanë të qeshurit me fjalën «vrangallë» dhe kushedi sa kohë do të kishin vazhduar kështu, po Gëzimi nuk u dha rast. U ngrit duke qeshur edhe ai, si të gjithë, dhe, si mori lejën e fjalës nga Mjaftimja, iu drejtua xha Alushit:

— Ndonëse më i shkuari në moshë, ti, xha Alush, na kupton mirë ne, të rinjtë. Ne, vërtet, jemi ca si të rrëmbyer, ashtu siç keni qenë edhe ju, besoj, kur ishit në moshën tonë, po në gabime që t'i kushtojnë shtrenjt popullit nuk biem. Nuk biem në gabime të tilla për dy arsye: E para se kemi eksperiencën tuaj rrugën plot suksese, po edhe me gabime që kemi bërë ju gjer më sot, dhe e dyta se patëm fatin të mësojmë në shkollë që ju nuk i kishit. Të vijnë tani tek ajo pyetja e shokut Tosun se si do t'u vejë halli atyre 100 dynmëve tokë që ujiten me ujët e përroit, kur përroin t'ia kthejmë hidrocentralit. Pyetja, s'do mend, që është me shumë vend. Po a është e mundur që ne, rinia, të mos e kemi menduar këtë çështje përpara se të bënim propozimin tonë për ngritjen e hidrocentralit?! Jo, shokë. Kjo s'është

e mundur, sepse edhe ne, si gjithë ju, preokupohe mi për të gjitha hallet dhe nevojat e popullit. Dhe në qoftë se ne kërkohmë që t'i sjellim dritë fshatit me çdo kusht, kjo nuk do të thotë se jemi të mendimit që mjafton të kemi dritë, pa edhe pa bukë le të mbetemi. Prova që ne kemi hapur me aksionet tona disa hektarë tokë buke në vende ku s'gjitet dot as kau, tregon se buka e popullit nuk na ka preokupuar më pak se drita elektrike dhe të tjerat...

Gëzimi, me sa më thoshte mua mendja, e bëri me qëllim që nuk ia dha përgjegjen Tosunit që në fillim, po na la e bëmë një copë herë fjalë. Dësh të tregonte edhe një herë, me këtë rast, që ta merrte vesh mirë Tosuni se ç'merita kishte rinia e kooperativës, të cilën e përbuz aq shumë zotëria e tij. «Me këto dua të them...» desh të vazhdonte Gëzimi, po xha Alushi nuk e la.

— Do të thuash që i keni menduar të gjitha. U kuptua. Tani thuaje edhe një herë fort atë fjalë dhe t'i japim fund çështjes.

— Po, xha Alush. Të gjitha i kemi menduar. Përroi ka ujë që të ushqejë edhe vijën e vaditjes më atë anë, edhe kanalën e hidrocentralit kësaj ane. Kjo është llogaritur nga inxhinierët. Vetëm se duhen marrë masa që të mos shkojë dëm asnjë pikë ujë siç na ka shkuar gjer më sot. Do të ndërtohet pikë së pari një rezervuar që aty ku buron përroi, i cili, jo vetëm s'do të lërë pikë uji të rrjedhë kot, po do të mbledhë e do të ruajë për në kohë thatësire edhe ujërat e shirave të vjeshtës e të dimrit.

— E more vesh? — iu kthye llogaritar Tosunit xha Alushi.

Tosuni kishte ulur kryet e s'fliste. E kishin djegur shumë ata thumbat që i kishte hedhur plaku gjatë mbledhjes dhe dukej sikur kish frikë mos ai i nxirrte në shesh ndonjë të palarë.

— Hë de, folë! — vazhdoi ta ngacmonte plaku.

— S'më mbushet, xha Alush, të them të drejtën — mërmëriti urtë e butë Tosuni, ndonëse nga sytë dukej që ziente përbrenda si kazan.

— S'të mbushet, ë? Po sikur të na i jepte Faslliu yt shpjegimet që na dha Gëzimi, do të të mbushej thua?

Plaku s'kish ndër mend ta mbyllte këtë muhabet, megjithëse Tosuni s'i jepte rast, por Mjaftimja e pa që po prishej rregulli dhe ndërhyri duke pyetur:

— A ka njeri ndonjë vërejtje në lidhje me shpjegimet e shokut Gëzim?

— Dakord, dakord! — thirrën nga të gjitha anët, kurse rinia shpërtheu, siç thonë gazetarët, në duartrokitje të fuqishme.

U vendos që punimet për hapjen e kanalit të fillonin më të hyrë të vjeshtës së tretë, ditën që do të çelej edhe Kongresi V i Partisë, atëhere kur mbarojnë të vjelat dhe punët e bujqësisë s'kërkojnë shumë krahë pune. Kanalën do ta merrte si aksion rinia e fshatit, po Gëzimi tha se patjetër asaj do t'i vinin në ndihmë edhe të rinjtë e të rejat e fshatrave të tjera fqinje.

«Me kaq mbledhja mori fund», mendova unë. Në këtë mendje kishte qenë edhe xha Alushi, siç më tregoi kur u takuam. Ishim ndarë në fjalë që, pas mbledhjes, t'ia thoshim me nga një dopio raki Skrapari nga ajo që i kishte dërguar një mik i tij dhe mezi prishim që të mbaronte. «Qe me fat,

pastaj, edhe i varfëri Faslli, thashë me vete, që zgjati kaq shumë puna e hidrocentralit, se ajo na e largoi mendjen nga ato të metat që përmendi ai në autokritikën e tij. Ndryshe, sikur të kishin pasur kohë kooperativistët të fillonin nga kritikata, kushedi ç'kusure të tjera do t'i nxirrnin Faslliut dhe atëhere ish e sigurt që as darka s'do të na shkulte dot nga mbledhja».

Nxora bële rutinë e duhanit dhe fillova të dredhja cigaren që ta kisha gati për të ndezur, kur dëgjoj Mjaftimen që po thërret nga presidiumi:

— Qetësi, shokë! Jemi në mbledhje këtu, apo në dyqanet e MAPO-s?

Dhe u hoqi vërejtjen disave që kishin filluar të lëviznin nga vendi.

S'dua t'ju mbaj shumë me ato që u thanë për kryetar Faslliun në vazhdimin e mbledhjes. Vetëm do t'ju sqaroj se nuk ishin të gjitha të vërteta. Patí, përshembull, ndonjë që i ngjiti edhe titullin «kulak». Dhe qe me të vërtetë e habitshme që kryetar Faslli, ndryshe nga ç'e ka zakon, e dëgjoj pa bërë gëk edhe këtë fjalë. Vetëm se patí kush t'i dilte zot. U ngrit vetë sekretari i organizatës, shoku Riza, dhe me ca fjalë që s'i kisha dëgjuar ndonjëherë nga goja e tij, e mbërtheu me shpatulla në mur atë serbesin që arriti të quante kulak Faslli Gurin.

— Ky është provokacion! — thiri Rizai, pasi shpjegoi hollë e gjatë se nga ç'mendime nisej ai zotëria që na cilësuaka kulak një shok që i dha luftës gjithë ç'pati, që edhe sot në moshën pesëdhjetë e pesë vjeç, vë në shërbim të revolucionit çdo gjë. — Ne, shokë, — vazhdoi Rizai — nisej

nga të tjera mendime, kur kritikojmë tjetrin. Nisemi nga mendimi që ta shpëtojmë shokun nga gabimet e të metat dhe jo t'i bëjmë varrin. Varrin e të tillë shokëve e kërkojnë vetëm armiqtë e revolucionit. Që ta them shkurt, kritika duhet të jetë ashtu siç na porosit Partia, konstruktive, e sigurtë, parimore... Faslliu nuk është pa të meta e gabime. Ça nga këto ai i pohoi edhe vetë. Ai do të mendohet thellë edhe mbi ato të meta që i ngritët ju, me disa nga të cilat, por jo me të gjitha, jam dhe unë dakord. Dhe jam i sigurt, si të gjithë ju, se ai s'do t'i marrë kritikën tona si kritika që i bëhen për inate personale, po për interesin e përgjithshëm dhe atëhere s'ka si të mos përpiqet me mish e me shpirt që t'i ndreqë të metat, se, fundi i fundit, ai, për këtë interes të përgjithshëm është bërë copë gjithë jetën e tij.

Natyrisht këto fjalë të shokut Riza na prekën të gjithë, po ato qenë ballsam i madh për shokun Fasllin, që e kishte humbur fare. Ai priste që Riza t'i jepte kopaçen e fundit, po, kur e pa që ky ia nisi fare ndryshe, u çel në fytyrë si ajo foshnja kur shikon të ëmën dhe zuri ta merrte veten.

Shumë u gëzua llogaritar Tosuni, që s'di pse qe shqetësuar aq shumë nga goditjet që kishte pësuar kryetari. Bënte, ç'bënte, Tosuni shtynte me bërri xha Alushin dhe i luante syrin, sikur donte t'i thoshte: «E shikon sa të drejtë kisha?» Plaku heshtëte. S'kishte dyshim që atij iu bë qejfi për Fasllin kur i doli në mbrojtje sekretari i organizatës po edhe atë kënaqësinë e tepruar të llogaritarrit, nuk e duronte dot. Dhe po bëhej gati.

ti jepte ndonjë nga ato përgjegjet që di ai vetë.

Po kënaqësia e Tosunit nuk zgjati shumë. Rizai, pasi foli për anët e mira të Faslliut, që ishin të shumta, vuri pikat edhe mbi dobësitë e tij të vërteta duke hedhur poshtë kritikën pa bazë që i kishin bërë disa. Pastaj i dha Faslliut edhe ca këshilla të mira. Një nga këto ish që Fasliu të mos gënjehej nga ca njerëz që i rrinë afër dhe që i bëjnë qejfin edhe kur s'është në vijë. Këto i tha në mënyrë që të gjithë e kuptuan se ku rrihte çekani.

Llogaritar Tosuni vari veshët e s'lëvizi më nga vendi.

Kapitulli III

S'e kanë keq ata që thonë se kritika është ilaç i hidhur, po të shëron. Kjo u vërtetua edhe në punën e Fasllit tonë. Vetëm se Faslliu nuk e pati aq lehtë. Dy ditë me rradhë që nga ajo e shkretë mbledhje ku hëngri gjithë atë kritikë, nuk vuri kokë në jastëk dhe nuk u shtrua një herë në sofër që të hante bukë në rregull si gjithë njerëzit. Kishte ca kohë që kish pakësuar shumë edhe duhanin, por tani s'ia priste cigarja cigaren, megjithëse ai i mallëkuar i jepte një kollë që i nxirrte shpirtin.

Festimja mundahej me mënyrat e saj t'ia hiqte mërzinë, po, aq sa dëgjonte muri, dëgjonte Faslliu. Vajza nuk kishte guximin t'ia thoshte troç se kjo udhë do ta shpinte në të këqija më të mëdha.

Fasllit filluan t'i shfaqeshin përsëri tani edhe ca sëmundje, të cilat i kish pasur edhe më përpara, por jo aq të theksuara: reumatizma në çapok, mëlçia e zezë dhe një djall dhembje në krahun e mëngjër që duhej të kishte të bënte me zemrën. Po shtratin nuk e zuri dhe për doktor e ilaçe, siç i thoshte e bija, as që çau kokën fare.

— Kjo që është nisur do të bëhet — ia preu shkurt vajzës.

Festimja vuri duart në faqe:

— Ç'thua kështu, baba? Kështu mendonin njerëzit njëherë e një kohë, kurse tani...

Faslliu buzëqeshi me pahir dhe e ndërroi fjalën:

— E pata me shaka, bijë e babait, pa ashtu është vërtet, si thua ti.

— T'i them shokut Riza, atëhere, të lajmërojë lokalitetin për doktor — vazhdoi vajza.

— Për doktor, jo. Nuk ka arritur puna gjer aty.

Faslliu e kuptonte se të gjitha këto kusure që i dolën tani e kishin rrënjën tek ajo e shkretë kritikë që, sipas tij, jo vetëm mëndjen ia kishte sjellë vërdallë, po edhe trupin ia kishte shpuar si me thika. Dhe s'kish udhë tjetër shërimi, veçse t'i vinte gjoksin punës dhe në punë e sipër të ndreqte një e nga një të gjitha ato dobësi e mendime të gabuara që ia kishin përplasur kooperativistët në mbledhjen e përgjithshme. Kjo ish, zaten, edhe porosia që i kishte bërë Rizai dhe te Rizai ai kish një besim që s'e kish te njeri tjetër. Dhe kështu i kish dhënë karar të vepronte. Doli në punë që të nesërmen e mbledhjes, megjithëse e ndjente kokën të rënduar dhe trupin sikur e kish rrahur njeri me dru. Po ajo që një dalje sa për sy e faqe, se në të vërtetë, ai nuk zuri punë me dorë dhe as i doli njeriu në sy duke u druajtur se të gjithë do ta prisnin me këmbë të para.

Festimja, që e kishte dëgjuar vetë gjithë natën të rënkonte e të kollitej me të madhe, u mundua t'i mbushte mendjen që të mos lëvizte nga kre-

vati, po qe e kotë. Ai i kish në majë të gjuhës fjalët «s'e mëson dot veza pulën», që e mbërthenin vajzën në vend.

Ditën e dytë mori guximin të futej në mes të njerëzve, pa le të dilte ku të dilte. Por, sa kapërceu prakun e portës e doli në rrugë, i zuri veshi zërin e Gëzimit tek po i jepte udhëzime një brigade të rinjsh që, me sa kuptohej, ishin zotuar të mbillnin brenda ditës gjysmën e tokave përtej përroit, punë kjo që, sipas Faslliut, kërkonte të paktën dy ditë e gjysmë. U dëgjuan qartë fjalët e fundit të përgjegjësit të rinisë:

— Ta bëjmë fora, shokë! Ta tregojmë në praktikë forcën tonë të pandalshme dhe të bëhemi shembull për gjithë kooperativistët!

Faslliut i ranë si plumb në zemër këto fjalë. «Me mua e ka... tha me vete. Po pse i bie rrotull, more djalë? Pse s'thua më mirë: «T'ia tregojmë grushtin Fasli Gurit?» Dhe ndërroi rrugën që të mos binte në sy të tyre.

Eci një copë herë pa u menduar fare se ku po shkonte e nga do t'ia niste. Ishte i bindur se, jo vetëm të rinjtë, po edhe burrat e gratë e moshës së tij, do ta shikonin tani me sy të shtrembër dhe kushedi çfarë romuzesh mund t'i hidhnin gjatë bisedimeve. Dhe mendohej që të mos takohej me njeri, bile, edhe kur i dilte ndonjëri përpara, mbante kokën ulur e s'i jepte rast për muhabet.

— Mirë mëngjez, shoku kryetar! — dëgjoi nga buza e gardhit përmbi rrugë zërin e një kooperativisti që, për çudi, në vend që të ishte nisur, si gjithë shokët, për në ndonjë nga frontet e punës së kooperativës, i ishte vënë me zell të madh

dynymit të tij individual rreth e rreth shtëpisë.

— Mirë mëngjez! — fu përgjegj ftohtë Faslliu. Po, me vete të tij, filloi të grihej: «Më thotë edhe mirë mëngjez, pa le. Ku e gjeti këtë kurajë ky surrat? Te kritikant që më bënë pardje, domosdo. Me një fjalë, zotërisë së tij i është mbushur mendja që Faslli Gurit i ranë pendët dhe s'guxon më t'ua shtrëngojë frenat kooperativistëve edhe kur i sheh që s'janë në rregull».

Kjo i ndodhi edhe pak më tej, te shtegu që kthen për në arat e kooperativës ndën fshat, dhe i ndodhi me nënë Zelkën. Plaka, me kokën ulur dhe e kredhur si zakonisht në hallet e saj, nuk e vuri re fare kryetarin që i shkoi pranë. Faslliu e shikoi shtrembër dhe diçka i mërmëriti. Ajo ngriti kryet me përtim, i hodhi një vështrim të turbullt nga koka gjer në këmbë dhe, pa i dhënë asnjë përgjegje, vazhdoi udhën.

Faslliut s'iu durua. Nxitoi hapin e i dolí përpara.

— Dale, moj plakë. Ç'të keqe ke parë ti nga unë që ma mban kokën mënjanë?

Nënë Zelka u ndal, fërkoj sytë si të ishte zgjuar atë çast nga gjumi dhe mezi mblodhi mendjen:

— Unë të kem parë të keqe nga ti? Jo, more bir. Ç'është kjo që më thua? Të keqen e pata nga kush e pata unë. E di mirë ti... — dhe nisi të qante.

Vërtet e dinte mirë Faslliu, ashtu si e dimë edhe të gjithë ne, mosha e tij, historinë e hidhur të nënë Zelkës dhe i erdhi keq që u bë shkak e i lëndoi plakës atë plagë që s'do t'i mbyllet kurrë, veçse kur të mbyllë sytë një herë e mirë.

Kishte gëzuar njëherë e një kohë edhe ajo jetë familjeje me shtëpi të hapur, me burrë e me fëmijët. Po qe e shkurtër për plakën ajo jetë. S'ish as dyzet vjeçe kur i ndodhi fatkeqësia e parë. Dhe, «kur nisin fatkeqësitë, hapu derën», thotë një fjalë e vjetër. I vranë djalin plakës, djalin që e kishte shpresën e shtëpisë. Xhandar mezi ish veshur djali për të mbajtur me bukë shtëpinë që ish në ditë të pikës, po kish një zemër e një shpirt që s'pajtohej fare me rrobën që mbante veshur. Qe përzier derëshuari në atë Kryengritjen e flamosur të Fierit, që thoshin se do të shpëtonte varfërinë nga kusuret dhe e pushkatuan vetë i njëmbëdhjetë.

E rëndë qe kjo plagë për nënë Zelkën. Nënë, e thërrisnim ne që atëhere, se ishim njëzet vjet më të rinj. Po ajo nuk u gjunjësua. U bë dorë e dhathtë e të shoqit, të ziut Tahir Likë, që ishte nja dhjetë vjet më i shkuar nga gruaja dhe e kish ngrysur jetën bujk te Kajtaz agai, më zengjini i fshatit. ku, jo vetëm s'kish mbushur një herë barkun me bukë, po ish futur edhe në borxhe gjer në grykë. Pas fatkeqësisë që i ndodhi me djalin, Tahiri ra shumë nga fuqia, kurse agai, sikur këtë rast kishte përgjuar, filloi t'ia shtrëngonte më shumë telvikun plakut.

Zelka e bëri natën ditë për të nxjerrë të shoqin nga e keqja. Lëronte vetë me parmendë të tre dynymët tokë që kishin të tyre. Vetë merrej edhe me bravaret nja nëntë kokë gjithsej, me të cilat siguronte dhallën e beharit e shëllirën e d'imit. E megjithkëtë, ajo ua delte edhe punëve të tjera të shtëpisë, një shtëpi përdhese pak si e

veçuar nga fshati, ku të kishte ënda të hyje nga pastërtia dhe rregulli që mbante e zonja.

E varfër sa s'kish ku të vinte më ish familja e nënë Zelkës, po as asaj, as të shoqit, nuk u ish ndër ndonjëherë zëri për të keq. Përkundrazi. S'kish shtëpi në fshat që të mos i përmendte për mirë, sidomos Zelkën që, sido që ta kishte hallin, s'përtonte e s'kursehej t'u gjendej pranë të tjerëve në fatkeqësitë dhe kusuret që u binin.

Burrë e grua kishin tanë vetëm një vajzë, të bukur që t'i prisje kokën, dhe ish vetëm gëzimi dhe shpresa e kësaj vajze që i mbante gjallë e me kurajë, sido që e kishin pisk. Vajza sapo kish mbushur shtatëmbëdhjetë vjet dhe njerëzit që e kërkonin s'qenë të paktë, po prindërve u ishte ngulur në mendje që t'i gjenin për shok jete ndonjë djalë që s'kish detyrime familjare dhe ta merrnin në shtëpi të tyre. Kështu që, jo vetëm vajza, drita e syve, siç e quanin ata, nuk do t'u delte nga shtëpia, por do t'u shtohet në familje edhe një krah i fortë mashkulli, për të cilin ishin sa të dëshiruar, aq edhe nevojtarë.

Dhe rasti ndoshta do t'u kishte dalë, sikur të mos ish zgjuar shpejt nga gjumi ai lugat Kajtaç aga, që kish lindur për të prishur gëzimin e të tjerëve. I mësoi agai qëllimet e bujkut e të së shoqes dhe e, që të mos i shpëtonte nga thonjtë ajo lule që kishte mbirë në mes të ferrës, se kështu e quante vajzën e Zelkës ai lugat, nxitoi ta kërkonte për një palo qehaja të tij që ta kish pastaj edhe për vete, kjo s'donte mend. Tahir Lika, që ishte burrë me karakter, i mori parasysht të gjitha dhe i dëftu bërryllin agait. Dhe që këtu filloi historia e vuajtjeve dhe e mjerimeve që erdhën e u

përplasën njëra pas tjetrës mbi kurrizin e asaj së mjere Zelkë, që paskësh rrojtur për të vuajtur. Kajtaz agai nxori defterët e borxheve që i detyrohej bujku dhe, meqë ky nuk ish në gjendje t'i lante, gjë që dihej mirë nga agai, e futi në burg, ku edhe vdiq pas nja dy muajsh nga një goditje në zemër. Pas kësaj, erdhí e keqja e dytë e madhe për Zelkë Likën. I shitën në ankand shtëpinë me tre dynymët tokë, me kaun e vetëm dhe nëntë bravaret, që ishin gjithë kapitali i saj. Mbeti kështu në të katër udhët vetëm me atë copë vajzë, pa njeri që t'i hidhte dorën dhe gjithnjë me frikë në zemër po nga ai xhelat Kajtaz aga, që s'kish hequr dorë nga e tija dhe kushedi çfarë rrëngu mund t'i punonte gruas së ve. E pa ngushtë e ngrata dhe s'gjeti dot rrugë tjetër. I gjeti rastin së bijës dhe, siç thotë ajo vetë sa herë që e përmend këte hístori, e vrau me dorën e saj...

Që atëhere nënë Zelkës s'i qeshi më buza. U mbyll në një copë kasolle që i ndërtuam ne, fshati, dhe aty jetoi dhjetë vjet me radhë, e ndarë nga bota si qyqe, pa u ankuar dhe pa i shtrirë dorën njeriut. Vetëm pas çlirimit, kur mori vesh pushkatinin e Kajtaz agait si kriminel lufte — se ai xhelat, përveç të tjerave, qe edhe ballist nga ata të tërbuarit që kíshte vrarë njerëz e u kíshte vënë flakën dhjetëra shtëpive — plaka filloi të bëhej e gjallë, të shihej e të kuvendonte me njerëzit, po edhe atëhere pleksej më shumë me të rinjtë se me ne, të mëdhenjtë. Zaten, për t'i bërë qejfin rinisë, plaka qe nga të parat që hyri në kooperativë kur e krijua më 1959. Faslliu dhe Rizai që e kishin vështirë asokohe për të bindur njerëzit të regjistroheshin, e treguan si she-

mbull nënë Zelkën dhe me këtë bënë punë. Që atëhere plakës i doli namí si përparimtare, pa-
varësisht që asaj s'i ndihej zëri. Në punë e sipër
nënë Zelka u njoh me vajzën e Fasllit, Festimen.
Festimja s'ishte as dymbëdhjetë vejçe atëhere, po i
ati e dërgonte herë pas here në punët e koope-
rativës në vend të së shoqes që e kishte të sëmure
dhe këtë e bënte, jo se kish nevojë për të ardhura,
po për t'u treguar të tjerëve se sa e rëndësishme
ishte pjesmarrja e gjithë fshatit në punën kolektive.

Që kur u pa me Festimen, nënë Zelkës i mbetën
sytë te vajza dhe aq shumë u dashurua me të, sa s'i
durohej dot pa e parë të paktën një herë në ditë.
Gëzohej si çilimí kur e shihte Festimen në qejf
dhe hidhërohej për vdekje kur kjo nuk i kish
punët mirë. Sa më shumë rritej e zbukurohej vajza,
aq më shumë çelej në fytyrë e i rrinte pranë nënë
Zelka. I dridhej buza plakës kur takohej me vajzën
dhe çdo hall e brengë që të kish, vetëm asaj ia
shfaqte. Po edhe Festimja, që ia kish njohur mirë
plagët, nuk i ndahej plakës, veçanërisht që kur i
vdiq e ëma. Sado e rënduar me punët e rinisë e të
kooperativës në njërën anë dhe me të shtëpisë
që i kishin mbetur në kurriz në tjetrën, Festimja
do ta gjente një copë kohë për t'u takuar e për
të këmbyer dy fjalë me plakën që mezi e priste.

Faslliu e kuptonte ku e kishte arësyeën kjo
çmendje e plakës për të bijën. Festimja s'i kish
lënë gjë, si në të parë dhe në sjellje, vajzës fat-
keqe të nënë Zelkës dhe ai, si baba që e kishte
provuar vetë dashurinë e prindit për fëmijën e
vetëm, nuk donte t'ia prishte plakës atë thërrime
ngushëllimi që gjente ajo te Festimja. Dhe heshtte.

— Më shpon këtu, këtu... — rënkoi plaka

dhe shpuri dorën në zemër. — E vrava vetë me dorën time të bukurën e nënës.

— Nuk e vrave ti, jo! — i thirri si me të qortuar Faslliu. — Pse e ngarkon veten kot? E vrau kush e vrau atë. Po ish koha e gogolëve ajo dhe s'kishe ç'ti bëje.

Ai kishte të tjera telashe tani dhe s'e la plakën t'i tregonte nga e para gjer në fund, siç e kish zakon, gjithë historinë e saj.

— Tani ti i ke të tutë gjithë djemtë e vajzat e fshatit, — vazhdoi ai. — Ata të duan e të nderojnë njësoj siç duan e nderojnë prindërit e tyre.

— Më duan, ua marrsha, më duan! — klithi plaka dhe një shkëndijë gëzimi ndriçoi fytyrën e saj gjithë rrudha. — Kam Festimen unë që është sa për të gjithë!

Faslliu e shikoi me keqardhje, po edhe me një farë kënaqësie që ia gjeti zemrën plakës.

— Vetëm me mua — tha — s'i kanë punët mirë këta të rinjtë e sotshëm.

— S'e besoj — mërmëriti me mëdyshje plaka. Pastaj ngriti zërin e vazhdoi: — Po, edhe në e shkelin nganjëherë, s'bëjnë ndonjë faj. Kanë ezhgalet e tyre ata dhe ne s'duhet t'ua presim me sëpatë.

Faslliu ngrysi vetullat. Diku qëllonte plaka me këto që thoshte. E kishte fjalën te rinia e kooperativës në përgjithësi, apo te Festimja?

— Kanë ezhgalet e tyre të rinjtë, mirë thua ti, nënë Zelka, — e ngau fjalën — po edhe unë si kryetar kam hallet e mia dhe s'ua kam borxh gjithë ato të shara e kritika që më bëjnë më të djathtë e më të mëngjër.

— Unë s'i kam dëgjuar ndonjëherë — mohoi plaka.

— S'i ke dëgjuar? Jo, moj! As kritikët e të sharat e tyre pardje në mbledhje nuk i dëgjove?

— Në mbledhje, po. Por më të djethtë e më të mëngjër, jo. — tha prerë plaka duke tundur kryet e habitur. Me mendjen e saj ajo habitej vërtet që kryetar Faslliu s'dinte të gëzonte gjithë ato të mira «që i kishte falur zoti» dhe i hapte punë vetes kot me të rinjtë që s'i kishin asnjë faj.

— Festimja, Festimja të të rrojë ty, ajo pastë fatin siç ka dhe zemrën, pa të gjitha të mirat i ke — e mbylli muhabetin nënë Zelka dhe iku pa e përshëndetur.

Faslliu mbeti një hop më këmbë i menduar: «Përsëri plaka te Festimja e qiti fjalën. Ku ta ketë hallin, ku? Zuri në gojë edhe fatin e saj, pale!»

Bëri disa hapa më tutje me mendjen që s'i rrinte në një vend. Ajo që e dëgjte më shumë ishte çështja nëse do të mbetej apo jo kryetar pas gjithë atyre kritikave që pësoi. Herë e përfytyronte veten të tillë duke dhënë urdhëra ose duke u hequr vërejtjen kooperativistëve që s'ishin në rregull me punën, herë i truar e i përlulur përpara tyre, sikur ishin ata që e urdhëronin. Ja, në hije të rrapit, aty ku fillojnë arat e lëruara për misër, anëtarët e një brigade mbjelljeje po linin rrjetat me bukën e gjellën e drekës dhe po fillonin punën.

Faslliu u kaloi pranë pa ngritur sytë. Ata e përshëndetën ashtu si u erdhi mbarë, po ai lëvizti vetëm kokën, edhe atë me përtim, dhe nuk u tha asnjë fjalë. Iu duk sikur të gjithë e shikuan vëngër, sikur çdo fjalë e tyre ishte me romuz.

Në mes të tyre na u ndodh edhe xha Alushi që kishte shkuar për të rregulluar nja dy branda. Ai e hoqi mënjanë Fasliun dhe i foli hapët:

— Të themi atë që është, burazer. Nuk e ke mirë kështu. Mblidh mendjen e merr frenat në duar si kryetar që je. Ndryshe, do turpërosh edhe veten, edhe ne, vërsën tënde.

Vetëm një Alush mund t'i fliste kaq shpenguar kryetarit tonë. Dhe Fasliu, aq sa i rrefkët ish sjellë me të tjerët që harronin se ndodheshin përpara kryetarit, aq i shtruar ishte me xha Alushin.

— Ç'frena të marr në duar? — tha. — Frenat që m'i bëtë copë-copë ju, pardje, në mbledhje? Mori fund ajo punë tani, Alush.

Xha Alushi u hoq pakëz më të prapë dhe e shikoi tjetrin në bebëzen e syrit;

— Jazëk të qoftë! — thirri pastaj. — Gjer në këtë pikë paske arritur ti? — Do bëje m'firë atëhere t'i dorëzoje çelësat vetë, që sot, sa nuk është vonë. T'u thoshe troç kooperativistëve: «Unë kaq e pata, s'jam i zoti për më tutje. I merrni vetë frenat dhe bëni ç'të doni». Po unë jam i mendjes se ti ke aq fuqi e mendje që të na drejtosh edhe për shumë kohë. Vetëm se duhet të shkundesh nga ato mendime që bluan në kokë, të kesh më shumë besim në veten tënde dhe në kooperativistët që të duan e të çmojnë, prandaj edhe të kritikojnë. More vesh?

Kaq tha xha Alushi dhe s'pritti fare që Fasliu të shpjegohej, po çau e iku për në punë.

Fasliu mbeti vetëm. Ia kishin ngatërruar ca mendjen ato fjalët shul-shqip të xha Alushit. «Po Alushi flet kaluar, tha me vete. S'ka ngrënë në kurriz të tij kopaçe si ato që hëngra unë».

Kishte një plan të tërë pune për të kryer atë ditë, po fuqitë nuk i bënin dhe ai dyshimi që e brente se kooperativistët do ta pritnin me buzë të varura ose me romuz çdo sjellje të tij ia bënte mendjen më çorbë nga ç'e kishte. U kthye për vendi e desh të merrte tatëpjetë rrugës që shpie në arat përtej përroit. Aty ishte fronti kryesor i të mbjellave dhe ai duhej të kontrollonte patjetër, punën, se tek ato ara varej gjithë shpresa për të siguruar në vend bukën e vitit. Mirëpo pikërisht atje ishte grumbulluar pjesa më e madhe e të rinjve me Gëzim Pronjon në krye dhe Faslliu ish i bindur që s'do të ndahej mirë me ta. Ndonëse me pishmanllëk, zbriti pa vështirësi gjer poshtë në përrua. Po, kur mori të përpjetën përtej përroit, këmbët iu prenë dhe fryma filloi t'i zihej. Herët e tjera, në të tilla raste, ai nuk zinte udhë më këmbë, sado mirë të ishte nga shëndeti; ia hipte kalit dhe me atë i binte anembanë kufive të kooperativës nga një front në tjetrin. Kurse sot e kish vështirë të përdorte kalin; edhe kjo i duhej, sipas mendimit të tij, që kooperativistët ta merrnin fare në gazep: «Shikoni, shikoni kryetarin! E ç'na kapardisesh majë dorit, o ditëzi?! Nuk të ra një çikëz hunda nga ata shkopinjë e pardjeshëm?»

Këto mendonte Faslliu duke u munduar të ngjiste të përpjetën. Djersët i shkonin shkule-shkule dhe fryma sa vinte e i mbahej më shumë. Për çudí, ato dhembjet në çapok e në gjithë trupin, që e kishin munduar tërë natën, nuk po i ndjente. Kjo i dha një farë kurajë. «Bëra mirë, tha, që nuk e dëgjova Festimen. Lëvizja është ilaçi më i mirë për sëmundjen. Ndryshe, ajo të vë poshtë dhe atëhere s'ka ç'të të bëjë as mjeku».

Kur i doli së përpjetës në krye, u ul të prehej ca buzë rrugës në një vend pakëz si të ngritur, prej ku shiheshin, njëra nën tjetrën, të gjitha arat nën ujë nga rrëza e malit gjer poshtë buzë përroit. Ndezi një cigare dhe filloi ta thithte me ëndje duke kullotur sytë. Tri pendë qe kthenin për së dyti tokën e lëruar. Pas tyre, grupe të rinjsh thërmonin tokën me shat, të tjerë lessonin. Në disa ara kishin filluar edhe të mbillnin. Poshtë, në një parcelë toke të re, dëgjohej traktori.

Faslliut iu bë qejfi sido që kjo tregonte se, edhe pa atë, punët mund të ecnin. Hodhi pastaj sytë nga fshati përkundrejt. Edhe arat nën fshat zienin nga njerëzit që i kishin hyrë punës me kohë. Në fshat nuk pa asnjë oxhak shtëpie që të nxirrte tym dhe as i zuri syri njerëz që ta shkonin kohën rrugëve kot së koti. Vetëm ai kooperativisti, që e takoi të parin në mëngjez, jepte e merrte rreth dynymit individual herë me kazmë e herë me lopatë.

«Pizevengu», shau me vete Faslliu. Dhe u pëndua që nuk ia bëri samarin copë që aty në vend kur dëgjoji zërin e tij prej kapadaiu! «Mirë mëngjez, shoku kryetar!»

Cigarja që piu gjer në fund i dha pakëz kollë, po edhe ia hoqi ca mërzinë. Koka sikur iu lehtësua dhe mendja filloi t'i punonte tani më qartë. «Xha Alushi nuk më do të keqen, tha me vete. Është burrë me mend dhe di ç'thotë. Edhe plakë Zelka nuk di të gënjejë. Mos jam unë i gabuar që më duket vetja i huaj në mes të kooperativistëve?»

U ngrit e mori udhën drejt për tek ara e parë, më e madhja, ku ishin grumbulluar e punonin me sulm të rinjtë e dy brigadave më të forta,

të brigadës së Gëzimit dhe asaj të Festimes. Faslliu u ndal buzë arës, prapa një radhe gorricash të shartuara, dhe po dëgjonte. Të dy brigadat i kishin shpallur garë njëra-tjetrës se cila prej tyre do të merrte flamurin. Nuk shikoje të ri që të ngrinte kokën nga puna. Dëgjoheshin vetëm zërat e tyre që nxitnin shoqi-shoqin në sulm; ndonjëri kurdiste ndonjë këngë dhe ia merrte bashkë me shokët e shoqet si për të qortuar brigadën tjetër që, gjoja, po mbetej prapa.

Faslliut i zuri veshi këngën:

*Ç'ka Festimja këtë radhë
që s'po zë vendin e parë...*

I mori për të vërteta fjalët e këngës dhe diç u thartua në fytyrë. «Me mua e kanë, tha. Do jetë e mërzitur vajza për çështjen time dhe s'i bën zemra të punojë. Dhe këta përgjuan rastin të tallen me të tamam taní që më panë mua». Kështu mendonte Faslliu, kurse, të rinjtë as që e kishin parë fare. Sytë dhe mendjen ata i kishin mbërthyer te puna.

Sa mbaruan këngën të rinjtë e brigadës së Gëzimit, ia nisën ata të brigadës së Festimes. Këngës ia mori i pari Bejkushi që i thuri vetë aty për aty edhe fjalët:

*Shokë, mos flisni më kot,
me Festën s'ia dilni dot,
se është' bijë partizani;
nga ata që u këndohet nami,
që s'u shkul nga barrikada,
as nga topi e nga granata....*

Në fillim Fasllit sa nuk i shpëtuan lotët, e atij i kish ndodhur tamam ashtu si thoshte kënga. I kish ndodhur në Tiranë ato ditë që luftohej për çlirimin e saj. Ai mbante mend dhe emrin e rrugës ku i kishte ndodhur kjo. Quhej «Rruga mbretnore» atëhere. Ngriti sytë e vuri buzën në gaz dhe qe gati t'i hidhej në qafë atij qerrata Bejkushit që i kishte rënë pikës me atë këngë. Mirëpo iu kujtua mbledhja e dy ditëve të shkuara dhe përnjëherësh ndërroi mendje. Mos vallë ato fjalët «që s'u shkul nga barrikada, as nga topi e nga granata» kishin lidhje me qëndrimin e tij në atë mbledhje? Se ç'është e vërteta, edhe aty Faslliu, tamam si në atë barrikadën e kohës së luftës me gjermanët, nuk u shkul nga mendimet e tij, veçse aty nga fundi, kur e pa që s'kishte udhë tjetër. Rrudhi përsëri vetullat dhe u mat të ikte. Po nuk kishte bërë as dy hapa kur dëgjoji nga prapa zërin e Gëzimit që po e thërriste:

— Urdhëro, shoku kyretar, urdhëro. Ke ardhur tamëm në kohë për të kontrolluar punën.

Kjo qe e papritur për Fasllin. Me gjithë mend ta kishte ky djalë që sillej kaq bukur sot me kryetarin, kurse dy ditë më parë e kish futur të gjallë në varr me ato kritikën e tij të shplara? «Eh, ku ta dish? Djalli i merr vesh këta të rinjtë e sotshëm».

Të gjithë kishin kthyer sytë nga kryetari, që desh, — s'desh, erdhi e u fut në mes të tyre. Thirrja e Gëzimit iu duk e sinqertë Fasllit dhe ai u mundua të tregojë i kënaqur, ndonëse përbrenda grihej nga merakë se mos të rinjtë, që i rrethuan dhe e ftonin secili të kontrollonte parcelën e tij, ia kishin me djallëzi.

Vetëm Festa e Bejkushi rrinin pak si më-njanë, pranë njëri-tjetrit dhe s'pipëtinin fjalë. Po nga fytyra linin të kuptohej që ata ishin në rregull me punën e brigadës së tyre.


— Festimja po e fiton edhe flamurin e kësaj gare — tha Gëzimi. — Asnjë brigadë s'ia del dot asaj, sidomos kur ka Bejkushin për ndihmës...

Kjo duhej të ish e vërtetë. Gëzimi s'kishte kurrë zakon t'i bënte qejfin tjetrit pa arësye. Këtë e dinte mirë Faslliu, por ja që, në vend që të gëzohej nga lëvdatat që dëgjoi për të bijën, ndjeu një si të shpuar në zemër. «Kur ka Bejkushin për ndihmës»... Këto fjalë sikur ia rrezuan gjithë atë gëzim që duhej të ndjente për çupën e tij. «Kur ka Bejkushin për ndihmës... Ç'do të thotë kjo?»

Edhe herë tjetër Faslliut i kishte takuar të shikonte ca gjëra që s'i pëlqenin midis atij djali dhe Festimes, po ish munduar t'i shtypte dyshimet e tij duke u nisur nga çështja që ata i lidhte më shumë puna e brigadës se sa ndonjë qëllim tjetër. Tundi dorën në erë sikur donte të përzinte diçka që po e bezdiste dhe filloi nga biseda me të rinjtë. Mburri punën e pastër të brigadës së Gëzimit si punë me cilësi më të mirë nga ajo e brigadës tjetër, brigadës së Festimes, që, «vërtet ka ecur më përpara, po nuk do t'i ketë kushtuar kujdesin e duhur cilësisë.»

Gëzimi i shtrëngoi dorën. Ish një çështje kjo, për të cilën ai kish bërë fjalë pak më parë me Festimen e Bejkushin, dhe tani, me gojën e vetë kryetarit, po dilte fjala e tij.

— Unë s'jam dakord — thirri Bejkushi. —



Xha Faslliu druhet të mburrë brigadën e Festimes se mos thotë bota se i bën hatrin së bijës, prandaj do t'i nxjerrë domosdo një farë kleçke punës sonë.

Faslliu uli kokën e vuri pak buzën në gaz. «I zgjuar shejtani, tha me vete. Kështu është vërtet». Pastaj u kthye nga Bejkushi.

— Mbase edhe gaboj, more bir. Sy është ky i shkretë. Ju kontrollojeni vetë punën dhe e gjeni fjalën.

Biseda me të rinjtë dhe sjellja e tyre plot respekt ia largoi Faslliu shumë nga ato dyshime që kishte ushqyer gjithë rrugës. E ndjente veten si më të lehtësuar tani si nga mendimet e këqija ashtu edhe nga dhembjet në trup.

U kthye në fshat pasdreke vonë kur dielli kishte filluar të varej nga ana e perëndimit. S'kish lënë front të punës pa vizituar dhe kudo kish gjetur po atë sjellje e respekt që kish gjetur edhe te të rinjtë. U dha të drejtë Alushit e nënë Zekës që ia kishin thënë këto atë mëngjez dhe, për herë të parë, i vuri gishtin kokës seriozisht: «Jam gabim, tha, që më shkon mendja gjithnjë për keq.»

Në shtëpi e priste Festimja, që ish kthyer më përpara. Atë ditë ajo ish nisur në mëngjez herët për në punë dhe i therte në zemër tani tek po shikonte të paprekur gjellën e drekës që ia kishte përgatitur në mbrëmje të atit dhe ia kishte lënë në shpuzë pranë vatrës me qëllim që të mos i ftohej.

Faslliu hyri te dera me çehre të ndryshme nga ajo e mëngjezit, i tha «mirë mbrëma» vajzës dhe u ul në një karrige, nga ato kashtoret me

mbështetëse që njihej si karrigja e tij. Dukej që ishte shumë i lodhur, por jo i vrarë. Përkundrazi.

— S'paske ngrënë as drekë — iu ankua vajza.

— S'kam ngrënë dhe as kam për të ngrënë
- - tha ai.

Vajza vuri re shenjat e kënaqësisë në fytyrën e të atit dhe nuk diti si ta shpjegonte këtë qëndrim të tij.

— Duhet të hash — i tha. — Nuk e sheh se si je rrëgjuar nga fytyra? Është e treta ditë që s'ke vënë gjë në gojë.

— Ashtu është — buzëqeshi Faslliu. — Po ja që njeriu, nganjëherë, paska nevojë më shumë për fjalën e mirë se sa për bukë e gjellë.

Ai ndezi një cigare dhe, duke e thithur herë pas here, i tregoi vajzës përshtypjet e tij të mira që kishte pasur gjithë atë ditë nga kooperativistët.

— Janë njerëz të mirë — tha e gëzuar vajza.
— Edhe kur ankohen e kritikojnë, nuk e bëjnë këtë me qëllim të keq. Kanë hallet e tyre, vështirësitë e tyre, në punë e në jetë, dhe s'kanë ku përplasen më përpara veçse te ti, kryetari..

Faslli Guri dëgjonte i kënaqur fjalët e kësaj «kalamane», siç e quante zakonisht të bijën. A nuk i fliste kështu atij, sot në mëngjez, edhe xha Alushi, që njihet si burri më i pjekur i fshatit? «Kështu tamam!» çuditej me vete Faslliu. Moshën e saj kish ai aty e tridhjetë vjet të shkuar, kur u martua; i hedhur e i gjallë ish në të gjitha, po nga goja, mezi i lidhte fjalët. Kurse e bija... Ehua! I kish shkuar e lënë edhe ata avokatët e njëherë e një kohe, që e shisnin çdo fjalë me para.

— S'ka kënaqësi më të madhe — vazhdoi vajza — se të dish të punosh me njerëzit dhe të fitosh zemrën e tyre.

Dhe i solli si shembull Gëzim Pronjon, që është vërtet i rrëmbyer nganjëherë, po në zb timin e detyrës është i rreptë dhe, megjithatë, i ka bërë aq për vete të rinjtë, sa japin edhe kokën për të. Pse? Se nuk vepron kurrë në kokë të tij. Se i dëgjon vërejtjet dhe kritikën e tyre, i peshon mirë ato, pastaj merr vendim.

S'kishte ndodhur kurrë që Faslli Guri t'u vinte kaq shumë veshin fjalëve të së bijës dhe të mundohej të nxirrte prej tyre ndonjë mësim: «Hë de, ç'i thua ti kësaj? pyeste veten. Një copë vajzë kjo dhe të bën t'i vësh gishtin kokës. Po të tjerët? Kanë ndërruar kohët, kanë ndërruar. Kurse unë vazhdoj t'i bie gozhdës me atë mendjen time të vjetër: «S'e mëson dot veza pulën, jo!»»

Atë natë Faslliu ra shpejt për të fjetur. Vrau një copë herë mendjen mbi gjithë ato që i kishin ndodhur ditët e fundit, duke u munduar të mos e përjashtonte veten nga rregulli i gjithë njerëzve të tjerë që, kur punojnë, edhe gabojnë; pastaj e zuri gjumi dhe fjeti i qetë tërë natën. Në mëngjez u ngrit herët, hëngri në rregull dhe u nis për në zyrat e kryesisë. Do të takohej me brigadierët e kooperativës, të shikonte përfundimet e garave të djeshme dhe t'u hidhte një sy planeve të ditës. Jo se nuk dinte ç'përmbanin këto plane, po kish qëllim të këshillohej me brigadierët për ca ndryshime që kishte menduar t'u bëheshin.

Brigadierët e pritën shumë mirë. Edhe me ndryshimet që propozoi ai qenë dakord, bile u gëzuan që kryetari i kishte studjuar kaq mirë

punët. E kundërshtuan vetëm në një pikë, që Bejkushi të mos lëviste nga brigada e Festimes siç propozonte kryetari. Vërtet që kryetari e bënte këtë propozim me qëllim që të forcohej njëra nga brigadat që s'i kish punët në rregull, po brigadierët qenë në një mendje që çështja e brigadës së prapambetur të rregullohej me tjetër rrugë. Ndryshe, do të dobësohej shumë brigada e Festimes dhe kësaj do t'i thoshin si i thonë fjalës! «Prish shtëpi e bëj kasolle». Brigadierët, sikur ta bënin me qëllim — të paktën kështu i thoshte mendja Faslliut — ia ngritën në qiell Bejkushin si një nga të rinjtë që i kishte të rallë shokët në kooperativë. Faslliu habitet me vete se si ky djalë, me gjithë ato cilësi të mira që tregonin shokët për të, nuk i kish rënë në sy dhe nga kjo nxirrte si përfundim që ai nuk i njihte mirë njerëzit e kooperativës së tij. Ndoshta këtu e kish pasur fjalën edhe e bija, kur i fliste mbrëmë për Gëzim Pronjon.

Desh, s'desh ai hoqi dorë më në fund nga propozimi i tij që Bejkushi të largohej nga brigada e Festimes, por ato fjalët e mira që i kishin folur shokët për të, sikur ia prishën pakëz qejfin. S'ish për t'u habitur që ata qerratenj të kishin nuhatur ndonjë shenjë simpatie të djaloshit për brigadieren e tij dhe përpiqeshin me këtë rast t'i mbushnin mendjen Faslliut që ata të dy, si brigadierja, edhe ndihmësi, janë lindur për njëri-tjetrin. Por jo! Jo! Çdo gjë mund të pranonte Faslli Guri për t'u ndrequr me të rinjtë, vetëm në këtë pikë s'do të pajtohej sikur edhe për gjuhe ta varnin! Ai e kish dhënë një herë fjalën për vajzën e tij dhe fjala e dhënë s'kthehet më. Këtë çështje ua kishte sqaruar mirë ai edhe Rizait e Gëzimit, që,

me sa dukej, kishin ngrënë më në fund arësye dhe s'po ia përmendnin më.

Çështja që ia sillte mendjen vërdallë Faslliu tani për tani ish se si të gjente fjalën me rininë në lidhje me gjithë ato kritika që iu bënë në mbledhjen e asamblesë, të ndreqte gabimet dhe të fitonte shpejt autoritetin dhe simpatinë që kish gëzuar shumë vjet me radhë në kooperativistët. Po të siguronte këto, më lehtë do ta hidhte përtej edhe atë bela që i kish pjellë me Gëzim Pronjon për punën e fejesës së Festimes. Se, ashtu si mendonte Faslliu, ndryshe është kur të bie autoriteti, të vërsulen të gjithë me të drejtë e pa të drejtë. Dhe ndryshe është kur gëzon autoritet, njerëzit, ca nga drojtja e ca nga turpi, nuk t'i përmendin të gjitha dobësitë.

Nga përshtypjet e dy ditëve me radhë nëpër frontet e ndryshme të punës, Faslliu ish bindur se çështja e autoritetit të tij do të rregullohej shpejt dhe se gjithë ajo zhurmë që qe bërë në mbledhjen e asamblesë do të kalonte në të shkuara e të harruara. Vetëm se këtej e tutje duhej të dinte si të sillej e si të vepronte.

Dhe me të vërtetë, filloi të bënte shumë ndryshime. Këto nuk i bëri lehtë. Shpirti i tij e di se sa vuante përbrenda kur detyrohej të sillej e të vepronte ndryshe nga ç'e kishte pasur zakon. Detyrohej nganjëherë të mbyllte sy e veshë e të pajtohej me kooperativistët, që mendonin ndryshe nga ai, edhe kur ish qind për qind i bindur që kish të drejtë. Tërë inatin pastaj ia përplaste në mbrëmje në shtëpi Festimes, e çila mendohej me të gjitha mënyrat ta qetësonte dhe, shpeshherë, edhe ia delte.

Ndryshimet s'i bëri dot as përnjëherësh Faslliu. po i bëri pak e nga pak. Në çdo çështje mendohej shumë përpara se të jepte urdhër ose të kundërshtonte mendimet e të tjerëve. Hetonte, pyeste, këshillohej, pastaj vendoste. Ecte, si të thuash, si ai njeriu gjysmë i verbër që e kontrollon mirë vendin përpara se të hedhë hapin. Kaq i vëmendshëm ish kur fliste sa edhe me ne, vërsnikët e tij. I maste fjalët para se t'i thoshte.

Brenda tri a katër javëve, në disa sjellje të tij, ne po shikonim një Faslli tjetër nga ai që njihnim, dhe bënim shaka me njëri-tjetrin, sidomos me xha Alushin.

— Mirë thonë që shkopi ka dalë nga derë e xhenetit — mendonte xha Alushi. — I duhej kjo Faslliut.

— Sikur po e kalon masën — kundërshtoja unë. — Po bëhet qengj fare. As kështu s'i ka hëje një kryetari.

Xha Alushi s'lëvizte nga e tija:

— E keqja s'i vjen kurrë njeriut nga urtësia, po nga mendjemadhësia.

Mirë filluan të flisnin tani për Faslliun edhe kooperativistët. Ai s'i priste e s'i përcillte më me sot e me nesër — me fjalë të mira e gur në trastë, si dikur — po u zgjidhte aty për aty punë dhe, kur s'kish mundësi t'ua zgjidhte, mendohej t'i bindte me të mirë se për ç'arësye nuk ish e mundur, duke u treguar nenet e ligjeve e të rregulloreve që vetë populli i ka aprovuar.

Edhe kur shkonte të kontrollonte punën e kooperativistëve dhe kish ndonjë vërejtje për të bërë, nuk u kanosej nga larg, pa i zbritur kalit,

siç bënte në të kaluarën, po ulej këmbëkryq me ta dhe bisedonte shtruar.

Një ndryshim tjetër i madh i Faslliut ish që ai filloi t'u vinte në ndihmë kooperativistëve, nganjëherë edhe me kazmë e me shat, të cilat s'i kish zënë me dorë që kur ish zgjedhur kryetar e këtej. Dhe kjo, jo vetëm e afroi me njerëzit, por rriti shumë edhe respektin e tyre kundrejt tij.

Më në fund edhe me llogaritar Tosunin u vuri një farë kufiri marrëdhënieve aq të ngushta që kish pasur me të, po këtë e bënte me shumë vështirësi, sepse Tosuni, s'di për çfarë djall arësyesh, i qepej si rrodhe e nuk i ndahej.

Një ditë e dëgjova me veshët e mi Faslliun tek i bëri me tërsëllëm:

— Bëj ç'të duash. S'dua të më flasësh më për këtë çështje.

Dhe do ta kishte përzënë nga zyra Tosunin, sikur ky ta kish zgjatur më shumë.

* * *

Me kthesën e kryetarit, edhe punët e kooperativës asaj vere shkuan më mirë. Të korrave, të prashiturave dhe vaditjes së misrave — tri punët më të mëdha të stinës këto, që u pleksën me njëra-tjetrën e s'na llinin të merrnim frymë — ua dolëm në krye me kohë. Rinia që kish hall të fillonte sa më shpejt aksionin e hidrocentralit, e bëri fora fare, po mbi të gjithë u dallua Festimja e Faslliut me brigadën e saj. Ajo e dalluar

kish qenë gjithnjë, po këtë radhë e kish gëzuar shumë kthesa e të atit dhe ky gëzim i dha fuqi e dëshirë më të madhe për punë. Ndoshta shkonte me mend se Faslliu, ashtu si ktheu në çështjen e punës nga kritikë që iu bënë, ashtu do të kthente edhe në atë çështjen tjetër, të fejesës së saj në Ramizaj, që e përcëllonte brenda në zemër.

Nuk mbetej asnjë hap pas saj edhe Bejkushi. Kuptohej që ai shpresonte shumë tani në kthesën e Faslliut. Vajzë e djalë i mori ato ditë edhe gazeta e rrethit, e cila i kish nxjerrë edhe në fotografi të dy bashkë, si dy yje. Gazeta përmendte për mirë edhe shokun Faslli si kryetar që vlerëson kritikën nga poshtë dhe arrin të organizojë mirë punën. Kjo e gëzoi pa masë Faslliun. Vetëm se ajo fotografia e së bijës krah për krah me djalin e botës e vuri në mendim. Në mbrëmje ndezi sherrin me Festimen dhe vetëm kur kjo iu betua që s'kishte dashur vetë, po e kish detyruar fotografi të dilte bashkë me Bejkushin, u qetësua ca.

Aty kuptoi vajza që Faslliu, asaj ane, s'kish ndryshuar fare dhe u dëshpërua shumë, po nuk e tregoi veten as në punë, as në jetën e familjes. Një gjë vetëm kishim vënë re ne, pleqtë, që Festimja, nga ajo ditë e këtej, takohej shpesh e bisedonte më shumë me përgjegjësën e rinisë.

Kapitulli IV

Më të hyrë të vjeshtës së tretë, kur u kishim dhënë fund edhe të vjelave, rinia filloi punimet për çeljen e kanalit, që do t'i jepte fshatit dritë elektrike. Si zemra e rinisë, edhe ajo ditë ish e çelur e plot diell. Gjithë natën kishte rënë një shi i butë, po afër të gdhirit qielli ish hapur dhe një diell i bukur dukej sikur kishte shtrirë tej e përkëtej krahët dhe përkëdhelte arat e mbjella me hasëll, korien përmbi fshat, pemët, shpezët dhe njerëzit. Aty-këtu rrezet e diellit binin mbi xhamat e dritareve që, kur i shikoje, të verbonin sytë. Fshati ziente nga zërat e këngët e të rinjve, që ishin ngritur pa gdhirë dhe me kazma e lopata në krahë drejtoheshin grumbuj-grumbuj për në sheshin e shtatëvjeçares, ku do të mbahej meetingu. Festimes nuk i zinte këmba vend, ngaqë përgjegjësi i rinisë, i cili merrej me fjalimin që do të mbante në meeting, i kishte lënë asaj gjithë përgjegjësinë e organizimit. Ish e ditur që vajzën e ndihmonin edhe të tjerë, sidomos Bejkushi që s'kursehej fare, po Gëzimi, shpresat më të mëdha që meetingu të dilte me sukses, i kishte varur te Festmja. Në meeting s'mbeti kooperativist pa ardhur. Dhe kjo ish gjë që dihej, gjersa aty do të vinin të ftuar edhe nga tri fshatrat fqinje, me të cilat gjer atëhere s'ishim bashkuar në një kooperativë.

Kur u mblodhëm te sheshi i shkollës, pamë gru-

mbullin e të ftuarve, nja dhjetë burra e gra që kishin zënë vend në tribunë bashkë me udhëheqjen e kooperativës sonë. Në nes të tyre edhe babai i të fejuarit të Festimes, Nexhip Ramizi, një burrë i shkuar, flokëbardhë, me pak mustaqe dhe më fytyrë të kuqërreme, pa-rrudha. Ishte veshur si për mik me një palë rröba kadife të zeza dhe me këmishë me jakë të mbyllur. Kasketën, edhe ajo prej kadifeje nga ajo e kostumit, e mbante në dorë dhe, kur bisedonte me ndonjërin nga ata që kishte pranë, vinte buzën në gaz. Veçse mua më ra në sy një gjë tjetër. Faslli Guri, që kish kohë pa u parë me krushkun, nuk i qeshi buza kur u takua me të, Faslliut, që bëhej copë herët e tjera.

— Paska goxha krushk Faslliu — më tha në vesh xha Alushi. që më rrinte në krah.

Unë isha njohur e parë edhe herë tjetër me krushkun dhe s'më bëri ndonjë përshtypje.

— Ashtu është — i përshpërta. — Po ta shohësh në muhabet, pa të thuash.

— Është i muhabetit, thua?

— Edhe i rakisë, në daç.

Xha Alushi u bë më qejf:

— Ndoshta e mban sonte për darkë Faslliu — tha — dhe na fton edhe ne.

— S'besoj — ia ktheva unë.

— Pse?

Unë ngrita supet e s'u përgjegja. Por Alushi nuk m'u nda:

— Ke mësuar ndonjë gjë të re që flet kështu?

— Jo, për kokë të djalit!

— Po pse s'besoni, atëhere, që Faslliu ta mbajë krushkun për darkë? A nuk është kështu zakoni?

— Kështu është, more Alush vëllai, po ja që

Faslliu edhe në këtë pikë mundohet të bëjë reforma. Ka filluar t'i shkurtojë shumë vajtjet e ardhjet.

Plaku ndenji një copë herë i menduar. Dukej që përgjegjja ime s'ia mbushi mendjen.

— S'ia hedh dot Alush Bocëngut, ti! — tha pastaj dhe tundi kokën.

Në këto e sipër kryetar Faslliu lajmëroi me dy fjalë qëllimin e këtij meetingu dhe ia dha fjalën Gëzimit.

Vendi gjëmoi nga thirrjet e duartrokitjet e të rinjve. Vetëm atëhere unë e Alushi hodhëm sytë nga të rinjtë dhe pamë se sa bukur ishin rreshtuar me ato kazmat e lopatat në krahë, që u ndritnin nga dielli. Në mes të tyre na zuri syri edhe një radhë të rinjsh që nuk i njihnim dhe as që arritëm dot të pyesnim se cilët ishin, se atë kohë Gëzimi kishte filluar të fliste. Po këtë na e zgjidhi vetë Gëzimi që me fjalët e tij të para. «Në këtë festë tonën, tha ai, kanë ardhur të gëzojnë bashkë me ne edhe të deleguar nga tri fshatra fqinje. Përveç kësaj, rinia e këtyre fshatrave, në frymën e solidaritetit vëllazëror, na ka dërguar 20 shokë e shoqe vullnetarë që do të punojnë bashkë me ne, në aksionin e parë të madh të kooperativës sonë...»

Pa e mbaruar fjalën Gëzimi, plasën përsëri të thirrurat e duartrokitjet, këtë radhë jo vetëm nga rinia, po edhe nga i gjithë populli, aq sa s'mbetëm prapa ne, të tjerët, as unë e xha Alushi, që jemi ca të përtuar në këto gjëra.

Pas fjalimeve, rinia, ashtu siç ishte në rresht, mori komandë e u kthye nga e djathta dhe, duke ia filluar këngës, u nis për në aksion. Zbritën atëhere nga tribuna e u përziën me popull edhe udhëheqësit e kooperativës bashkë me të ftuarit. Unë e xha Alu-

shi pamë Mjaftimen që u drejtua nga ne dhe na e bëri me sy duke na treguar një djalë të ri me bluzë e pantallona doku, që ecte me hap ushtarak në rreshtin e parë të 20 vullnetarëve fqinjë. Në kokë djalo-shi mbante një bustinë si ato të partizanëve, nën të cilën i dilte një tufë flokësh ngjyrë gështenjë. Kishte ca sy të gjallë e të lëvizur dhe një fytyrë të mbushur, vende-vende si të skuqur nga dielli.

— Është i fejuari i Festimes — tha Mjaftimja duke zgjatur kryet nga xha Alushi.

— Jo, moj! — u habit plaku duke shikuar edhe një herë me kureshtje nga djali. — Pse s'thua që paskemi goxha dhëndërr?

— Se mos e kemi të sigurt — i shpëtoi fjala Mjaftimes. Plaku vërejti vetullat e hodhi sytë nga unë.

«S'ia hedh dot Alush Bocëngut, ti, jo!» më dukej sikur thoshte me atë vështrimin e vretur të tij. Pounuk tha asnjë fjalë. Edhe unë e Mjaftimja heshtëm. Së largu dëgjohej qartë kënga e vullnetarëve:

*Me hapa vigane
ecën, moj rini...*

* * *

“Në kanal puna filloi mirë e me hov të madh. Dhe, si i thonë fjalës, një punë e nisur mirë është gjysmë e mbaruar. Shoku Gëzim, që njihej nga të gjithë si inisiator i aksionit dhe kryente edhe punën e komandantit të shtabit, i kishte parashikuar të gjitha dhe s'kishte lënë masë pa marrë.” I pille mendja si për gjërat e mëdha ashtu edhe për ato më të voglat. Kryesisë së kooperativës, për shembull, nuk i

kishte shkuar ndër mend se në fshatin tonë kishim dy veta që kanë mbaruar prej kohësh ushtrinë dhe aty kanë mësuar nga dy-tre lloj zanatesh, kështu që ata ishin lënë e punonin si kooperativistë të thjeshtë dhe s'merreshin me punë tjetër. Gëzimi foli me kryetarin për këtë çështje dhe e rregulloi që ata një pjesë të punës ta kryenin në kooperativë dhe tjetrën në aksion duke u marrë secili me zanatin e tij. I pari me ca hekurishte të vjetra e dru lisi, rregulloi për bukuri tezgat dhe tri karroca dore që bëjnë secila punën e pesë njerëzve, kurse i dyti ngriti edhe ai me vegla që i çalltisi andej-këtej, një kovaçanë të vogël, ku s'kishte ditë që të mos ndreqte kazma e lopata që u thyeheshin aksionistëve në punë.

Djem e vajza dërmoheshin tërë ditën në punë, nganjëherë edhe natën me fenerë, po Gëzimi e kishte organizuar punën në mënyrë që ata edhe të punonin, edhe të dëfrenin, dhe të mos e ndjenin lodhjen. Punonin e dëfrenin me turne. Kur punonte një palë, të tjerët shikonin ndonjë shfaqje ose dëgjonin korin që këndonte lloj-lloj këngësh të shoqëruara me fisarmonik, sidomos, i jepte dorë për të organizuar mbrëmje vallëzimi që të rinjtë i kishin shumë qejf.

Nga këto mbrëmje për të mbajtur mend është ajo që u organizua më 29 Nëntor. S'do mend që rinia ftoi në këtë mbrëmje edhe disa nga ne. Rizai, Fasliu, Mjaftimja, si përgjegjëse e gruas, dhe unë e Alushi ishim ndër të parët.

Mbrëmja na bëri për vete edhe ne, pleqtë, aq bukur që organizuar. Patí lloj-lloj këngësh nga ato që këndojnë zakonisht të rinjtë, por pati edhe këngë të vendit nga ato që na pikojnë në zemër mua e Alushit. U erdhi radha pastaj recitimeve. Disa të bënin të derdhje lot nga mallëngjimi, disa të

rrembeje dyfekun që atë minutë e t'i thoshe armikut; «Pritmë, qen i qenit!» ose të shkoje nëpër miniera e kombinate e t'u thoshe punëtorëve: «Ju qofsha falë, se, pa ju, s'kish si të arrinte Shqipëria këtu ku ka arritur». Disa të tjerë të bënin të mbaje ijet nga gazi, sidomos njëra prej tyre që fliste për hidrocentralin dhe i lëshonte një thumb të lehtë edhe kryetar Fasllit për atë qëndrimin e tij të dikurshëm, «jo aq revolucionar», në lidhje me këtë çështje.

Pas këtyre erdhi radha e të vallëzuarit. Djem e vajza, çifte-çifte, filluan të kërcenin. Fisarmonikës i binte traktorist Petraqi, që e çante fare. I pari që u ngrit në valle ishte shoku Gëzim me Festimen, pastaj Bejkushi me një nga vajzat e brigadës mike, Xhevahiri me një vajzë të kooperativës sonë, e kështu me radhë. E fundit u ngrit shoqja Mjaftime për të treguar se edhe ne, mosha e shkuar, nuk kemi mbetur prapa në këto gjëra. Kërkoj të kërcente me Fasllin, po ky bëri be që s'dinte. Iu drejtua atëhere Rizait dhe ky s'ia prishi qejfin, bile i kërkoj të falur që nuk e kish marë ai inisiativën, se na qenka rregull, namna, që mashkulli duhet t'i drejtohet femrës dhe jo femra mashkullit. Po Mjaftimes nuk iu bë vonë. Përkundrazi, ajo e zuri në fjalë Rizain duke i përmendur të drejtat e barabarta të gruas me burrin.

Me vallen e parë e të dytë, puna shkoi si jo më mirë, po në të tretën u ngatërrua pakëz. Në mes të çifteve që vinin rrotull duke kërcyer, Fasllit i zuri syri Bejkushin tek po kërcente me Festimen. I kishte hedhur vajzës njëren dorë në bel, kurse me tjetrën kish mbërthyer dorën e saj.

Kërcenin duke vështruar në sy njëri-tjetrin dhe duke pëshpëritur fjalë që vetëm ata i dëgjonin. Nganjëherë vajza ia kryste të qeshurit. Kuptohëj që ai qerrata Bejkush bënte ndonjë shaka të kripur me të.

Faslliu mundohej të mos e jepte veten. Kthehej nga ne dhe fliste për gjëra që s'kishin lidhje fare as me mbrëmjen, as me kooperativën. Por, për ne që ia njohim zakonet, ishte e qartë që ai grihej përbrenda. Vërtet ai kishte besim të madh tek e bija, po edhe këto shenja që shfaqte haptazi ajo në sy të tij e të bashkëfshatarëve s'ishin aspak të mira. Ç'do të thoshte fshati? Ç'do të thoshte krushku kur të merrte vesh?

Unë vë bast që Faslliut, kur ish duke biseduar me ne për gjëra pa kuptim e lidhje, i shfaqej si nëpër mjegull fytyra e Nexhip Ramizit tek tundte kokën me zemërim e i thoshte gjithë romuz: «Ama burrë që paske qenë edhe ti, Faslli Guri! Ku m'i ke ato fjalët që më thoshe se vajza jote s'di të bëjë gjëra jashtë lejes së babaat? Tani e shikon me sy dhe rri e m'i bën sehir».

Kushedi pastaj se ç'gjëra të tjera bluante në kokë Faslliu kur mendonte se aty në sallë ishte edhe vetë dhëndrri, që domosdo, i shikonte të gjitha.

Si e pa që neve na mbetën sytë te Bejkushit me Festimen dhe s'e kishim asnjëri mendjen në ato muhabetet e tij, Faslliu kërkoi leje të ikte, se gjoja ashtu e kishte punën. Por, pa u ngritur nga karrigja, Petraqi ia ndërroi avazin firsamonikës. Çiftet, si ata nxënësit kur bëjnë ushtrime gjimnastikore me bilbil, u ndanë përnjëherësh

dhe sa hap e mbyll sytë, u bashkuan prapë, por jo ashtu siç qenë. Këtë radhë i ra Xhevahiri të kërcente me Festimen. Kërçyen nja dhjetë minuta duke i buzëqeshur njëri-tjetrit e duke biseduar si miq e shokë të ngushtë.

Faslliu e harroi fare lejen që kishte kërkuar nga ne për të ikur dhe mbeti aty gjer në fund si i mbërthyer në karrige. Kur mbaroi vallja, ai u kthye nga ne me një të buzëqeshur që s'tregonte as dëshpërim, as gëzim:

— Si i thoni ju kësaj? — pyeti.

— Kanë ndërruar kohët, Faslli! S'janë më ato që kemi njohur unë e ti — iu përgjegj xha Alushi.

— Ashtu mendon ti, Alush? — pyeti përsëri Faslliu ca si i çelur në fytyrë.

— Ashtu, posi. Pse të mendoj ndryshe? Mjaf-ton që ata janë të zotët e punës e të mësimit dhe të dinë ta lozin edhe këtë, kur ta kërkojë puna. — Plaku ngriti gishtin dhe e lëvizi sikur shtinte me revole.

* * *

Kaq u ishte ngjitur për zemre të rinjve puna e aksionit, sa, edhe kur ktheheshin për të pushuar një copë herë nëpër familjet e tyre, hanin një kafshatë bukë më këmbë dhe vraponin për në kanal.

— Pusho një çikëz, moj vajzë, se u këpute! — i thoshte Faslliu së bijës.

Po ku merreshe vesh me Festimen?

— Jo, baba! Për kokën tënde në lodhem — ia kthente ajo urtë e butë dhe e shikonte në sy e gëzuar, sikur kishte shkuar për të bërë qejf në aksion.

Lëre pastaj se si u përgjegjej të tjerëve që thoshin në sy të saj se nuk duhej marrë aq nxituar puna e aksionit:

— Në qoftë se s'na vini dot në ndihmë, të paktën mos na sabotoni.

Ja, kështu u përgjegjej. Dhe u numëronte punët e shumta që e prisnin rrinë pas asaj të hidrocentralit: disa kilometra xhade që duheshin hapur akoma për të ardhur automobili brenda në fshat; lidhjen e telefonit me lokalitetin që vetëm shtylla kërkonte 200 copë e të tjera. Vinin pastaj me radhë: sharra përtej në pyll, punishtja e frutave dhe mulliri i mfiellit me motor që do të ngriheshin kur të vinte drita e hidrocentralit.

Këtë përgjegje merrnin derë për derë familjet e aksionistëve nga fëmijët e tyre dhe qe e kotë që ta zgjatje fjalën me ta. Ata të mbyllnin gojën me ca pyetje që s'dije si t'u përgjigjeshe. Djalli vetë ishte në këto biseda Bejkushi. «Na qortoni se jemi të nxituar e të rrëmbyer, thoshte ai. Po a nuk i bëni një herë pyetjen vetes suaj se edhe ju, kur ishit në moshën tonë, kështu ju qortonin pleqtë kur iu futët një lufte aq të rëndë e të vështirë siç ishte lufta kundër fashizmit?»

Pak nga pak u pajtuam me këtë qëndrim të rinjve. Puna e tyre e vrullshme në kanal, pa lënë pas dore as atë të kooperativës, na vuri të gjithë në sedër. Sekretari i partisë, Sinani, dhe, sipas orientimeve të tij, edhe kryetar Faslliu, e shfrytëzuan mirë rastin. Bënë një mbledhje me ne, kooperativistët, ku shtruan punën e rinisë si she-mbull që duhej ta merrte secili nga ne në detyrën e tij. Faslliu, bile, gjeti rastin të thellonte edhe ca

më tej autokritikën e tij për qëndrimin e padrejtë që kishte mbajtur kohë më parë ndaj të rinjve. Kjo na bëri të gjithëve të mendonim dhe t'i vinim gjoksin punës më shumë se herët e tjera. Që atëherë, jo vetëm që filluam t'ua dilnim më mirë në krye punëve të kooperativës, po gjenim edhe kohë të vinim në kanal për t'u dhënë nga një dorë të rinjve. Xha Alushi, si zanatçi që është, u vinte në ndihmë me ca këshilla që Gëzimi me shokë i çmonin shumë. Kishte raste kur plaku mbetej me ta gjer në mes të natës, herë me punë, herë duke u treguar ngjarje nga jeta partizane e herë për të parë ato shfaqjet e tyre që i kishte shumë qejf. Ai kish parë shumë herë shfaqje të tilla, edhe më të mira, kur ish mbathës në minierë. Ç'është e vërtetë, atje në minierë shfaqjet bëheshin nëpër salla të mëdha me drita elektrike lloj-lloj ngjyrash dhe nëpër skena që hapeshin e mbylleshin vetë. Edhe grupet që loznin në këto shfaqje visheshin tamam siç e kërkonte rasti: partizani si partizan, punëtori si punëtor, gjermani e italiani me uniformat e tyre që të kallnin tmerrin dhe kryetari i ballit me çizme të verdha, me sahat të florinjtë në xhepin e jelekut dhe me kamxhik lëkure në dorë, tamam si Kajtaz agai që patëm ne në fshat. Megjithatë, plakut i pëlqenin shumë këto shfaqjet e të rinjve tanë, e para se i nxirrnin mallin e kohës partizane, që e ngrinin teatrin mu në mes të pyllit me ca batanie që i varnin në degë të lisit dhe e dyta se këta qerratenj loznin gjithnjë gjëra që kishin të bënin me ca nga ato zakonet tona të këqija, të cilat xha Alushi, ndryshe nga ne, vërsnikët e tij, i lufton për vdekje.



Kapitulli V

Kish një muaj e gjysmë plot që puna ecte revan në kanal. Ishin hapur mbi një mijë metra me thellësi një bojë njeriu dhe me gjerësi plot një metër. Dheu që ish hedhur anës përngjante nga larg si dheu i atyre llogoreve që hapin zboristët tanë. Ndihmoi shumë edhe koha, ~~kjo~~ është e vërtetë, se vjeshta te ne vjen zakonisht me llohra e përmytje, kurse vjeshta e atij viti, sikur e kishte porositur rinia me gojë, bëri prill fare. Po koha, me ç'na panë sytë neve, nuk bëri as të njëqindën e asaj që bëri rinia. I kishim njohur djemtë e vajzat e kooperativës sonë në të korra e të prashitura, në të ujitur të mësrit e të zarzavateve dhe në hapjen e 3000 gropave për pemë frutore; i kishim njohur edhe në ndonjë rast tjetër të vështirë, siç qe ai i vjeshtës së shkuar, fjala vjen, kur na zuri bora bagëtitë, që s'qenë dirrur¹⁾ akoma nga mali dhe qenë në rrezik të ngordhnin njëqind e ca shqerra që posa kishin lindur. Sa ra bobla²⁾ e parë

1) Zbritja e tufave të bagëtisë nga kullotat malore në vërri.

2) bobël — guaskë deti e madhe që përdoret si instrument frymor. I thonë edhe bri.

në mes të natës, — se boblës i biem ne në raste të tilla — të rinjtë, me djem e me vajza, u ngrihën nga gjumi dhe, me ç'kishin veshur, pa e dëgjuar gjer në fund shokun Riza që u tregoi gjendjen dhe desh t'u bënte thirrje nga ana e partisë, u vërsulën malit nëpër thëllim dhe, brenda tri orëve, u kthye secili me nga dy shqerra nën sqetull. Bile kishin hequr fanellat e xhaketat e tyre për të mbështjellë shqerrat. Qysh nga ajo natë, edhe unë, që s'kisha aq besim të madh te të rinjtë, se ma kishin thyer zemrën me ca çapkënllëqe, që, fundi i fundit, ishin çapkënllëqe të moshës, bëj bërë për kokën e tyre.

I kishim njohur, siç thashë, në shumë raste, djemtë e vajzat tona, po në një punë të tillë siç ishte ajo e kanalit, që kërkonte krahë të fuqishëm e djersë me gjyma, nuk i kishim provuar. Dhe ja që edhe këtu ata e treguan se janë me të vërtetë për t'u pirë dollinë.

Më takonte të shkruaja nga një libër më vete për secilin dhe prapë të mos lahesha me ta, aq mirë kanë punuar që të gjithë, po kjo kërkon kohë, kërkon edhe zanat, kurse unë s'kam as një-rën nga të dyja. Dhe, dua, s'dua, do të bëj fjalë vetëm për ata që, edhe sot e kësaj dite i mban fshati në gojë. I tillë është ndër të tjerët Bejkush Alemi, për të cilin s'ma kish pritur mendja jo vetëm mua, po gjithë ne, të rriturve, që do të dilte kaq i fortë. Është i gjallë dhe i përpjekur, ashtu si shkruante për të gazeta, kur e mori bashkë me Festimen, po vjen i pakët nga trupi dhe të duket çudi kur e shikon në punë tek ngre, sikur

lot, një vare të rëndë dhe me dy të rëna, e bën copë shkëmbin që i del përpara.

— Të nxjerr apo s'të nxjerr mallin e Alemit?
— thotë xha Alushí.

Alemi ishte babai i Bejkushit, një burrë i gjatë e thatim, por mjeshtër i mbaruar në të përdorurit e varesë, të qysqisë dhe të kazmës. Alemi nuk kishte as një pëllëmbë tokë të tij dhe, për të nxjerrë koromanen e fëmijëve, u robëtua tërë jetën duke hapur tokë të re për llogari të Kajtaz agait me shokë, në ato këmbët e malit përtej përroit, që kanë qenë shkëmb e mbrete me rrënjët dy pashë thellë dhe që tani janë gëzimi i fshatit. Pas çlirimit, kur u bë reforma agrare, një pjesë të atyre arave ía dhamë të zotit, domethënë babait të Bejkushit, që i kishte hapur me krahët e tij... Këtë e bëmë më tepër për inat të ish-agallarëve të tij, pa, sipas ligjit, atij i takonin më pak. Ca kohë më pas krijuam kooperativën dhe Alemi që i pari që i bashkoi arat me ato të të tjerëve. Ai nuk rrojti gjatë që të kishte gëzuar të mirat që na solli kooperativa, po të paktën vdiq me dëshirën të plotësuar dhe me mendjen të fjetur për jetën e djalit e të së shoqes, që, vërtet s'kishin njeri tjetër të tyre, po kishin partinë dhe pushtetin që vlenin sa për njëmijë. Dhe këtë e tregoi koha. Bejkushi taní numërohet nga më të mirët e djemve në fshatin tonë, si nga puna, ashtu edhe nga mendja e nga sjellja. Së shpejti edhe atë, si Festimen, do ta propozojnë për

kandidat partie. Dhe ne jemi të sigurt se kjo e ka bërë që të mos ndjejë të lodhur e të mos dijë ç'është prehja. Shoku Gëzim, që, si përgjegjës i rinisë, kujdeset shumë edhe për dëfrimin dhe prehjen e shokëve e të shoqeve, i ka hequr disa herë vërejtjen Bejkushit për punë të tepruar, por ai s'vë mend. Ka pasur edhe raste kur ky i ka bërë bënë në të rreme Gëzimit se gjoja kish fjetur e kishte pushuar më shumë nga të tjerët, kurse në të vërtetë e kish kaluar gjithë natën në punë për t'i dalë mbanë një zotimi që kish marrë dhe që s'qe e mundur ta kryente gjatë ditës.

Dy-tri ditët e para në kanal gjithë atë fuqi të Bejkushit që punonte jashtë masës e s'lodhej, unë me xha Alushin e Faslliuin e shpjegonim me atë që në fillim kështu e ka çdo punë që merret me sevda dhe thoshim se kjo s'kishte për të zgjatur. Mirëpo dolëm të gënjyer. Puna në kanal, siç thashë, kish një muaj e gjysmë që vazhdonte, po prapë Bejkushi, jo që nuk e kishte pakësuar vrullin, po edhe e kishte rritur më shumë. Këtë e pamë vetë me sy unë e xha Alushi. Kish ardhur me ne atë ditë, për të punuar nja dy orë, edhe Faslliu që vinte më rrallë. Qe një nga ato ditë ajo që s'do të na harrohet kurrë. Ndonëse mes i dhjetorit, dita ish e ngrohtë dhe dielli digjte të thuash si në prill a në maj. Ne kishim ardhur me ca vonesë në kanal, kurse Bejkushi me shokë kishte filluar nga puna që pa zbardhur. Kish afër dy orë që ai ishte qepur me kunja hekuri e me vare një cope shkëmbi që nuk thërmohej lehtë. Po e kish vënë përpara punën, kundër mendimit që kishin shfaqur të tjerët se kësaj pune nuk i dilej dot pa

mina. I ish bërë qejfi që po delte fjala e tij dhe kaq ish dhënë pas asaj pjese të shkëmbit që i kish mbetur, sa s'na vuri re fare ne që i fshim afruar e po e shikonim. Nja 10 a 15 metra më tutje rrëmihnin me kazma, shkulin gurë e i hidhnin buzës së kanalit Festimja me katër shokë. Herë pas here ata, po më shumë Festimja, hidhnin sytë nga Bejkushi dhe tundnin kokën sikur kishin ndonjë ankim në të.

— Puna mbarë! — thirri xha Alushi duke mbajtur lopatën përpara fytyrës për t'u mbrojtur nga copat e shkëmbit që vërtiteshin andej-këtej si copa granate.

— Mbarë paç! — u përziegj Bejkushi pa ngritur kokën.

U kuptua që nuk e njohu plakun nga zëri. Ndryshe, ish e pamundur që ai të mos i hidhte sytë e t'i buzëqeshte. Se, që nga ajo mbledhje e dikurshme e asamblesë që kritikoi kryetarin, është m'fijësuar shumë me xha Alushin dhe e di që ky u vë re këtyre gjërave.

Unë e Faslliu nuk hapëm gojë. Vumë lopatat përpara fytyrës si xha Alushi që të mbroheshim nga copat e gurëve dhe po i vështronim si të hutuar.

Me ballin rrudhur e me sytë mbyllur përgjysmë, që nuk i hiqte asnjëherë nga shkëmbi, Bejkushi qëllonte në të si i xhindosur. Sa herë që ngrinte krahët për të qëlluar, merrte frymë thellë dhe, kur qëllonte, nxirrte një «ëh» të fortë, sikur shfren-te inatin te ndonjë armik. I qeshte fytyra dhe hapte për një hop sytë i gëzuar, kur shikonte ndo-

një copë të madhe shkëmbi që niste të lëkundej, domethënë të dorëzohej.

Kullonte i tëri në djersë që nga koka gjer te këmbët. Ish veshur vetëm me kanotiere e pantallona doku dhe ato pjesë të trupit që ia zinte diell dhe që nxinin si të ndonjë arapi shndritnin në diell si a! shkëmbi pllakë i larë nga shiu.

— Kështu i pret mysafirët ti, Bejko? — bëri shaka xha Alushi dhe diçka desh të thoshte akoma, por atë çast, një copë gur që u shkëput me forcë nga shkëmbi, erdhi e i ra mu në cep të syrit të djathtë.

Ne s'e patëm mendjen asnjëri te djali dhe vetëm kur pamë gjakun që i plasi e po i mbulonte fytyrën, hodhëm lopatat dhe u vërsulëm drejt tij.

— U vrave! — briti me duar në kokë plaku dhe aq shumë u prek, sa nuk e kisha parë kurrë të zverdhej në fytyrë dhe t'i merrej goja kur fliste.

Britmën e dëgjuan edhe Festimja e ata katër shokët që punonin më tej dhe ajo që e para që arriti në vend. E prekur dhe e dëshpëruar sa s'bëhet ajo nxori shpejt e shpejt nga xhepi i bluzës një shami të vockël me lule dhe filloi t'i fshinte gjakun Bejkushit.

— Duhan! Duhan! — e përsëriti nja dy herë fjalën xha Alushi duke kërkuar në gji e nëpër xhepa kutinë e duhanit, që s'po e gjente dot.

Festimja i mbante me njërën dorë kokën djaloshit, kurse me tjetrën vazhdonte t'i fshinte gjakun, po shamia u qull e tëra dhe gjakut s'po i bëhej dermani.

— Ujë, shpejt! Dhe sillni sa më parë inter-

mierin! — thírri ajo duke iu drejtuar shokëve.

Dy prej tyre u lëshuan me vrap në drejtime të ndryshme. Në çast ishin grumbulluar rreth djaloshit e po vinin akoma shokë e shoqe me veglat e punës në krahë dhe secili mendohej t'i vinte në ndihmë me ndonjë mënyrë.

«E hëngrëm ne me sy», mendoja unë me vete, po këto fjalë s'guxova t'ia thosha njeriu.

Bejkushi, që u trullos shumë në fillim nga kjo e papritur, kishte hapur syrin e mëngjër tani dhe na shikonte si nëpër gjumë.

— S'kam gjë! Pse e bëni kaq të madhe? — tha pastaj, i dëshpëruar, duke i buzëqeshur vetëm xha Alushit.

— Atë duam edhe ne, more bîr, që të mos kesh gjë — mori frymë plaku.

— Sidomos tí, xha Alush, që na ke treguar gjithë ato gjëra të çuditshme për partizanët, s'duhet të shqetësohesh.

Plaku iu afrua më shumë dhe u ul këmbëkryq pranë tij.

— Ashtu është, djalë i xhaxhait, ashtu. Po ja, të themi atë që është, jemi bërë ca si delikatë tani. S'na e duron zemra të keqen fare.

Në këto e sípër erdhën duke nxituar dy shokë me nga një kabash ujë në dorë dhe bashkë me ta edhe një tjetër me një çantë nga ato të infermiereve në sup. Edhe ky, me pantallona doku e kano-tiere ish veshur, si shumica, po, ndryshe nga të tjerët; mbante në kokë një kashtore të madhe sí ato të vietnamezëve që kemi parë në film, dhe kishte edhe sahat dore.

— Cili është ky? — pyeta në vesh Fasllun.

— S'ma ka zënë syri ndonjëherë këtë infermier.
— Dhe me të vërtetë, ashtu si ish ndërruar ai, m'u duk si fytyrë që s'e kisha parë kurrë. Fasliu uli sytë e m'u përgjegj sí me të përtypur:

— Si s'ta ka zënë? Ka kohë që punon këtu. Është djali i Nexhip Ramizit.

Ky i lau më përpara fytyrën me ujë Bejkushit dhe atëhere u duk në cep të syrit të tij të djathtë një e çarë e thellë sa të futje gishtin. Syrin e vrrarë Bejkushi s'e hapte dot.

— S'duhet të ketë pësuar gjë, — tha infermieri — po, për çdo rast, duhet ta nisim Bejkon për në spital. — Dhe i rrahu supet të plagosurit me shumë dashuri.

Hapi pastaj çantën e nxori gjithë ç'duhej: pambuk, jodio, fasho. Ia leu e ia lidhi plagën me kujdes dhe, kur mbaroi, iu drejtua Festimes:

— Si thua ti, shoqja brigadiere? Në spital s'besoj ta mbajnë Bejkon, po ne e kemi për detyrë ta nisim. Për çdo rast.

— Në këto punë të kemi ty komandant — qeshi vajza.

— Ç'komandant, moj! — turfulloi Bejkushi. — I bëni hesapet pa hanxhiun, si duket, t'i e Xhevoja.

Xhevahir e kishte emrin infermieri, po Bejkushi e thërriste Xhevo me përkëdhelje.

Unë, që e dija si qëndronte puna e këtij djali me Festimen e me Bejkushin, habitësja me vete: «Tjetër botë kjo e këtyre. T'i kishte ndodhur ndonjërit nga neve kjo që i ndodhi këtij, s'do t'ia hidhnim për kiamet sytë as vajzës, as atij që do ajo. Pa le që, po të ishin kohëra të tjera, mund të

lëvonte edhe plumbi. Kurse ky as që e ka për gjë...»

— Nuk shkoj në spital unë, jo! — thirri përsëri me fjalë më të prera Bejkushí. — E ka gabim Xhevoja. Apo jo, vëllaçko? — iu kthye ai Xhevahirít.

— Epo mirë, atëhere. E lëmë që të vendosë organizata — hoqi në zemër Festimja. — Ku është Gëzimi? — pyeti pastaj, si me hakërrim, duke shikuar nga Xhevahiri.

— Ai ka dy net që s'vjen në shtëpi — shpjegoi Xhevoja, që strehohej në familjen e Gëzimit.

— Po shoku Riza?

— Edhe Rizai, më duket, me Gëzimin ka shkuar.

Kjo ish e vërtetë. Si sekretari i organizatës së partisë, edhe përgjegjësi i rinisë, kishin dy ditë që mungonin. Nuk vura re se cili nga të rinjtë tha se i kishte dëgjuar të bisedonin për punën e qyngjeve dhe të turbinës që ish ngatërruar mjaft dhe kish rrezik të mos na i jepnin fare. //

— Kanë shkuar në lokalitet' — tha Faslliu që, gjer atëhere, kish ndenjtur si i humbur në mendime dhe nuk kishte hapur gojë.

Me t'i përmendur Festimja organizatën, Bejkushí e mbylli gojën dhe as që mori më pjesë në bisedime, gjë që tregonte se nuk e kish pritur mirë propozimin e shoqes.

E mërzitur nga kjo gjendje dhe duke parë se rreth e rrotull të plagosurit ishin grumbulluar e po grumbulloheshin akoma më shumë vullnetarë, Festimja u ngrít më këmbë e urdhëroi:

— Njëpër vende, shokë! Të fillojmë nga puna!
Ç'është kjo që bëni?

Djem e vajza u shpërndanë përnjëherësh si ajo tufa e thëllëzave, kur u kalon njeri pranë. Mbetëm me Bejkushin vetëm unë, xha Alushi, Fasliu, Festimja dhe infermieri. Ky e zuri për qafe të dorës të plagosurin dhe, si numëroi një copë herë me vete, duke shikuar sahatin, tha:

— Ka pak temperaturë. Duhet të shtrihet patjetër.

Me gjithë kundërshtimet e Bejkushit, ne e detyruam të shtrihej në hije të një gorrice. nja njëqind hapa larg kanalit, duke i premtuar që punën e tij do ta vazhdonim ne, pleqtë.

Bejkushi qeshi.

— Ç'do të thuash? — iu hakërrua gjoja i zemëruar xha Alushi. — Mos të shkon mendja se nuk e bëjmë dot ne, tre burra, punën tënde?

— S'e kam për atë, jo. Por do të lodheni.

— Le të lodhemi, mos na e qaj hallin! — ia ktheu plaku. — Bile, ja ku po ta them, do punojmë në mënyrë që edhe detyrën ta kryejmë, edhe të mos vritemi si ti. Se, t'jua them unë juve, të rinjve, ju i kini të gjitha të mirat, po, kur punoni, s'e keni mendjen në vend. I futeni punës si të ndërkrयर, pa asnjë kujdes, pa marrë asnjë masë...

Fjalët e xha Alushit, që nisi si me shaka, i bënë përshtypje djaloshit dhe ai po e shikonte tani në dritë të syrit plakun, i vrejtur e i menduar.

— Mos më shiko ashtu, po dëgjomë mirë — u nxeh më shumë plaku. — Më ka djegur xhanin mua ajo çështja e kujdesit që duhet pasur dhe e masave që duhen marrë në këto punë. Kam parë

me sytë e mi shokun më të ngushtë, mbathës edhe ai si unë, që m'u vra në minutë, mu përpara këmbëve. Dhe përse na iku nga duart, në dy minuta e sipër, ai goxha shok, thua ti? Për mendtë e kokës, bir! Se s'kish vënë në kokë atë ditë kapelën e mınatorit siç porosit ligji i sigurimit teknik.

Plaku psherëtiti dhe u rrëmbush në lot.

Pa vajtur mesdita, u kthyen edhe Rizai e Gëzimi. Ata erdhën tërë qejf. Kishin vënë në vijë punën e turbinës e të qyngjeve, për të cilat qenë shqetësuar shumë kohët e fundit dhe kjo, sipas tyre, kishte qenë hendeku i fundit i kapërcyer që fshati ynë të bëhej së shpejti me dritë. Do të kishin ca vështirësi për sjelljen e materialit nga vendi ku arrinte xhadeja e automobilit, si nja dy kilometra jashtë fshatit, xhade të cilën e kemi çarë prej kohësh, gjer në qendrën e punimeve të kanalit. Po kjo ish punë që ndreqej. Do të hapnim, me këtë rast, edhe ato dy kilometra rrugë që na kishin mbetur dhe do ta sillnin automobilin gjer brenda në fshat. Kështu që do të kishim dy gëzime bashkë, gëzimin e dritës dhe atë të borisë së automobilit që do të na kalonte përpara shtëpive. Mirpo, sa morën vesh se ç'i kishte ndodhur Bejkushit, të dy shokëve u iku tërë gëzimi dhe i harruan fare edhe turbinën e qyngjet, edhe borinë e automobilit. Ata erdhën me një frymë në kanal dhe, puna e parë që bënë, dërguan të sillnin ka-

lin e kryetarit me qëllim që ta nísnin Bejkushin për në spitalin e lokalitetit. Andej, pastaj, po të ish nevoja, e kishin të lehtë ta përcillnin menjëherë me maqinë për në Tiranë. Se, ç'është e vërteta, djalit nuk i kishte pushuar akoma gjaku dhe temperatura, që, sipas të thënave të infermierit, sa vinte e i hipte. Dhe kjo nuk ishte shenjë e mirë.

Plagosja e Bejkushit na kishte pikëlluar te gjithë, po puna, megjithatë, vazhdoi njësoj. Unë e Alushi me Fasliun i dhamë fund brenda një ore shkëmbit që kishte lënë përgjysmë Bejkushi dhe, sado që mendjen e sytë i kishim te djali që lëngonte në híje të gorricës, u jepnim duarve dhe ecnim përpara. Këtë e bënim më tepër për të kënaqur djalin, që, e kish si e kish hallin, ngrinte nganjëherë kokën e shikonte nga ne. Po kjo nuk zgjati shumë. Kali i kryetarit erdhí më shpejt nga ç'pritej dhe Bejkushin e hipën dhe e nisën pa humbur kohë. Si për të përshëndetur shokun e tyre të plagosur, vullnetarët ia nisën sulmit me të madhe.

Në gjithë trasenë e kanalit, përpara dhe prapa nesh, kërcisnin kazmat e varetë, venin e vinin me nxitim karrocat e dorës, ngriheshin sí gjëmim furtune thirrjet e të rinjve e të rejave që i jepnin kurajë njëri-tjetrit, të prera tek-tuk nga ndonjë këngë, dhe të gjitha këto, si ajo zhurma e dallgëve të detit kur tërbohet, merrnin përpjetë gërshet e shkëmbinjtë që ngrihen radhë-radhë në gjithë anën e sipërme të kanalit dhe zienín e oshëtinin parreshtur.

— E dëgjoni përroin ju? — na pyeti mua e Fasllium xha Alushi.

— Ç'përrua, a, i varfër! Ku dëgjohet përroi në këtë furtunë? — ia dha përgjegjen Faslliu.

Dhe me të vërtetë, gjithë ai përrua që derdhet me nxitim tatëpjetë nëpër gurë e gropa dhe që herët e tjera të shurdhonte gjer dy kilometra larg, tani, pesëqind metra pranë, nuk dëgjohej fare.

— E ka kuptuar i gjori se ç'e pret, prandaj i ka ulur veshët — bëra shaka unë.

— E di që thua mirë? — e mori me gjithë mend xha Alushi. — U kanë mbyllur gojën dhe lumenjve më të harbuar këta çapajevë — dhe tregoi me kokë skuadrën e të rinjve në të djathtë tonë, që e kishte marrë me aq vrull e potere, sa të dukej sikur kishe përpara një nga ato batalionet partizane kur i vërsuleshin gjermanit me bomba dore e sokëllima brenda në transhetë e tij.

Vullnetarët ishin ndarë në skuadra dhe secila nga këto kishte frontin e saj, jo shumë larg nga të tjerat. Ç'ishin djem, kishin hequr tani edhe kanotieret, kaq shumë ishin nxehur, dhe ne shquanim që aty ku ishim duke punuar, rrëketë e djersës që u shndrinte në lëkurën e tyre të nxirë. Vajzat i dalloje vetëm nga bluzat e pantallonat e gjata që mbanin veshur, kurse nga lëvizjet e shpejta dhe nga shkathtësia s'ndryshonin asnjë thërrime nga djemtë. Shquante përmbi të gjitha Festimja e shokut Fasllii me një bluzë të kuqe me mëngë të shkurtëra. E kuqe kishte emrin bluza, po, në të vërtetë ngjyra e saj nuk dallohej nga pluhuri. Po Festimja nuk shquhej vetëm nga bluza. Shquhej edhe nga puna, edhe nga lëvizjet, edhe nga zëri

kur jepte udhëzime ose i hiqte vërejtjen ndonjërit. Herë pas here, pa lëshuar kazmën e lopatën nga dora, kalonte nga njëra skuadër te tjetra dhe, edhe aty ku shkonte, fillonte menjëherë punën dhe ashtu, duke punuar, u thoshte shokëve e shoqeve ato që kishte për t'u thënë.

Skuadra e fundit ndeshi në një copë vend të fortë që kish nën vete një shtresë guri dhe nuk shqepej. Festimja dëgjoi tringëllimën e thatë të kazmave dhe isot e vullnetarëve që jepnin e merrnin të dëshpëruar që s'po u ecte puna dhe u gjend në mes të tyre. Urdhëroi shumicën e shokëve që të vazhdonin punën pak më tej, aty ku toka s'kish bela të tilla, dhe mbajti me vete vetëm tre veta që ajo i njihte si më të aftë. I erdhi rrotull shkëmbit duke kontrolluar me qysqi se ku i kishte anët e dobëta me qëllim që aty të fillonte sulmën. Vendosi pastaj secilin nga të tre shokët në një nga vendet e dobëta të shkëmbit, kurse për vete zuri pikën më të vështirë. Vajza sa s'thyhej në mes kur ngrinte lart kazmën ose varenë për të goditur me sa fuqi që kishte aty ku duhej. Shokët e saj, midis tyre edhe traktorist Petraqi me ata muskuj të fortë si të sportistëve që ngrenë rrotën e vagonit me një rën dorë, mundoheshin t'ia arrinin duke shikuar herë pas here se si punonte ajo, po s'ia arrinin dot. Festimja, nga ana e saj, edhe me atë shpejtësi vetëtime siç punonte, e gjente më të rrallë kohën të hidhte sytë nga shokët, t'u jepte ndonjë këshillë ose t'i qortonte për ndonjë gabim të tyre. Dëgjohej që nga larg zëri i saj kur përmendte si shembull Bejkushin.

— Kapedane e ke këtë vajzë, more Faslli...

— tha i gëzuar xha Alushi, që e kishte humbur një copë herë mendjen pas të rinjve.

Kish rënë bilbili për të lënë punën, se do të hahej dreka dhe ne atë prisnim. Mbështetëm anës së kanalit kazmat e lopatat dhe e mbajtëm vrapin te gorrica, në hije. Na ishte djegur hunda për duhan dhe po nxirrnim kutinë që ta dridhnim.

Kryetar Faslliu, që pë gjithnjë cigare «Partizani» nga ato të Gjirokastrës, se është e vetmja markë, thotë ai, që s'e ka prishur dorën, na hodhi nganjë, dhe, duke na e nderur, zuri të ngasë fjalën që kish lënë përgjysmë xha Alushi:

— E shkathët është, vërtet, po është për atë që do ta marrë, s'është për mua — tha pak si me të truar.

— Punë e madhe! — ia ktheu plaku. — Cili është ai që pati vajzën e nuk e dërgoi në fatin e saj? Ti gëzohu që ajo të shkojë jetë të mirë atje tek të jetë shkruar.

Faslliu ngriti sytë e shikoi i menduar plakun, sikur donte të kuptonte se ku rrihte ai me fjalët «atje tek të jetë shkruar». Përse ta hidhte këtë fjalë xha Alushi kur dihej nga të gjithë se fati i vajzës ishte caktuar me kohë që me fejesën që i kish bërë i ati në Ramizaj? «Kjo do të thotë se kanë filluar të dyshojnë njerëzit në fejesën e sime bije», mendoi Faslliu dhe u mat të thoshte diçka, por, tek hoqi thellë cigaren, e mbyti kolla dhe s'e la të nxirrte asnjë fjalë.

Vullnetarët, grumbuj-grumbuj, kush më parë e kush më pas, po linin punën dhe secili gjente nga një copë hije ku të pushonte. Vetëm Festimja me

grupin e saj nuk kishte lëvizur dhe as që kish ndër mend të lëvizte nga fronti i punës.

— Forca, shokë! Edhe pak që t'i japim fund!
— dëgjohej herë pas here thirrja e saj. Dhe, me një lopatë më të madhe se veten, ngrinte e hidhte buzës së kanalit, që tani ish thelluar goxha, copat e gurit e të dheut që ishin bërë përgjithësisht përpara saj. Një kashtore, që mbante në kokë gjoja për t'u mbrojtur nga dielli, me atë gjalmin e lidhur nën gushë, i ishte liruar dhe i varej mbi shpatulla, po ajo s'kujtohej ta rregullonte ose kujtohej, po s'donte të humbte kohë. Faslliut, sa i pushoi ajo drejt kollë, i ra në sy që vajza i mbante sytë mbyllur kur punonte dhe i ngjiti fjalën «kalamane».

— Ç'kalamane, more! — s'ia la Alushi fjalën të binte përdhe. — Nuk e shikon që s'e lë djersa të hapë sytë? Apo s'është kripë e gjallë ajo e shkretë!

Plaku kishte të drejtë. Flokët e vajzës, të shprishur siç ishin, kullonin siç kullon gjethja në shi. Djersa çurçe-çurçe i mbulonte ballin, sytë, fytyrën. Vajza shtrëngonte fort, ashtu si sytë, edhe buzët për të shmangur atë lëng të athët e gjithë pluhur, të cilit s'ia dilte dot me të fshirë. Bluza e saj e kuqe, e ngjeshur në pluhur, dukej sikur atë çast që nxjerrë nga kazani me ujë dhe kish marrë një ngjyrë tjetër.

Sa i dha fund punës, vajza lëshoi pa kujdes përtokë lopatën që kishte në duar dhe bëri të largohej. Po, pa hedhur as dy hapa, ndjeu një si të marrur mendsh, shtrëngoi fort kokën me të dyja duart dhe, duke u shtrirë sikur s'kish pësuar gjë,

mezi arriti e u ul pranë nesh, dyllë e verdhë në fytyrë.

— U dërmove, moj vajzë! Ç'është kështu me ty? — e qortoi Faslliu. — Ne thamë se ajo që pësoi Bejkushi do të bëhej mësim për ju, të tjerët, kurse ju...

— Kurse ne bëmë të kundërtën — ia preu vajza. — Për nder të Bejkushit dhe, duke marrë shembull prej tij, e shpallëm ditë sulmi ditën e sotme. Dhe kjo na dha përfundimin që shikoni. — Ajo tregoi me dorë kanalën e gërmuar që, me të vërtetë, ish zgjatur shumë.

— Pa shih, pa shih! — u habít xha Alushi, që kishte dëgjuar me vëmendje gjithë bisedën. — Prandaj bënë gjithë këtë punë sot këta të uruar? — Ktheu pastaj sytë nga kryetari dhe shtoi:

— U ka lindur mendja më përpara këtyre, o Faslli. Lëri të bëjnë ç'të duan.

«Me një fjalë, lëre çupën të bëjë si të dojë edhe punën e fejesës.» Kështu e shpjegonte Faslliu me vete fjalën e xha Alushit.

Muaji i dhjetorit, aty nga mbarimi, sikur desh të merrte edhe hakun e vjeshtave që bënë behar, ia nisi me shira të mëdha, me shkrepëtima dhe gjëmime që tundnin malet e shkëmbinjtë. Një javë me radhë qielli nxinte e derdhte pa pushim. Rrëketë u bënë përrenj dhe përrenjtë lumë. Ishte rrezik të dilte nga shtrati një rrëke e vjetër sipër fshatit, që kish bërë kiametin me përmytje vëtin e zisë më 1918.

Që natën e parë, kur nisi tufani, shoku Riza e Fasliu dolën me rrezik koke përjashta, thirrën derë për derë — se bobla ish e pamundur të dëgjohej — burrat më të fuqishëm e më esnafë të fshatit dhe, për gjithë natën, i ngritën prita rrëkesë në vendet ku rreziku ishte më i madh. Gëzim Pronjoja e të rinjtë vrapuan për në kanal, që kish edhe ai rreziqet e tij nga ujërat e rrëkeve të shumta që zbrisnin nëpër gjithë rrëzën e shkëmbit nga ana e sipërme e kanalit. Zalli i hatashëm që sjellin këto rrëke do të depozitohej i tërë në kanal in e hapur dhe do të varroste gjithë atë goxha punë që kishte bërë rinia dy muaj me radhë. Për të dy palët ish një punë e mundimshme dhe, po ta mendoje hollë, edhe e pafrytshme. Merrreni me mend që, vetëm për të arritur në vendet përkatëse, si burrat që e kishin udhën më të përpjetë, edhe të rinjtë e të rejat që e kishin drejt, bënë nga një orë plot, sepse ish aq errësirë, sa nuk shihje shokun që kishe pranë dhe, që të ecje, ose duhej ta njihje udhën pëllëmbë për pëllëmbë, ose duhej të prisje shkrepëtimat e rrufesë. Hynë një copë herë në punë nja pesë a gjashtë fenerë që kishte gjithë fshati, po një pjesë e tyre nuk ishte e siguruar mirë dhe i shoi era që frynte si e ndërkyer, kurse të tjerët s'kishin pasur vajgurë të mjaftueshëm. E kujt i vinte ndër mend në ato minuta rreziku të merrte të gjitha masat që kërkonte kjo punë? Të nesërmen, dërguam e blemë në MAPO njëzet e ca fenerë të zgjedhur dhe puna, me gjithë vështirësitë e tjera të mëdha, eci më mirë.

Po ato mundimet e natës së parë, që s'i kishim provuar ndonjëherë, s'i kemi harruar as

tani që jemi ndryshe fare nga ç'ishim atëhere, dhe, kur na del përpara ndonjë punë nga më të vështirat, s'ngrihet dot njeri të thotë që kjo punë s'bëhet, se i vërsulen të tjerët: «Hesht, more shok! Ne u kemi dalë në krye punëve të tjera njëqind herë më të rënda se kjo. Ç'na përrallos ti?» Dhe i përmendin mundimet e asaj nate.

Ajo natë na dha me të vërtetë të kuptojmë se, kur u bashkuakan mendjet dhe vullnetet e njerëzve dhe kur arrihet të binden tejprtej se çështja është në interes të të gjithëve, s'ka vështirësi që të mos kapërcehet. Zaten, këtë të vërtetë na e kishte mësuar edhe lufta partizane, po ne kemi nganjëherë të keqen që i harrojmë të kaluarat.

Rizain e Fasliun i pashë vetë me sy kur u futën gjer në brez në ujët e llomissë për të gërryer vendin dhe për të prapsur gurët që sillte lloimia, me qëllim që ajo të ikte lirisht tutje, gjersa të kapërcente sinorin e fshatit, pastaj le të bënte ç'të donte. Dhe trimëria e këtyre dy shokëve nuk ish ajo që ata ishin kredhur në ujë, se për ashtu, uji na kish hyrë në kockë të gjithëve, po atyre u dërmonin kërcinjtë gurët që sillte me rrëmbim lloimia dhe, po të mos kishin orë e çast mendjen, ishin në rrezik edhe të mbyteshin.

Nuk qe e paktë edhe puna e Alush Bocëngut. Aty e tregoi ai jo vetëm fuqinë, por edhe mendjen e punëtorit të kalitur, zanatin e tij si mbathës miniere. Që kur u nisëm nga fshati, na kujtoi të merrnim edhe sëpatat e sharrat me vete dhe, me të arritur në vend, më futi mua me nja dy a tre të tjerë, midis të cilëve edhe Tosunin, të prisnim disa trungje lisash, që, siç u pa më vonë,

qenë shpëtimi i situatës. Në fillim bëmë ca fjalë me kryetarin, që na kujtoi ligjin e mbrojtjes së pyjeve, po më në fund, duke pasur parasysh se njeriu e krijon pyllin dhe jo pylli njeriun, mori përgjegjësi dhe na lejoi. Se si ia dolëm kësaj pune në gjithë atë shi e errësirë, nuk shpjegohet dot me fjalë. Po përfundimi që që xha Alushi me trungjet që premë ne dhe me gurët që nxirrnin nga lllomia Rizai e Faslliu, ngriti buzës së rrëkesë një mur të tërë — digë, i thoshte plaku, që s'i kish ç't'i bënte as topi.

Këtë punë kishin bërë, në mendje të tyre, edhe të rinjtë, vetëm se ata, në vend të lisave, kishin prerë gorricat që s'janë dhe aq të çmuara. Se, edhe ata, siç na treguan më vonë, të njëjtin hall kishin pasur, t'u ngrinin pritë buzës së kanalit jo nga ana e poshtme si ne, por nga ana e sipërme, rrëkeve të shiut me zall e llomi që zbrisnin nga shkëmbinjtë, kështu që me sa të ishte e mundur, gjithë ajo katana të mos zbrazej në kanal, por diku gjetkë, ku të mos bënte dëm.

Kështu e shkuam gjithë javën. Flinim me radhë nga tri-katër orë gjumë natën dhe pjesën tjetër të kohës e shkonim në luftë vetëm në dy fronte ne burrat atje sipër te lllomia e madhe, duke mbathur e forcuar digën, të rinjtë në kanalim e hidrocentralit, kurse gratë u mobilizuan për të zhveshur mîsrin. Sa për punë të tjera të jashtme ish e kotë të bëje fjalë në atë tufan.

Sidoqoftë, puna jonë pas asaj të natës së parë nuk ish më e atillë që të dridhet mishtë kur e kujton. Them kështu për punën e ne, të rriturve, pa, sa për të rinjtë, ata e kishin pothuaj njësoj.

Pasi siguruan mirë me prita kanalën nga rreziku i llojve të këtyre vetë kanalit. Një pjesë gërryenin e pastronin vendet që kishin pësuar përmbytje, pjesa tjetër vazhdonte gërmimin për zgjarjen e kanalit, megjithëse fjala kishte qenë që, kur të nisnin shirat e mëdha, punimet në kanal të ndërpriteshin gjer në fillim të pranverës.

Qull në shi e fillonin punën, më qull ktheheshin pasdreke vonë nëpër shtëpëra. Dhe është vërtet për t'u habitur se si nuk mori asnjëri ndonjë plevit. Festimja, zjarr si kurdoherë, e para arrinte në aksion dhe e fundit largohej. «Edhe kur fle, kanalën sheh në ëndërr», na thoshte Faslliu.

I korrë¹) na doli ato ditë në punën e kanalit edhe një i ri tjetër, të cilin gjer atëherë s'e kishim shumë në defter. Ky ishte traktorist Petraçi, nga rrethi i Përmetit me atë trup të ngjeshur e llërë të forta, që punonte edhe në shi pa këmishë e pa kanotiere, se «është njësoj, thoshte, pse t'i vesh kot?» Petraçi kish të drejtën e tij të pushonte ato ditë llohe kur s'futej dot traktori në arë, se e kishte bërë ditë edhe natën me hënë për lëvizimet e vjeshtës, por ec t'i mbushje mendjen. «E ka si traktori që s'kthehet lehtë, bënte shaka xha Alushi, që e çmonte shumë dhe që i vetmi që u pajtua me vendimin e djaloshit. Mos u tërhiq, djalë i xhaxhait. Je klasë punëtore ti,» i thoshte. Ashtu si traktorist Petraçi, punonte me mish e me shpirt edhe Xhevahir Ramizi, që, fund i fundit, s'kishte ndonjë interes gjersa kooperativa e tij ish rregulluar prej kohësh me dritë elektrike. Po Xhevahiri kishte edhe shumë cilësi të tjera.

Ish shakaxhi i madh, thoshe sikur kish bërë shkollë për avokat dhe jo për infermier. Vullnetar i thjeshtë ishte ai në njëzet të rinjtë e fshatrave fqinje, po fjala i dëgjohej njësoj si përgjegjësit të tyre, dhe kish pse t'i dëgjohej, se jepte vetë shembullin. Nuk kishte radhë që të mos dilte në tabelën e të dalluarve herë në punë kazme, herë si infermier. Zanatin e infermierit nuk e ushtronte vetëm në kanal me të rinjtë, po në gjithë kooperativën. Nuk thoshte kurrë: «Jam i zënë», siç bëjnë disa, por të gjendej pranë kur e kërkoje, ditë ose natë le të ishte. Kishte pastaj edhe atë të mirë që shumë gjëra nga të zanatit mundahej t'ua mësonte edhe pleqve e plakave.

Ato ditët e tufanit, sidomos, Xhevahiri punoi përtej fuqive të tij dhe këtë nuk e bëri pa arësye. Ish zotuar të kryente punën e Bejkushit që po mbushte tri javë në spítal dhe thuhej se qëndrimi i tij në duart e mjekëve mund të zgjaste me muaj.

Dhe zotimin e mbajti si burrat gjer në fund. Kjo na bëri përshtypje të madhe të gjithëve.

— Do veproje kështu ti, sikur të ishe në vend të tij? — më pyeste xha Alushi.

— Jo, për besë! Po ti?

Xha Alushi tha të drejtën:

— Të them atë që është... Ne s'e bëjmë dot si këta. Dhe kanë të drejtë.

Po kish në fshatin tonë edhe njerës që thoshin se Xhevahiri e bën këtë për të fituar zemrën e së fejuarës, e cila e ka syrin gjetkë, por, ashtu si e tregoi puna më vonë, këto qenë thashetheme

nga të atyre që s'kanë punë tjetër. Dhe nga të tillët s'ishte mangut as fshati ynë.

Tufani dhe vështirësitë që dolën prej tij na dhanë rast ne, prindërve, që të kërkonim pezullimin e punimeve në kanal, të paktën gjer në të hyrë të marsit, dhe na u desh të bënim një thes fjalë me të rinjtë që ata të bindeshin. Ata u bindën, ç'është e vërteta, jo nga arësyetimet tona, po nga që u ngatërrua përsëri çështja e turbinës me gjeneratorë e me qyngje, të cilat vetëm aty nga pranvera kish mundësi të na jepeshin, kështu që ish e kotë t'i jepje fund kanalit, gjersa nuk inaguroje dot hidrocentralin. Po edhe që u ndërpre në punimet, prapëseprapë kanalí s'mbeti fare shkretë. Një skuadër me të rinjtë e fshatit s'pat ditë gjatë gjithë atij dimri që të mos shkonte në kanal për të kontrolluar gjendjen dhe për të merretuar dëmet që shkaktonin shirat. Ditët me diell skuadra kryente edhe punë të tjera që kishin të bënin me sjelljen e dritës në fshat. Prisnin shtylla, hapnin gropa aty ku do të vendoseshin shtyllat dhe afronin gurë e materiale të tjera te vendi ku do të ngrihej hidrocentrali.

Faslliu s'pati besë që rinia të çlirohej nga aksioni i hidrocentralit dhe t'u përvíshej aksioneve të tjera, që, sipas tij, ishin të domosdoshme. E kishte ndrequr politikën tani edhe me Gëzim Pronjon, që s'ia kish përmendur me atë «kleçkën» e

famshme dhe s'kish ku ta vinte përgjegjësia e rinisë kur ky ish dakord me propozimet e kryetarit. Filluan kështu njera pas tjetrës nja tri aksione të mira, po më e rëndësishmja nga të gjitha, sipas Faslliut, ishte ajo e kullimit të tokave që do të mbilleshin në pranverë.

Faslliu këputej edhe vetë në punë, po nuk ndjente lodhje. Kthehej në mbrëmje në shtëpi me buzë në gaz dhe, gjatë kohës që Festimja do të pregatiste ndonjë gjë për darkë, ai merrte ndonjë nga librat ose rivistat që i kishte rreshtuar mbi oxhak, si në një etazherkë, dhe ia niste leximit.

Kur gjente ndonjë gjë interesante, i kthehej së bijës:

— Dëgjo këtu, dëgjo. Lëre pakëz atë punë.

Dhe ia lexonte.

Festimja s'ja prishte. Linte tiganin në zjarr dhe dëgjonte si me vëmendje, edhe kur ishin gjëra që i kish lexuar e stërlexuar. Asaj i bëhej qejfi që i ati kishte filluar të jepej edhe pas librave, po, thellë-thellë, ndjente një lloj boshllëku që ia zhdukte shpejt gazin nga buzët. E ç'vlerë kish që babai të lexonte, qoftë edhe gjërat më të bukura të botës, kur ai i shpjegonte ato sipas kokës së tij?

Faslliu s'i gëlltiste dot shkrimet, që bënë fjalë për lirinë e vajzave që duhet të zgjedhin vetë, pa ndërhyrjen e prindërve, shokun e tyre të jetës. Dhe e keqja më e madhe ishte që ai nuk i shfaqte të tilla mendime në sy të të tjerëve, po ia përplaste së bijës, sikur donte t'i thoshte kësaj: «Ki mendjen! Ndryshe, të piu e zeza!»

Vrer mbushej vajza nga këto mendime të ba-

baft, po nuk guxonte t'ia kthente fjalën. Të ish për çështje të tjera, ajo ish e zonja ta mbërthente me shpatulla në mur Faslliun ashtu siç e kishte mbërthyer shumë herë, po, për çështje dashurie ish e kotë të shpjegoheshe me të. Mjafton t'i thoshe gjysmë fjalë dhe ai kish borxh ta kthente shtëpinë përmbys. Lëre pastaj sikur vajza të merrte guximin e t'ij thoshte se edhe ajo vetë s'ishte dakord të merrte për burrë djalin që i kishte caktuar i ati më kokë të tij.

Dhe Festimja i kish mbështetur gjithë shpresat te përpjekjet e Rizaft e të Gëzimit që e kuptonin botën ndryshe, dhe e kishin edhe për detyrë t'ia zgjidhnin hallin.

Vërtet kish ca kohë që ata s'po e ngisnin më këtë çështje, por kjo s'do të thoshte që kishin hequr dorë. Ndoshta kanë menduar ta marrin kalana me rrugë të tërthorta dhe jo drejtpërdrejt. Një shenjë e mirë ish edhe ajo që as Faslliu, s'po interesohej shumë tani për krushkun, as krushku nuk shihej më, si më parë, java shtatë e ai tetë, në derë të Faslliut. Edhe një herë që erdhi, i shkoi bosh mundimi. Faslliu, që ishte njoftuar se atë ditë do t'i vinte krushku, iku nga fshati dhe s'u pa gjer vonë në mbrëmje.

Dhe kjo kishte një kuptim. Kështu mendonte vajza dhe kështu kaluan nja pesë a gjashtë javë të atij dimri në familjen e kryetarit. Faslliu, duke shpresuar që po e hidhte lumin dhe së shpejti do të shihej ballëhapur me mikun e tij të shtrenjtë, Festimja, e bindur që shokët d'ishte do të bënin për të.

Megjithatë, Faslliut i thoshte nganjëherë mendja se mos kjo heshtje ishte si ajo koha përpa-

ra furtunës që mbarset dalëngadalë dhe, papritur, lëshohet si e tërbuar.

* * *

Dhe ashtu i doli vërtet, po i doli andej nga s'e priste. S'kish pesë javë që ishin ndaluar punimet në kanal kur erdhi në fshat lajmi i një fjalimi me rëndësi që kishte mbajtur shoku Enver Hoxha në një mbledhje me komunistë në Tiranë. Në fjalim ngriheshin shumë çështje, po ajo që i dogji shumë Faslliut ish çështja e të drejtave të gruas dhe veçanërisht e luftës që u duhej bërë fejesave që në vegjëli. Ai ish i bindur tani se Gëzim Pronjoja këtë rast donte që t'i ndizte përsëri urët. Dyshimi sa vinte e i shtohet nga gjithë ato që po ndodhnin tani, pas fjalimit, në shumë krahina të Shqipërisë. Shumë vajza që ishin fejuar të vogla ose edhe të rritura, por të fejuara me anë lajmësish dhe pa pëlqimin e tyre, ngriheshin në mes të mbledhjeve të gjëra të popullit dhe ua përplasnin në surrat prindërve ose lajmësve shpirtkazmë krimin që kishin bërë.

Dhe priste Faslliu ta thërrisnin e t'ia shtroinin edhe një herë çështjen ashtu si ja kishin shtruar Rizai e Gëzimi shumë kohë më parë. Këtë radhë ai e kishte vështirë t'u vërsulej shokëve me këmbët e para siç kish bërë herët e tjera dhe, e vetmja shpresë e tij për të kapërcyer hendekun, varrej te qëndrimi që do të mbante e bija. Po të ish që ajo s'do të shfaqte ndonjë ankim për fejesën që i kish bërë i ati, atëhere shokët s'kishin përse ta bënë çështje. Prandaj ai mund ta flinte men-

djen nga ajo anë. Po sikur, meazallah, të ndodhte e kundërta?

Faslli Guri s'kishte hyrë ndonjëherë në muhabetë të tilla me Festimen. Mbahej aq shumë pas zakonet të vjetër në këto çështje, sa nuk përmendte në sy të së bijës as emrin e të fejuarit të saj, jo më ta pyeste se si i kish punët me atë djalë, se si mendonte ajo ta rregullonte të ardhmen me të, e të tjera e të tjera. Këto ishin gjëra «të shplara» për Faslliun. Sipas tij, vajzat duhej t'i gëzonin të drejtat dhe liritë që u jep ligji grave vetëm kur të shkonin në derën e burrit, tjetër që ai ishte i detyruar të mbyllte gojën kur shikonte edhe tek e bija shumë gjëra që s'i pëlqenin.

Mirëpo ja, ato që thuheshin në fjalimin e udhëheqësit ishin kopaçe për shumë nga këto mendime të Faslliut dhe ai duhej të bënte tani ca ndryshime. Dhe ndryshimi i parë ish që të shtrohej e të bisedonte me të bijën. Ish e rëndë kjo për Faslliun. Po ec e mos e bëj, në daç!

U përpoq t'ia ngarkonte Tosunit këtë punë, megjithëse me Tosunin s'e kish më grurë muhabetin si më parë. Por Tosuni ja preu me sëpatë: «Nuk ma mban». Dhe kish arsëyet e tij që të përgjegjej kështu.

Desh, s'desh, Faslliu u detyrua të hynte vetë në bisedim me vajzën. I gjeti rastin një të dielë paradreke, kur Festimja sapo kish mbaruar punët e shtëpisë dhe po nisej për në një mbledhje rinie, ku ish e ditur se do të bisedohej edhe për punën e fejesave.

Sterrë në fytyrë si ajo reja më të zbrazur e me sytë përdhë sikur kish për t'i dhënë çupës

ndonjë mandatë, i doli përpara në çastin që ajo po kapërcente prakun.

— Për në mbledhje kështu? — e pyeti.

— Po. Dhe jam vonë... — u përgjegj si e trembur vajza.

— Je vonë, po unë kisha nja dy fjalë me ty...

Ajo e shikoi në fytyrë dhe u drodh. Fytyra e tij të shtinte frikën, kaq e prishur dhe e shqetësuar ishte.

— Urdhëro, baba! — buzëqeshi me pahir, goja sikur s'e kishte vënë re gjendjen e tij.

— Do më thuash të drejtën, — tha duke pshe-rëtitur Faslliu — mos ke edhe ti qëllim të më nxish faqen në sy të botës, mua, babait, ashtu siç kam dëgjuar se bëjnë disa vajza me baballarët e tyre që i kanë fejuar të vogla?

Atij i dridhej buza kur fliste. Kish ngritur kokën tanë dhe e shikonte të bijën në bebëza të syrit, si të donte t'i thoshte: «Nga përgjegjja jote varet jeta ose vdekja ime.»

Festimja u zu ngushtë. Ajo ja njihte mirë kokën të atit. Do të mjaftonte edhe një shenjë e vogël kundërshtimi nga ana e saj, që ai të shkallonte fare. Dhe gjeti aty për aty një përgjegje të mençur, sa për të kapërcyer hëpërhë rrezikun:

— Unë nuk të turpëroj, baba. Për këtë të jesh i sigurt.

Faslliu ndërroi përnjëherësh nga çehrja. Desh të kërkonte nga vajza edhe shpjegime të tjera, po dëgjoi shokët e shoqet e saj që po e thërrisnin, se po fillonte mbledhja, dhe nuk e zgjati. Megjithatë, edhe ato dy fjalë që dëgjoi nga goja e së bijës, nuk ishin pak për të.

Afër mbrëmjes, ndërsa mbledhja e rinisë povazhdonte, Faslliu e thirri Riza Hodoja.

— E merr me mend pse të thirra — i tha.

— E marr — pohoi Faslliu.

— Domethënë e ke lexuar me rrënjë e me degë fjalimin.

— Po.

— Dhe ke nxjerrë përfundimin e duhur, besoj... Në lidhje me çështjen e Festimes, e kam fjalën.

Faslliu tundi kokën me një farë kureshtje.

— S'do mend që kam nxjerrë edhe përfundimin, — tha — por jo atë përfundim që mendoni ti e Gëzim Pronjoja.

— Domethënë?.. — ia ktheu Rizai i pakënaqur.

— Domethënë që fjalimi s'ka lidhje me çështjen time, gjersa e zonja e hallit s'ka ndonjë ankim.

Rizai nuk u ndje. E merrte me mend që Faslliu diç do ta kishte gjetur fjalën me të bijën, prandaj fliste aq serbes, dhe i vinte plasja që ajo vajzë, aq e zgjuar dhe e shkathët në shumë drejtime, nuk kish qenë e zonja, as tani që ia kish hapur rrugën fjala e udhëheqësit, t'ia shfaqte lirisht babait mendimet dhe dëshirat e saj. Po ish e kotë të zgjatej në këtë bisedë me Fasllin Gurin.

— Epo mirë atëhere. Ashtu qoftë si thua ti! — e mbylli fjalën Rizai, duke dashur të thoshte se çështja nuk ish mbyllur. Kurse Faslliu e kuptoi ndryshe.

Kapitulli V

Ditën e parë të marsit alla franga rinia filloi përsëri punimet në aksionin e hidrocentralit. Kjo ditë e parë marsi na kujton ne, pleqve, 1 marsin alla turka, ditë të cilën, kur ishim të rinj, e festonim fshatshe duke dalë me djem e me vajza nëpër pyje e livadhe për të mbledhur lule e gjethe që i sillnin nëpër shtëpira dhe me to stolisnim dyer e drítare, me shpresë, gjoja, se do të na sillnin mbarësi.

Kishin çelur lulet e para të pemëve dhe nëpër livadhe kish plasur bari. Majat e maleve rreth e rreth zbardhnin akoma nga bora, po në fshat moti ish zbutur shumë. Kooperativa ish në lëvizje të madhe me lëvrimin dhe të mbjellat e pranverës. Tek arat matanë përroit, që kishin rrezik të mbeteshin atë vit pa ujë për shkak të hidrocentralit, Petraq përmetari kish futur traktorin dhe gjëmimi i tij arrinte gjer në fshat duke mbuluar çdo zhurmë tjetër, aq sa mezi të zinte veshi tek-tuk blegërimën e shqerrave që i kishin ndarë ato ditë nga mëmat ose cicërimat e zogjve dhe poteren e nxënësve në oborr të shkollës.

Dielli s'kishte zënë as gjysmën e fshatit, kur

filluan të dukeshin nëpër rrugën, që shpër në kanal, grupet e para me të rinj e të reja. Ecnin grup pas grupi duke kënduar si ata krushqit njëherë e një kohë kur merrnin nusen. Edhe nga ana tjetër e fshatit, andej nga do të vijë së shpejti xhadeja, u dëgjuan këngë. Po vinte si gjashtë muaj më parë, brigada e të rinjve të kooperativave fqinje me një flamur të kuq në krye dhe me një pankartë të madhe që e mbanin dy veta. Në pankartë lexoheshin që nga larg këto fjalë: «TË MENDOJMË, TË PUNOJMË, TË JETOJMË SI REVOLUCIONARË.»

— E shikoni? Ju kam thënë unë. E kemi zjarr rininë — u mburr xha Alushi duke përpjekur duart, kur brigada e fqinje na kaloi pranë.

Gjithë atë ditë, anembanë kanalit, uturinim më fort se dy muaj të shkuar kazmat e varetë dhe ngriheshin gjer në qiell thirrjet gazmore të vullnetarëve.

Të nesërmen mbrëma, për të nderuar brigadën e vullnetarëve fqinjë që kish ardhur tani më e vendosur dhe me radhë më të zgjeruara, rinia e kooperativës sonë dha një shfaqje në vatrën e kulturës, të cilën e paskësh përgatitur prej kohësh.

Shfaqja që nga më të bukurat që kishim parë gjer atëhere, po kish një domethenje që na futi të gjithë në mendim, sidomos Faslliun, që, edhe pas fjalimit të 6 shkurtit dhe bisedës që kish pasur me Rizain, kish shpresë ta ruante krushqinë me Nexhip Ramizin duke u mbështetur në fjalën që i kish dhënë e bija se nuk do ta turpëronte.

Dhe ja tani ai tek po e shikonte me sytë e tij që çështja jo vetëm s'ish mbyllur, por po shkonte edhe më tej.

Të rinjtë, si me qëllim, kishin ftuar në këtë shfaqje të gjithë kooperativistët. Fasliun, Rîzain, Mjaftimen, xha Alushin dhe mua na vunë në radhët e para të karrigeve. Ata e kishin zgjidhur mirë edhe punën e dritës që pengonte shumë në këto shfaqjet tona. Kishte sjellë pothuaj secili nga shtëpia e tij nga një llambë me vajguri dhe i kishin varur afër e afër në të dyja anët e sallës. Kështu që, s'í salla, ashtu edhe skena që hapej nganjëherë, se ishte e mbyllur me perde, ndritnin si ato teatrot e qytetit, aq sa mua më zuri syri e njoha, andej nga fundi, në mes dyqind veta-ve, edhe llogaritar Tosunin, pak si të mërziur.

Gëzimi që s'bënte pushim së këshilluari herë njërin e herë tjetrin nga të rinjtë, sigurisht për punën e shfaqjes, qëndroi pak edhe me ne dhe na dha dorën me radhë duke filluar nga Fasliu.

— E paskeni rregulluar bukur, hallall e paçi!
— i tha xha Alushi dhe tregoi llambat që ishin varur rreth e rreth sallës.

— Punë me andre, xha Alush! — qeshi djali. — Do ta kemi ca pisk gjersa të na vijë drita e atij babaxhanit që po ndërtojmë. Pastaj, ehua! Do të qëndisë natën, pa syze, edhe plaka jote. Merrre me mend — shtof pastaj dhe fytyra e tij mori një pamje të gëzuar, të thuash sikur atë çast u hapën gjithë dritat e hidrocentralit — vetëm një llambë elektrike mesatare do të ndriçojë më shumë nga të pesëmbëdhjetë llambat e vajgurit që kemi varur këtu.

— Juaja u bëftë, more bir! — uroi plaku dhe e mori për qafe Gëzimin.

Kur do të fillonte shfaqja, ca të rinj që rrinin qëllimisht në këmbë në të dy anët e sallës, i ulën

llambat. Salla u errësua ca, kurse ajo pjesa ku do të luante grupi teatral, me t'u hapur perdja, ndriçonte dhe çdo gjë shihej si në pëllëmbë të dorës.

Shfaqja tregonte për një vajzë malësore me gërsheta si ato vajzat e dikurshme, të cilën e kish fejuar i ati që në djep me një burrë nga «dera e parë». Burri, sado që s'dukej shumë i shkuar, duhej të ish nja dyzet vjeç, kurse vajza nuk i kish as gjashtëmbëdhjetë. Burri kish pastaj edhe ca të këqija të tjera, ish tri pëllëmbë më i gjatë se e fejuara dhe i merrej ca goja kur fliste. Kish dëgjuar lumëmadhi që, në shumë krahina, vajzat po i linin burrat që u kishin gjetur prindërit pa pëlqimin e tyre dhe nxitohej të bënte një orë e më parë martesën.

U shqyem në gaz kur pamë gjatahulin kur erdhi në shtëpi të nuses për të prerë ditën e martesës. Ish veshur e ngjeshur si djalë njëzet vjeç dhe përpiquej me duar e me këmbë, më shumë se me gojën që i mbahej, t'u mbushte mendjen njerëzve që puna nuk priste.

Mirëpo vajza, që e shikonte për herë të parë, u bë si e çmendur dhe s'qe e mundur të bindej. Kjo i hapi punë të atit, që donte të shpinte domosdo në vend fjalën e dhënë dhe të mos turpërohej as me atë mavri dhëndërr, as me lajmësin, një llafazan që s'i pushonte goja dhe që i shtyn-te urët më shumë nga të gjithë.

Babai i vajzës të merrte në qafë si nga pamja, ashtu edhe nga disa cilësi të tjera, po ish fare i pagdhendur në punën e zakoneve të reja dhe kërkonte të bënte të pabërën, aq sa nja dy herë iu kanos së bijës edhe me revole..

Vajza s'u bind. I mori parasysh të gjitha dhe,

kur e pa ngushtë, çau e iku për te një daja i saj në qytet, ku bëri edhe katër vjet shkollë për ndihmësagronome, gjithnjë si me të vjedhur e me të ruajtur nga i ati dhe nga njerëzit e burrit që e kërkonin.

Kur mbaroi shkollën, u dërgua ndihmësagronome në fshatin e saj që ish bashkuar më në fund edhe ai, si e gjithë Shqipëria, në kooperativë bujqësore. Si më e rritur dhe e mësuar, ajo ish në gjendje tani të luftonte më mirë mendimin e të atit, të të fejuarit e të lajmësit, që meazallah se hiqnin dorë nga e tyrja. Po edhe intrigat e djallëzitë e atyre katranëve nuk ishin të pakta. Që ta pres shkurt, vajzës i erdhi në ndihmë tamam në kohën e duhur fjalimi i shokut Enver Hoxha që thoshte se u duhet prerë koka atyre që marrin nëpër këmbë të drejtat e gruas. Keni parë ndonjëherë furtunë që të pret duart e të merr gojën dhe s'je i zoti të marrësh as frymë? Ja, kështu qe për xhelatët e asaj vajze fjalimi i shokut Enver. E humbën si Xhaferri simiten, kur u lexua fjalimi në mes të mbledhjes së fshatit, dhe nuk e pa më i pari të dytin. Kurse vajza, siç na shpjegoi më vonë Gëzimi, mori atë që i desh zemra dhe bën jetë të lumtur me të.

Ca nga ata që loznin i njohëm se kush ishin. Festimja luante rolin e vajzës me gërsheta, kurse, si babai i saj luante traktorist Petraqi. Ky ishte veshur pak a shumë si Faslliu ynë dhe nuk shquante shumë nga ky, po ne e njohëm nga zëri. Bejkushit i kishin dhënë pjesën e atij dajës në qytet që e ndihmoi shumë vajzën. Nuk njohëm vetëm atë që luante rolin e dhëndrrit, por shumë nga ne

e morën për të vërtetë, aq mirë e luajti pjesën e tij.

Të rinjve iu bë zemra mal kur panë që iu plotësua dëshira vajzës, po edhe ne, të tjerët, s'mbetëm prapa. Xha Alushi, sidomos, vazhdoi të përpiqte duart edhe kur të tjerët kishin pushuar.

Ferk nga të gjithë bëri Faslliu. Ai përpoqi duart vetëm nja dy herë nga fundi, sa për të nxjerrë borxhin dhe gjithë kohën ndenji kokulur e i menduar. E kishte djegur shumë historia e asaj vajzës me gërsheta dhe ndoshta i shkonte mendja se një ditë, edhe Festimja e tij mund të ndiqte shembullin e asaj vajze. Vërtet që i fejuari i Festimes ish djalë i ri, nuk ish as gjatahul e marmarak si ai i malësorës dhe Festimja kish dhënë fjalën, siç e kish kuptuar Faslliu kur bisedoi me të, se nuk do ta turpëronte babain. Por a mund ta flinte mendjen ai me këto kohëra që kishin ardhur dhe sidomos pas gjithë atyre shenjave afrimi të së bijës me Bejkush Alemin që ai vetë i kish nuhatur e parë me sytë e tij disa herë? Po Gëzim Pronjoja, që ia kish ngritur me kohë çështjen Faslliu, pa qëllim, thua, ta kish përgatitur këtë shfaqje?

Kaq i hyri krimbi i dyshimit Faslliu, sa kishte rrezik ta humbte përnjëherësh gjithë atë vull e kurajë që kish marrë ata pesë a gjashtë muajt e fundit në detyrën e tij si kryetar i kooperativës.

Kur dolën përjashta, Rizai, që i kishte vënë re të gjitha lëvizjet e Faslliu gjatë shfaqjes dhe e dinte mirë se, si gjithmonë, në të tilla raste dëshpërimi, ai do ta gdhinte natën pa gjumë, e mori prapa, i hodhi krahun dhe, duke nxjerrë si shkak «një çikëz darkë» që kish përgatitur gjoja e shoqja

për një vëllain e saj, që kthehej nga ushtria e s'arriti dot atë mbrëmje, e ftoi në shtëpi.

— Nuk vij — ia preu Faslliu.

— Do të vish se s'bën.

— Me urdhër, thua ti?

— Jo me urdhër, po me arësye. Kemi gjëra me rëndësi për të biseduar.

— Ashtu?!

Faslliu mbajti një hop këmbët si me mëdyshje, po më në fund u bind.

E shoqja e Rizait, që sapo ish kthyer edhe ajo nga mbrëmja me tërë ato përshtypje që na kish bërë shfaqja gjithë ne, të tjerëve, pa fytyrën e ngrysur të kryetarit dhe e mori me mend se ku e kishte qëllimin i shoqi që e kish ftuar. Shtroi shpejt e shpejt darkën dhe u tërhoq në dhomën tjetër duke kërkuar të falur se gjoja ish pakëz pa qejf dhe se të nesërmen duhej të fillonte punën që me natë.

Pas darke — darkë i thënçin, se Faslliu, s'vuri në gojë as tri kafshata, edhe ato me të shtyrë — Rizai i ra muhabetit drejt e në plagë. Ia tha hapur Faslliut gjithë kuptimin e shfaqjes dhe iu lut si shok dhe si sekretar i organizatës që të mendohej mirë përpara se të thoshte fjalën e tij.

— Ç'fjalë të them? Fjalën ta kam thënë me kohë unë — ia preu shkurt Faslliu.

— Kurse unë them se duhet të mendosh mirë përpara se të më përgjegjesh kështu si po më përgjegjesh — i hoqi vërejtjen Rizai.

Faslliu s'u tund.

— Të mendohem? E pse të mendohem, gjersa e zonja e hallit siç të thashë edhe radhën e parë,

s'ka ndonjë kundërshtim për djalin që i kam zgjedhur unë, i ati?

Qe një përgjegje kjo që e vuri në gjendje të vështirë Rizain. Ai s'mund t'i fliste hapët Faslliut për ndjenjat e vërteta të vajzës. Këtë duhej ta kuptonte vetë Faslliu dhe këtu ishte gjithë vësh-tirësia.

— Vajzat tona — tha — s'janë akoma në gjendje t'ua thonë prindërve të vërtetën e ndjenjave të tyre.

— Kurse vajza ime ma tha me gojën e saj — u mbrojti Faslliu.

Rizai tundi nja dy herë kokën e tha si nëpër dhëmbë:

— Mos beso aq shumë, Fasllí. Është punë e koklavitur puna e ndjenjave, sidomos në femrat.

Faslliu u pre. Pse t'ia thoshte këtë fjalë Riza Hodoja? Të mos kish qenë e sinqertë e bija në fjalën që i kish dhënë? E pabesueshme, po ja që...

— Të mendohem atëhere dhe më tutje ta jap përgjegjen — pranoi më në fund dhe kërkoi leje të ngríhej.

Kuptohej që ai do të shkonte drejtpërdrejt e tek e bija dhe kushdi çfarë sherri do të ndizte me të. Këtë e dinte mirë Rizai, prandaj edhe nuk e la.

— Nuk është e mundur ta shtyjmë më tutje, kupton? Je një nga anëtarët më të vjetër të partisë dhe pikërisht për këtë kemi mbyllur njërin sy e kemi bërë veshin të shurdhër gjer më sot. Por tani erdhi puna tek s'mban më, shoku Fasllí. Ti pandeh se çështjen e ngacmon Gëzim Pronjoja nga koka e tij — vazhdoi Rizai. — Po je gabim. Më takon mua të parit ta ngacmoj. Se përgjegjësia

më e madhe mbi mua bie. Se, fundi i fundit, turpi ose nderi yt është edhe turpi ose nderi im, turpi ose nderi i organizatës sonë dhe i gjithë kooperativës. Më kuptoj?

Faslliun s'po e mbante vendi. Mezi priti që sekretarí të mbaronte fjalën dhe iu kthye tërë inat:

— Nuk të kuptoj, jo! Çfarë turpi paskam bërë unë që kam fejuar çupën time dhjetë vjet të shkuar, atje, tek më gjeti zemra karar? Po edhe sikur ta zëmë se është ashtu si thoni ti e Gëzimi, ç'përgjegjësi kanë organizata e partisë dhe kooperativa në këtë punë? Turpin e bëra unë, Faslli Guri, dhe unë përgjegjem për të. Është apo s'është kështu?

— Nuk është ashtu, jo, shoku Faslli. Ti harron që në sistemin tonë njeriu nuk rron i ndarë nga shoqëria. Përkundrazi, e ndjejmë veten përgjegjës kundrejt njëri-tjetrit, si në të mira, ashtu edhe në të këqija. Ish tjetër kohë ajo kur secili mendonte vetëm për vete, kur shoqëria e braktiste njeriun në fatin e tij dhe njeriu s'kish ç'të priste prej saj. Po, që të kthehemi aty ku e kisha fjalën, ne nuk quajmë turp atë që bëre ti dhjetë vjet të shkuar. Ish koha atëhere që fejesa të tilla ishin të zakonshme dhe s'binin në sy. Turp ne i themi qëndrimít që mban ti tani. E ke në dorë ta ndreqësh gabimin sa nuk është vonë dhe prapë përpiqesh të qëndrosh në tënden pa marrë parasysh se kohët kanë ndryshuar. Ç'i thonë kësaj? Kësaj i thonë sedër e sëmurë, individualizëm, frymë mikroborgjeze e djalli me të brrin, që ti i lexon çdo ditë në shtyp, po nuk i lidh edhe me të metat e tua, se pandeh që shkruhen vetëm për të tjerët. Ah,

Faslli, Faslli! Ta dije ti se ç'gjë e vështirë është që njeriu të njohë veten e tij...

Rizai vazhdoi të fliste edhe për gjëra të tjera që dukej sikur s'kishin lidhje me çështjen, por që në të vërtetë aty dilnin. Faslliu dëgjonte me kokën ulur duke ndezur e shuar cigare pas cigaresh.

Kish kaluar mesnata. Llamba mbi oxhak regë-tinte me vajgurin që ishte në të mbaruar, ndërsa pranë saj, dëgjoheshin tiktaket e një sahati me zile që Faslliu i krahasonte me të rrahurat e zemrës së tij.

— Sikur na u bë vonë — guxoi më në fund Faslliu t'ia priste fjalën shokut. — Na presin që me natë edhe shumë punë të tjera, apo jo?

Ai i tha këto fjalë si ai njeriu që është zënë ngushtë e s'di nga t'ia mbajë dhe kërkon shkakun më të vogël për t'iu larguar bisedës.

— Le të na bëhet vonë. Për mua e për ty s'ka punë më të madhe se kjo që po bisedojmë — ia dha aty për aty përgjegjen Rizai. — Unë s'ndahem pa i dhënë fund kësaj çështje.

— Domethënë? — ngrysi vetullat Faslliu.

— Domethënë që ti të më japësh fjalën e komunistit se fejesën e Festimes me Xhevahir Ramfzin e deklaroi të prishur.

Një hije e zezë mbuloi fytyrën e Faslliut. Shtrëngoi fort gjoksin sikur kish aty diçka që i zinte frymën dhe tha me zë të dëshpëruar:

— Kjo s'është punë që bëhet, Riza. S'e nxij dot faqen unë përpara krushkut, që s'më ka asnjë faj.

— Aha! — tha Rizai duke e vështruar vëngër shokun. — Me një fjalë ti pranon të të nxi-

het faqja përpara Partisë dhe shoqërisë, por jo përpara Nexhip Ramizit.

— Atë e thua ti, nuk e them unë — u nxeh Faslliu. — Për Partinë unë jap edhe kokën.

— S'është puna te koka, shoku Faslli Guri. Proven e kokës e ke dhënë ti kur e kërkoi nevoja. Tani është puna tek ajo sedra e sëmurë që të ka ngulur thonjtë në shpirt si oktapodhi dhe që t'i s'je i zoti t'i japësh shqelmin. Këtë kërkon Partia sot nga ti, nga unë, nga komunistët në radhë të parë, nga gjithë populli.

U pa që puna do të shkonte larg. Faslli Guri, ndonëse i kredhur në lloj-lloj mendimesh, që i bëheshin çokëlidhe në kokë, e kuptonte se. ashtu si e shtronte çështjen Rizai, nuk ish gjë e lehtë as të pranonte, as të kundërshtonte.

Dhe mbeti një copë herë me gojën mbërthyer e sytë ngulur në një vend. Kish nxjerrë kutinë e duhanit e matej të plekste një cigare, po duart i dridheshin dhe duhani i binte nga letra.

— Ti ke ndryshuar shumë këta muajt e fundit — vazhdoi Rizai. — Ke shkukur nga koka shumë lakra dhe kjo na ka gëzuar pa masë. Po ja që tani po u vë kazmën të gjithave me dorën tënde. Vete e ngul këmbë si mushka në një çështje që është fare kundër mësimeve të partisë.

— S'bëj dot ndryshe. Thuamë më mirë të mbytem — u përmend më në fund gjithë brengë e helm Faslliu.

Rizai vuri buzën si në gaz:

— Do të të bëj një pyetje — tha, duke e shikuar drejt në sy. — Ç'qëndrim do të mbaje ti sikur prishja e kësaj fejeje të vinte nga ana e krushkut?

— S'e bën atë punë Nexhip Ramizi — ia ktheu Faslliu. — Është burrë zemani ai.

— Burrë zemani, tamam. Po ja, ta zëmë se e bëri. Qe i shtërnguar, të themi, nga i biri ose nga arësye të tjera. Ç'qëndrim do të mbaje?

Pyetja e vuri në mendim Faslliu.

— Do të ish gjysma e së keqes, — tha pastaj — po unë s'do ta bëja çështje.

— S'do ta bëje çështje... E shikon? Pse të mos mendosh atëhere se edhe Nexhip Ramizi s'ka pse të tërbohët me ty, sikur jot bijë të mos e dojë të fejuarin që i ke zgjedhur ti?

Faslliut iu mbyll goja. Jo se nuk dinte më ç'të thoshte. Përkundrazi, ai mund t'i fliste Rizait me orë të tëra për cilësitë e së bijës, si një nga ato vajza të rralla që e kanë për turp të madh të kundërshtojnë mendimet dhe vendimet e prindërve. Por ja që ato fjalët e fundit të Rizait sikur i dogjën shumë dhe ia prenë hovin.

Mblodhi supet e psherëtiti.

— Dëgjo, Faslli — ia shkundi mendimet Rizai duke marrë përsëri fjalën:

— Unë s'ta bëra kot pyetjen. Dhe tanë do të të them një gjë që shpjegon shumë të tjera.

Faslliu hapi sy e veshë. Ndezi shpejt e shpejt cigaren, që kishte arritur më në fund ta dridhte, dhe e hoqi një herë fort. Tymi që nxori nga goja si shtëllungë mbuloi fytyrën e Rizait.

— E njohe dot në shfaqje atë të riun që lozte rolin e dhëndrrit gjatahul? — pyeti Rizai.

— Jo.

— Ish Xhevahiri ai, dhëndrri yt.

Faslliu luajti nga vendi:

— S'më besohet.

- S'të besohet, po ja që kështu është, vetë Xhevahiri, bile, kish propozuar të luhej ajo shfaqje dhe vetë kish kërkuar të lozte edhe rolin e dhëndrrit.

Kjo ia prishi mendjen më shumë Faslliut.

— Ta ketë bërë me ndonjë qëllim, thua ti? — pyeti.

— Me qëllim, sigurisht. Është djalë me mend Xhevahiri, Faslli. Me sa ma pret mua, duhet të ketë kuptuar që Festimja s'ushqen ndonjë dashuri për të dhe ka ardhur në përfundim që kjo fejesë s'ka si të çohet gjer në fund. Po druhet t'ia thotë të atit ashtu siç druhet edhe Festimja jote të të hapë zemrën ty, babait të saj.

Më shumë se kaq Riza Hodoja s'mund të thoshte, po edhe kaq nuk ishte pak që Faslliu t'i binte mendjes: A kish ai gabim me gjithë atë besim të madh që kish tek e bija, apo Rizai fliste kuturu?

Shtrëngoi nofullat e me zë të mekur iu drejtua shokut:

— Më fute mizat, Riza. S'ma merrte mendja që ime bijë...

— Jot bijë është lulja e rinisë në kooperativën tonë — ia preu fjalën Rizai. — Dhe ti duhet të jesh shumë prapa, në qoftë se mendon keq për të. Shkundu nga mendimet e vjetra, Faslli! Festimja ka lindur e është rritur në këto kohëra kur i gëzon me pashë të drejtat e saj dhe s'ka burrë që të guxojë të marrë nëpër këmbë këto të drejta. Më kupton? Në qoftë se flasim për të meta të sat bije, e vetmja e metë e saj është që ajo s'ka guxuar të t'i thotë të gjitha ty, babait.

«Domethënë e paska marrë ferra uratën, përfundoi me vete Faslliu. Po tani?»

Lidhi duart kryq në kraharor dhe, me kokën varur si ai i munduri që s'ka më fuqi të luftojë, ia qepi sytë shokut. Dukej sikur kish diçka për të thënë, sikur ish në të dorëzuar të armëve, por diçka e pengonte.

— Është e kotë të mendohesh — i rrahu krahet Riza! — Jep fjalën si burrat dhe të marrë fund kjo punë.

— Nuk e jap dot. Është e ngatërruar çështja.

— E ngatërruar? Jo, more! E pse qenka e ngatërruar?

Faslliu ngurroi të përgjegjej. Rrudhte e çrrudhte buzët që i ndjente si të thara dhe thithte fort cigaren që po i digjte gishtërinjtë.

— Hë de, folë! Pse qenka e ngatërruar? — e ngau përsëri Riza! — Apo është sekret që s'duhet ta dijë as organizata? — shtoi pastaj si me romuz.

— Sekret pa sekret, kjo është çështje që mund të marrë në qafë edhe të tjerët — u detyrua më në fund të fliste Faslliu.

— Folë më qartë, Faslli. Komunistët s'e kanë zakon të flasin me doreza. Cilët janë këta të tjerë që dashkan të merren në qafë? Më thuaj një, të paktën, që të kuptoj edhe unë.

— Tosuni, për shembull, — mezi e nxori fjalën Faslliu.

— Tosuni?! Cili Tosun, more?

Ndoshta s'kishte për të dalë kurrë nga goja e Faslli Gurit emri i llogaritarit në këtë çështje, por ja që u zu ngushtë dhe s'kish si ta mbante më të fshehtë. Iu desh kohë që ta merrte veten dhe të përgjegjej me fjalë që i dilnin si me çengel:

— Tosuni ynë, llogaritari. Ai ka qenë lajmësi.

— Lajmësi, ëhë! Pastaj?

— Ka marrë dhjetëmijë lekë nga krushku për këtë punë.

— Punë e bukur, besa! Pastaj?

— Pastaj, merre vetë me mend. Lëre që mund ta pushojnë nga puna të gjorin, por kjo shumë i duhet kthyer të zotit në qoftë se bëhet ajo që kërkon ti. Kush do t'ia kthejë? Tosuni ka një barrë fëmijë tani dhe mezi i del rroga që merr.

Rizai e shikoi vëngër dhe s'u mbajt më:

— More, ti s'qenke në të, më duket. M'ia qan hallin atij palo burri për të dhjetëmijë lekët që i ka ngrënë qyl dhe harron përgjegjësinë tënde si anëtar partie. E di ç'do të thotë të jesh në dijeni për një punë të tillë të turpshme dhe t'ia mbash fshehur partisë dhjetë vjet me radhë? Do të thotë të kesh ikur nga binarët e saj. Ja se ç'do të thotë.

— E mësova vonë punën e të 10.000 lekëve — u mundua të mbrohej Faslliu.

Por qe e kotë. I mbërthyer me shpatulla në mur nga ajo gjuha brisk e sekretarit të organizatës, e harroi fare Tosunin me të dhjetëmijë lekët e lajmësisë dhe jepte e merrte tanë të sqaronte punën e tij. Pranonte shumë nga dobësitë që i numëronte sekretari, po nuk i mbushej mendja që të ish aq fajtor sa e quante Rizai vetëm e vetëm pse s'kish njoftuar partinë për lajmësinë e llogaritar Tosunit dhe, vinte nga vinte, prapë kthehej po tek ato fjalë që kish thënë e përsëritur kushedi sa herë: «Për Partinë unë jap edhe kokën».

— Partisë nuk i duhet koka jote! — ia plasi

më në fund Rizai me shpirtin që i kish ardhur në majë të hundës.

Dhe u ngrit të dilte. Po, fek bëri tutje, i ra në sy pamja e llahtarshme që kish marrë tani fytyra e shokut dhe, desh, s'desh, u ndal. U pendua shumë për ato fjalë të papeshuara që i shpëtuan pak më parë në dëshpërim e sipër. Mos vallë Faslliu i mori ato fjalë si paralajmërim të përjashtimit të tij nga partia?

— Partia është zemërgjerë me anëtarët e saj, Faslliu. Sidomos me shokët si ti që s'kanë dhënë pak në jetën e tyre. — Fjalët e Rizait tani ishin të urta, këshilluese. — Por edhe ne kemi shumë detyra kundrejt saj, në radhë të parë detyrën që t'i hapim zemrën me të gjitha të mirat dhe dobësitë tona. Di ajo pastaj se si të veprojë që çdo gur të zërë vendin e tij. Më kupton?

Faslliu pohoi me kokë si të ish në një mendje me ato që thoshte sekretari, por, thellë-thellë, ai ish bindur tani se çështja nuk ish aq e thjeshtë.

— Nuk është vonë? — pyeti pastaj me një fije zëri dhe hoqi thellë në zemër.

— S'është vonë, jo. Por edhe vonë të jetë, më mirë vonë se kurrë — tha duke i zgjatur dorën Rizai. — Këto ditë bëjmë mbledhjen e organizatës dhe aty i sqarojmë të gjitha.

* * *

Dy ditë më pas, në mbledhjen e organizatës, shoku Riza shtroi çështjen e fejesës së padrejtë të Festimes duke kritikuar rëndë Faslliu në ra-

dhë të parë për gabimin që ai kish mbajtur të fshehur nga të gjithë, gjer edhe nga vetë sekretari, punën e lajmësisë.

Na ra lëverja nga krahët dhe na u sqaruan të gjitha dyshimet që kishim, kur mësuam që lajmës na paskësh qenë llogaritar Tosuni. Propozuam aty për aty që shoku Tosun të kthente menjëherë të 10.000 lekët, t'i hiqej një vërejtje me shënim në biografi që ta mbante mend sa të ish jeta dhe, për nja dymbëdhjetë muaj me radhë, të punonte me parmendë në ato ara ku nuk shkon dot traktori.

— S'ka haber Tosuni nga parmënda — bëri vërejtje njëri nga shokët, kur u hodh ky propozim.

— Të mësojë si çëço! — ngriti zërin tërë inat Mjaftimja. — S'ka lindur njeri i mësuar.

Që me fjalët e para të Rizait Faslliu u mbërthye ligsht dhe ngriti duart. Nuk bëri xanxë si herët e tjera, po me një gjakftohtësi që na habití, tregoi se me çfarë koke i gjykonte ai punët dhjetë vjet të shkuar kur gatoi fejesën.

— E kisha vajzë të pleqërisë Festimen — tha — dhe doja që edhe vajzën ta jepja në një shtëpi të mirë nga gjendja, edhe për vete të siguroja një mik për kokë. Dhe rasti më doli ashtu si e kisha menduar unë. Vjen një ditë Tosuni e më thotë: «Na ka dalë në shteg një gjah i mirë, xha Faslli. Të mos e humbim». Tosunin, siç e dini, me gjithë ca kusure të tij, e kam dashur e përkrahur si jetim që ishte. «E çfarë shtegu»? e pyeta unë. Ai m'i dha të gjitha hollësitë për shtëpinë e Ramizajve dhe për djalin e tyre. Në fillim ngurrova ca, se nuk i thoshin shaka, luhej me fatin e vajzës së vetme. Po Tosuni m'u qep gjersa më bindi dhe unë isha i sigurt se ai e bënte këtë për

të mirën time, për të shpërblyer një pjesë të të mirave që ka parë nga unë. Sa për 10.000 lekët e lajmësisë, betohem për ideal të partisë se nuk dija gjë. E mësova më vonë dhe u grinda me Tosunin, po ai më vuri thonjtë në grykë që të mos e bëja çështje. Më erdhi keq, se sapo ish martuar i katranosuri dhe s'kish shtëpi ku të fuste gruan. Ato 10.000 lekë ishin gjithë shpresa e tij. Dhe unë, desha, s'desha, i vura kapak çështjes.

Faslliu shpjegoi pastaj se si, prej dy vjetësh e këtej, i kishte rënë mendjes që një fejesë e tillë ish gabim, po këtë ia thoshte vetëm vetes, dhe jo vetëm që s'guxonte t'ia thoshte tjetërkujt, por edhe kur ia përmendnin të tjerët, ai u hidhej me këmbët e para, sepse, siç i qe ngulur atij në kokë, do të ishte një turp që s'e mbulon as varri, sikur t'i kthente fjalën Nexhip Ramizit.

Domosdo, shumë gjëra që kish parë e kish dëgjuar kohët e fundit dhe veçanërisht biseda me Rizain pas shfaqjes në vatrën e kulturës, e kishin tronditur shumë Fasllin. Ai i kish vënë më mirë gishtin kokës dhe, si përfundim, kish vendosur t'ia hapte zemrën organizatës me të gjitha.

Kur do t'i përgjegjej një pyetjeje që i bëri Gëzimi, ai e shikoi me buzë të qeshur dhe drejt në sy, gjë që nuk e kishte pasur zakon me atë djalë, dhe me kokën lart i tha:

— Mos ma bëj pyetjen anës e anës, po bëri drejt dhe të jesh i sigurt se s'do të jem më ai kryetar Faslliu që e merërte ters çdo vërejtje e kritikë tënde. Ka kohë që përpiqem t'i kuptoj drejt çështjet, bile, edhe për ndonjë romuz që hedhin nganjëherë njerëzit në drejtimin tim, nuk zemërohem, po vras mendjen që edhe nga kjo të nxjerr mësim.

Organizata u bind që shoku Faslli bëri auto-kritikë të mirë dhe, duke shfaqur besimin se ai do të luftojë me ndërgjegje për të vënë në jetë si komunist dhe si kryetar i kooperativës mësimet që nxori nga kjo mbledhje, që shumë e matur në vendimet e saj.

* * *

Festimja hyri me nxitim në shtëpi me një xhup që kishte hedhur krahëve dhe hapí sytë nga habia kur pa të atin me fytyrë të qeshur tek vinte e vinte nëpër dhomën e zjarrit duke vërshëlyer një këngë të njohur partizane.

Kish plot dy ditë, qysh nga ai bisedimí kokë më kokë me Rizain, pas asaj djall shfaqjeje teatrale që nxori në shesh shumë gjëra, që Faslliu i rrinte me hundë së bijës. Hynte e dilte në shtëpi pa e përfillur fare vajzën. Bile, edhe kur kjo i drejtonte ndonjë pyetje për çështje pune, ai i përgjegjej nëpër dhëmbë, pa ia hedhur sytë. Për Faslliuin kjo ishte sjellje më e urtë që ai mund të mbante ndaj Festimes, pas gjithë atyre që mësoi për të nga Riza Hodoja. E kishte në dorë ta mbërthente vajzën për flokësh e t'i kërkonte llogari për atë premtimin e saj të rremë: «Unë nuk të turpëroj, baba!», po e kish kuptuar mirë tani se nga kjo sjellje s'do të dilte gjë e mirë. Përkundrazi, mund të arrinte puna gjer aty sa t'i vinte revolen në kokë së bijës dhe me këtë të përmbyste gjithë të shkuarën e tij. Jo, jo! Kjo nuk ish e udhës për Faslli Gurin. Po edhe të sillej me të bijën ashtu siç ish sjellë gjithmonë, i qeshur e i dashur, prapë

nuk ia duronte zemra. Dhe kështu, dy ditë e dy net me radhë, kishte nxirë shtëpia e Fasllit. Nxinte fytyra e babait, nxinte edhe zemra e vajzës kur kthehej nga puna në shtëpi.

Kur ja, ndryshe nga sjellja e atyre dy ditëve, vajza po shikonte tani tek i ati një fytyrë që ta kish ënda ta shikoje. Ish më të ngrysur të ditës, një ditë e freskët me mjegull që lajmëronte shi dhe Faslliu sapo ish kthyer nga arat në fshat, ku kish shkuar menjëherë pas mbledhjes së organizatës për të kontrolluar serat e farishteve që i kish shumë merak. Vajza, që ish interesuar dhe e dinte se ku e ku e kishte kaluar i ati gjithë atë ditë marsi, e mori me mend që ai kish dalë mirë me të gjitha dhe i fluturoi zemra nga gëzimi që e pa aq të çelur.

— Mirë mbrëma, baba! — e përshëndeti ajo që në të hyrë të derës.

— Mirë mbrëma!

— S'qenke ndarë keq me kontrollin, é?

— Pse të ndahem keq? Punojnë shokët, punojnë.

— Edhe shoqet! — shtoi duke qeshur vajza.

— Edhe shoqet, patjetër... Po ju, andej nga kanali, si i keni punët? Kam ditë që s'jam parë.

Vajza, sikur këtë kish pritur, i shkoí pranë të atit dhe i shpjegoi me një frymë gjendjen e punimeve. Kanali po ecte përpara përtej zotimeve dhe parashikimeve të rinisë.

— Sidomos tani që kthehet edhe... — shtoi nxitimthi vajza, po përnjëherësh u skuq e tëra në fytyrë dhe s'e mbaroi dot fjalën...

— Kush? — pyeti si pa qëllim Faslliu.

Ajo e vështroi vetëtimthi në sy. Fytyra e të

atit nuk tregonte ndonjë nga ato shqetësimet e dikurshme që e bënin të tërbohej.

— Kemi marrë letër nga shoku Bejkush — tha pastaj me zë të qetë. — Kthehet së shpejti.

— U shërua? — pyeti me interesim Faslliu.

— U shërua. Kishte pasur syrin në rrezik, po ai bënte operacion dhe shpëtoi.

— Paska shpëtuar. Shyqyr!

Këto fjalë Faslliu i tha me gjithë zemër dhe vajza, që e peshonte me mend çdo fjalë e lëvizje të tij, nuk e fshehu dot kënaqësinë që ndjeu. I shkëlqyen sytë dhe gati sa s'i tha: «Të falem nderit».

«Paska ndryshuar, vërtet», mendoi Festimja. Asaj i kishin folur për autokritikën dhe zotimin e të atit në mbledhjen e organizatës, por e dinte mirë se sa vështirë do ta kishte ai të vinte në jetë zotimet që kishte marrë dhe, hëpërhë, nuk priste ndonjë gjë të madhe prej tij.

«Rëndësi ka që u interesua për Bejkushin, mendoi. Kur e kish përmendur, ai, emrin e tij në sytë e mi? Asnjëherë. Kjo do të thotë që ka lëvizur ca nga ajo mendja e tij e ngulur si me gozhdë edhe për martesën time në Ramizaj».

Vajzës i duhej sa më parë një farë pohimi nga i ati për të prishur fejesën e vjetër, jo se kishte hall të fejohej e të martohej përnjëherësh me Bejkushin, por për një çështje tjetër që s'kish ditë të mos ia hidhnin në sy. Në organizatën e rinisë atë e tregonin me gisht si shembullin më të mirë nga çdo pikëpamje, po gjithmonë kësaj lëvdate i vinin prapa një bisht: «Shoqja duhet të tregohet më revolucionare kundër disa mentaliteteve të vjetra që shfaqen në familjen e saj». Ky bisht

kishte shkuar gjer te disa nga shokët e organizatës së partisë që kishin marrë vesh çështjen e propozimit të saj për kandidatë.

Puna kish ardhur aty tek s'mbante më. Ose të thyente vargojtë e zakonit që e mbanin lidhur, ose të mos pranohej në parti. Po, që të thyente vargojtë e zakonit, do të thoshte të thyente zemrën e të atit, të prishej me të, t'i hiqte babait në atë moshë pleqërie gëzimín e fëmijës së vetëm që i kishte mbetur. Kurse, edhe rruga tjetër, nuk ish më pak e keqe, jo. Dhe s'vendoste dot, s'vendoste.

Tani gjendja dukej sikur po ndryshonte... Jo sikur po ndryshonte, po kish ndryshuar tamam. Fytyra e saj u çel dhe mori një pamje tjetër, të gëzuar, plot shpresa. Dyshoi se mos ish në ëndërr, dhe, që të sigurohej se nuk ishte kështu, përpoqi disa herë qerpikët e syve siç përpjek flutura krahet kur ngrihet të fluturojë. «Ç'fuqi të ketë qenë kjo që po e tund babain nga istikami?» Mendja i shkoi te mbledhja e organizatës, tek ajo forcë e padukshme e partisë, që arrin të ndriçojë edhe mendjet më të errëta të njerëzve. Dhe e krahasoi këtë dritë me atë të elektrikut që do të ndriçonte së shpejti edhe shtëpitë dhe rrugët e fshatit.

Faslliut i theri në zemër ajo çehre e gëzuar e vajzës që e tregonte hapët atë që s'thoshte dot goja e saj. «I paska pasur të thella zuska! rënkoj me vete duke shikuar me bisht të syrit vajzën. Kurse unë rrihja gjoksin me grusht e mbahesha më të madh për sjelljen e saj, për karakterin e saj. Ah, moj kokë!» Ju kujtuan kritikën e para të Gëzim Pronjos dhe vërejtjet e këshillat e Rizait më vonë në lidhje me fejesën që duhej prishur.

«Ja ku e paskan pasur mahananë e vërtetë ato kritikë e këshilla, mendoj. Domethënë ata e dinin që ime bijë i kishte rregulluar punët me të dashurin, kurse unë ia këputja gjumit dhe s'ish çudi që një ditë bukuroshja të më vinte në shtëpi me barkun gjer te buzët». I erdhë ndoht nga ky mendim dhe ndjeu një farë ngushëllimi që çështja nuk kishte arritur gjer aty. Prandaj edhe ishte marrëzi tani të prishje gjakun. Kësaj pune i kish dhënë fund një herë e më shumë mbledhja e sotme e organizatës, ku Faslliu kish dhënë fjalën e komunistit se do të zbatonte pikë për pikë vendimet e saj.

Ajo që duhej ta linte pa gjumë tani Faslliu Gurin ish prishja me Nexhip Ramizin që kish qënë dhjetë vjet me radhë gëzimi i tij. Si do t'i dilte në sy këtej e tutje atij të gjori krushk? Kish kohë që ai i bënte bisht takimit me të, po sa do të vazhdonte kështu? Si burrë me mend, krushku s'duhej t'ia ngarkonte fajin Faslliut, po kohërave që erdhën, prandaj, s'kish edhe pse t'i mernte hekurat bran kundër këtij. Sidoqoftë, kjo ish një plagë e rëndë për Nexhipin dhe Faslliu Guri, që e ndjente edhe vetë këtë plagë, duhej të dinte si të sillej me të.

Faslliu e hodhi pastaj mendjen edhe te krushqia e re që po i gatunte e bija. Bejkushit s'kishte ç't'i thoshe nga zgjuarësia dhe nga zotësia në punë. Në gojë e mbanin të gjithë edhe për sjelljen dhe karakterin e tij të mirë. Ish i vetmi djalë në fshat që mund ta zgjidhje kur të doje në vendin e Gëzim Pronjos dhe ta kishte mendjen të fjetur. Këto nuk ishin pak. Po ja që të gjitha të mirat s'bëhen bashkë. A ish ai i uruar Bejkush në një shkallë

me Ramizajt nga gjendja, nga jetesa, nga fisi?
«Edhe nga fisi, posi!» Bëri me mendje një krahasim
dhe i vari buzët. Se, që ta dini, edhe shoku Faslli,
si shumë nga ne që ngarkohemi e mbajmë konfe-
renca kundër zakoneve të vjetra, kur është fjala
për disa nga këto, ndryshe flet e ndryshe mendon.
Po e kishte kot Faslliu që mundonte veten me të
tilla pyetje e brengosje gjersa ai e dinte mirë se
këto nuk mund t'i bisedonte me njeri përveç se
me llogaritar Tosunin, që e pësoi si e pësoi. Shtren-
goi atëhere ballin me pëllëmbë të dorës sikur don-
te t'u vinte fre të gjitha atyre mendimeve që i
vinin rrotull nëpër kokë dhe, duke u munduar të
tregohej i qetë e i qeshur, iu kthye Festimes me zë
të urtë e dashamirës:

— Epo mirë, bijë e babait. Shumë mirë që
shpëtoi Bejkushi! Të rrojë e të gëzojë jetimi i var-
fër, se është i vetëm e pa njeri.

Festimja lëshoi mbi sergjen xhupin që mbante
krahëve dhe iu përvesh punëve të shtëpisë.

* * *

Në kanal zienin nga mëngjezi gjer në mbrëm-
je këngët dhe zhurma. Edhe puna shkonte kësaj
here më mirë se radhën e parë. Si vullnetarët e
thjeshtë, ashtu edhe drejtuesit e punimeve kishin
fituar një eksperiencë të mirë nga ata dy-tre muaj
punë të vjeshtës së shkuar. Përveç kësaj, Gëzimi,
gjithë dimrin, bashkë me çështjet e tjera të rinisë,
kishte ndjekur këmba-këmbës çështjet e hidrocent-
ralit që s'pakëshin qenë aq të lehta sa ishin dukur

në fillim. Turbina, për shembull, që do të arrinte në fshat «brenda pak kohëve», gjeti njëqind e një pengesa dhe vetëm një javë më parë mezi ishte nisur. Një ngatërrësë më e madhe kish dalë për punën e qyngjeve, se këto qenqeshin nga ai lloj materiali që përdoren vetëm për punët e mëdha të shtetit dhe nuk ish gjë e lehtë të merrje autorizim nga qeveria. Avaz pas avazi patëm edhe për ca çimento e shufra hekuri që ishin të domosdoshme, se edhe për ato u desh një thes me formalitete.

Kur e shikonte pisk ose kthehej nga avteti pa mbaruar punë, Gëzimi vinte e zbraste tërë dëshpërimin te ne, në fshat.

Faslliu, megjithëse e kuptonte shqetësimin e djaloshit dhe i jepte të drejtë, qeshte nën hundë e mundahej të shfaqësohej për qëndrimin e tij të dikurshëm në lidhje me hidrocentralin:

— E dija unë që do të kishte avaze kjo punë, prandaj nuk i hyja dot menjëherë.

Po Gëzimi nuk pajtohej me këtë mendje.

— Mos u justifiko, shoku kryetar. Qëndrimi yt nuk qe i drejtë. Dhe do të shohësh se si, me ca përpjekje të tjera, do t'i dalim medoemos në krye çështjes që kemi marrë përsipër. Është kala që duhet marrë kjo dhe kalaja pa luftë s'merret.

Dhe me të vërtetë Gëzim Pronjoja e mori kalanë. Herë me të lutur e herë me të kanosur, nuk la derë zyre pa shkelur e të njohur pa bezdisur gjersa i siguroi të gjitha ç'duheshin.

Gëzimi pati edhe ndihmën e Rizait, që ish i vendosur, njësoj si ai, ta shpinte punën gjer në fund dhe, si sekretar i organizatës, i kishte dyert

më të hapura se cilido nga ne edhe në komitetin e partisë.

Pati, patjetër, edhe ndihmën e kryetar Faslliut, ndonëse ky, kësaj radhe, u mor më pak me punët e aksionit. Jo se s'donte, por nuk ia dilte dot. Interesohej më shumë tani për mbjelljet e pranverës që s'prisnin. I kishte pjellë pastaj edhe me ca raporte e statistika që i kërkoheshin urgjent nga lart, aq sa atje e mbante mendjen edhe kur e sillte rrallëherë puna në kanal. Po mbi të gjitha Faslliun — sidoqë ai mendohej të mos e jepte veten — e brente shumë tani dhe e pengonte edhe në punë brenga e prishjes me Nexhip Ramizin. Në mbledhjen e organizatës ishte zotuar t'ia jepte vetë mandatën krushkut, por kishin kaluar ditë dhe ai s'e kish kryer dot zotimin. E kish shumë vështirë t'i dilte në sy, pa le t'i thoshte me gojën e tij: «Kaq e pati miqësia jonë, more shok...»

Tek mendonte këto, i mbetej cigarja në dorë dhe sytë i humbnin diku tutje. Shikonte si nëpër mjegull shkaktarin e gjithë kësaj fatkeqësie, Bejkushin, ashtu siç e kishte parë nëntorin e shkuar në kanal tek fluturonte me ato duar që i punonin si maqinë, gjë që i kish kujtuar kohën e djalërisë së tij kur edhe ai hante hekurin me dhëmbë. Sa fatkeqësi që gjithë ai mundim e ajo vuajtje i kishin shkuar për dhjamë qeni! Edhe atë të shkretë grua që pat marrë, nënën e Festimes, e kishte paguar me qimet e kokës, kish shitur kaun e vetëm dhe një copë arë nën ujë. Se ashtu ishte zakoni! Kurse Bejkushi...

Në aksionin e hidrocentralit s'kishte mbetur njeri pa dhënë ndihmën e tij. Gjer edhe kalamajtë e kooperativës s'i mbajti vendi. Ata vinin tufë-tufë me gjyma e kabashë xingoje në duar për të gostitur me ujë të ftohtë vullnetarët. Në mes të tyre do të shihje patjetër nënë Zelkën si një kllोकë të madhe, të murme, në mes të zogjve të vegjël.

Por ndihma që na zgjidhi një problem të madh, atë të materialeve që s'jepen pa vendim të qeverisë, i erdhi kooperativës andej nga s'ta merrte mendja; kjo ish ndihma që dha kryetarja e gruas, Mjaftimja. Nuk qe ndihmë me punë krahu si e re, të tjerëve, po me punë mendjeje që s'e bën dot kushdo. Na iu dha rasti Mjaftimes, aty nga mesi i prillit, të shkonte delegate në një mbledhje të madhe grash në Tiranë. Aty se si qëlloi e u takua me një nga shokët e udhëheqjes, dhe, kur ky e pyeti se si shkojnë punët në kooperativë, ajo s'e zgjati shumë fjalën për sukseset që kemi pasur, siç mund të bënte ndonjë tjetër në vend të saj, po u hodh shpejt e shpejt te puna e hidrocentralit dhe i çau hallin për të pesë copët qyngje që na mungonin, pa të cilat do të shkonin dëm gjithë ato sakrifica të rinisë. Udhëheqësi e dëgjoi me shumë vëmendje dhe më në fund e pyeti, me shaka sigurisht: «E ç'ju duhet juve hidrocentrali në majë të malit?» Mjaftimja e mori seriozisht pyetjen dhe ia numëroi një e nga një të gjitha të mirat e dritës elektrike. I përmendi bile edhe ato fjalët e njohura të Leninit për elektrifikimin që i kishte dëgjuar këtu dikur nga goja e instruktorit të partisë. Sho-

ku i udhëheqjes s'e kish mbajtur dot të qeshurit dhe aty për aty kish nxjerrë nga xhepi një defter të vockël e kish marrë shënim. Me kaq puna kish marrë fund. Nja pesë a gjashtë ditë më pas, komiteti ekzekutiv i rrethit, që s'na kishte mbaruar dot punë gjer atëhere, na njoftoi të shkonim e të tërhiqnim sasinë e qyngjeve që na duheshin.

Ja, kështu puna e Mjaftimes.

Sa për ndihmën time e të xha Alushit, s'më takon mua të flas. Do të them vetëm se ne vinim në kanal më shumë për sehir se sa për punë, tjetër që edhe punës nuk i shmangeshim kur na vinte mbarë.

* * *

Në një nga ato ditët e prillit, kur po i afrohej fundi hidrocentralit dhe rinia ish hedhur në sulm me të gjitha forcat, unë e xha Alushi ishim ulur e rrinim në një shullë aty më të dalë të fshatit, ku i kishim si në pëllëmbë të dorës si zonën e punimeve, ashtu edhe arat përtej përroit. Në një nga këto ara, që ne i quajmë akoma «arat e Alemit», se kështu u ka mbetur emri që nga koha e reformës agrare, dallohej një pendë qe, që tërhiqnin parmendën dhe, prapa parmendës, një burrë me kasketë e me pantallona kilota që ngiste pendën me një hosten të gjatë. Ai burrë ishte llogaritar Tosuni. Nxitohej të plotësonte sa më parë normën e ditës që të mund të ndihmonte pasdrekeve, siç kishte premtuar, në punimet e hidrocentralit.

Po mua e Alushit na hoqi vërejtjen më shumë një grup vullnetarësh, që kishin filluar një lloj tje-

tër pune te «Shkëmbi me hundë» dhe bëmë komentet tona pa u zgjatur. Hymë pastaj në muhabet për ngjarje e zakone të kohës së kaluar, që s'mbarojnë kurrë dhe s'kishim vënë re që punimet ishin ndaluar dhe asnjë njeri për bë s'dukej në tërë zonën e kanalit.

— Po kjo si shpjegohet? — pyeta xha Alushin.
— Më bëjnë mua sytë, apo vërtet kanë lënë punën të gjithë?

Xha Alushi s'arriti dot të më përgjegjej. Një krismë e fortë që tundi vendin gjer te ne, u dëgjua te «Shkëmbi me hundë». Pas saj, edhe një tjetër e një tjetër. Mbi shkëmb ngriheshin njëra pas tjetrës shtëllunga të zeza tymi që i shpërndante era më të katër anët, kurse lart maleve e shkëmbinjve, vazhdonte valë-valë uturima e rëndë e krismave.

— More, po ç'bëhet kështu? — i brita xha Alushit duke e mbërthyer fort për krahu.

— Minat, more! Nuk e kupton? — m'u përgjegj rëndë-rëndë plaku pa treguar asnjë farë shqetësimi. — Janë minat që do rregullojnë shkëmbin, — vazhdoi — kurse të rinjtë s'duken, se janë shtrirë në kanal për t'u mbrojtur nga copat e gurit që fluturojnë gjer dyqind metra larg.

Xha Alushi s'kishte mbaruar fjalën, kur u dëgjua një vërshëllimë e zgjatur bilbili dhe menjëherë pas saj, sikur doli papritur nga dheu, një buçimë thirrjesh e zërash të gëzuar që i afrohej asaj të minave dy minuta më parë. Të rinjtë, duke tundur në erë kazmat e lopatat, po lëshoheshin me vrap, disa që nga kanali, të tjerët nga prapa trunqeve të atyre pak gorricave që kanë shpëtuar pa

u prerë, ose nga gufa gurësh ku qenë fshehur, drejt e te «Shkëmbi me hundë».

Pas tyre u derdhëm edhe ne. Minat e kishin bërë punën e tyre si me porosi. Shkëmbi, që ish quajtur denbabaden «Shkëmbi me hundë» dhe që akoma sot e kësaj dite kështu e quajmë, kish mbetur shtyt.

— Kësaj i thonë punë! — thirri gjithë gëzim xha Alushi kur arritëm në vend dhe i përqafoi me radhë djemtë e vajzat që i kishin dalë aq mirë në krye kësaj detyre. — Ç'mbështetje, ë? Edhe e pje-rret aq sa duhet, edhe e fortë sa e ka shkuar e lënë çimenton.

Plaku kishte të drejtë të gëzohej e bile edhe të mburrej, se kish qenë ai vetë që propozoi këtë lloj mbështetje për koritën, duke kursyer kështu kushedi sa thasë çimento që do të ish dashur, sikur të ish vepruar ndryshe.

Arritën pas pak duke vrapuar edhe Rizai, Fas-lliu e Mjaftimja dhe që të tre i dhanë dorën më përpara xha Alushit, pastaj vullnetarëve që kishin punuar në shkëmb.

Pas ndonjë gjysmë ore, filloi përsëri uturima e kazmave e lopatave tejpërtej kanalit. Xha Alu-shit i zuri syri Bejkushin tek jepte e merrte me kazmë në dorë në krye të një skuadre që kish frontin më të vështirë, dhe u kthye nga unë:

— Kapedan djalë — tha — S'do të dijë fare nga gjithë ato që pësoi.

Bejkushi i kishte shpallur garë skuadrës së Festimes, që s'kish dashur të matej me të me që-llim që të mos e mundonte, po më në fund u de-tyrua të pranonte dhe gara u përhap edhe në skuadrat e tjera.

Në skuadrën e Festimes bënte pjesë edhe infermier Xhevahiri me dy nga bashkëfshatarët e tij. Ai s'kish shumë punë tani me të plagosur e të sëmurë dhe të gjitha fuqitë e tij i derdhi në punën e skuadrës, të thuash sikur ish i vendosur që garën ta fitonte domosdo Festimja.

— Forca, shokë! T'ia marrim flamurin atij qerratai — bënte shaka në sy të Festimes dhe i binte dheut me kazmë me sa fuqi që kish. Fjala ish për Bejkushin.

— E ke inat, ë? — pyeste me të tallur ndonjëri.

— Inat e kam, posi! — pohonte Xhevahiri gjoja serioz, duke i luajtur syrin Festimes.

— Të mos e futim garën në çështjet personale, shokë! — thërriste tjetri më tej, dhe vrehej në fytyrë, sikur e kish me gjithë mend.

Festimja i dëgjonte pa ngritur kokën. Herë-herë shikonte me bisht të syrit Xhevahirin dhe ndukte buzën, si të donte t'i thoshte:

— E shkele, më duket. Ka kufitë e saj edhe shakaja.

Pastaj, kur e shikonte që ai ia niste prapë avazit, pezullonte një hop punën, merrte drejtpëdrejtim dhe, duke shmangur me kurriz të dorës tufën e flokëve të saj që s'i kish shkurtuar prej kohësh dhe i mbulonin ballin, u kthehej të gjithëve me të qortuar:

— Do t'i lini këto muhabete, shokë? Jemi në garë pune këtu, s'jemi në garë fjalësh.

Mjaftonin këto dy fjalë dhe ai vështrimi i saj i hakërruar që shokët të ndërronin përnjëherësh bisedë.

— Forca, shokë! — e mbyllte shakanë Xhevahfri, dhe kazmat e lopatat ia nisin me tërsëllëm më të madhe.

* * *

Pothuaj pasdreke për pasdreke, si realizonte normën e ditës në punët e kooperativës, vinte për të punuar në kanal edhe Tosuni. Të gjithë habiteshin se si ky njeri, brenda vetëm 3-4 javëve në punë bujqësie, kishte ndërruar aqë shumë. Festimja, që e kishte urryer dikur, por edhe që i kish ardhur keq për të, ish porositur në mënyrë të veçantë nga Rizai e Gëzimi që ta kishte në kujdes dhe, jo vetëm ajo, por të gjithë të rinjtë silleshin mirë me të. Ajo i vinte re Tosunit, si në punë dhe në fjalë, dhe i bëhej qejfi që, në çdo gjë, ai mban-te një qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi që kish mbajtur dhjetë vjet me radhë sa që nëpunës. Punonte me gjithë zemër dhe, pak a shumë, njësoj si të rinjtë, sado që vinte i lodhur nga të lëruarit me pendë. Nuk u ankua kurrë për vendimin e kryesisë që të merrte parmendën në vend të penës së llogaritarit. Përkundrazi, linte nganjëherë të kuptohej se kjo fsh ilaç «për ata që harrojnë se nga kanë ardhur». Dhe këto nuk i thoshte sa për sy e faqe, se, për ashtu, Festimja ishte djalli vetë, të njeh nga sytë, po i thoshte me sinqeritet. Ish bërë më i kursyer në fjalë, po, kur fliste, thoshte gjëra me mend, të cilat vinin në kundërshtim me ato profkat që lëshonte dikur më të djathtë e më të mëngjër kundër rinisë.

Ditët e para në kanal qenë të sëkëlldisura për Tosunin. Ai priste që rinfa t'i hidhej për gryke dhe t'ia përplaste në fytyrë të gjitha ato mendime e fjalë të papeshuara që kish shprehur për të rinjtë e të rejat e fshatit. Po, kur e pa që s'ish kështu, mori pak e nga pak kurajë dhe u vu mbrë në udhë.

— Paskam qenë prapa dynjasë... — i shpëtoi njëherë fjala, padashur, tek bisedonte me Festimen.

— Pse? — bëri sikur s'kupto i ajo.

— Mos më pyet kot, Festë. Po hiq më përdita nga një dru, në më do të mirën. S'e paskam njohur rininë, jo...

Festimja ia dha gazit.

— Dëgjo, Tosun — iu kthye pastaj duke vrejtur pakëz vetullat. — Të flas edhe në emër të Rizait e të Gëzimit. Ti po jep prova se i ke kuptuar sinqerisht gabimet e tua dhe një e nga një po i ndreq. Kjo ka rëndësi. Në qoftë se vazhdon kështu, ne t'i kemi falur të gjitha.

Tosuni u prek. Desh ta falënderonte vajzën, por u ngatërrua në fjalë dhe tha tjetër për tjetër.

— Hidrocentrali — tha — s'është ngritur akoma, po mua ma futi që tani në kokë një copë nga drita e tij. Llogarite vetë se sa do përfitoj kur ai të ndrigojë edhe shtallën e lopëve.

Festimja nuk i dha rëndësi fjalës, po, kur i shkoi kjo fjalë në vesh Gëzimit, ai u habit dhe s'donte të besonte që një fjalë kaq të madhe ta kishte thënë Tosuni. Dhe shpjegoi kuptimin e thellë që kish kjo fjalë, domethënë që drita elektrike nuk ndricon vetëm shtëpitë, po edhe mendjen e njerëzve.

— Ç'thua ti, xha Alush? — pyeti më në fund plakun që u ndodh aty kur bisedohej për këtë çështje.

— Ç'të them? — ngriti supet xha Alushi. — Edhe unë dakord me ty jam për Tosunin. I trashë më është dukur. Po ja që «nga ferra e vogël del lepuri i madh» themi ne pleqtë.

Kapitulli VI

I dhënë natë e ditë pas punës me atë gëzim që pret babai martesën e djalit të vetëm, Nexhip Ramizit as që i kishte rënë ndër mend të pyeste veten se për ç'arësye vajtjet e ardhjet me familjen e Faslliut prej gati një viti kishin filluar të rralloheshin dhe tani në fund ishin prerë fare. Po, edhe sikur të ish kujtuar të pyeste, prapë s'kish pse t'i shkonte mendja për keq. Sigurisht që, ashtu si ai, edhe Faslli Guri kish tjetër hall tani, hallin e vajzës që do të nxirrte nga shtëpia dhe s'ua kishte ngenë të tjerave.

Dhe që si ajo rrufeja në mot të kthjellët për Nexhipin një cep fjale që i ra në vesh nga ato që ishin përhapur e kishin marrë dheun kohët e fundit edhe në fshatin e tij.

Në fillim ai s'desh të besonte. «Janë fjalë rruqësh e gojëkëqish që s'kanë punë tjetër veçse të shpifin e të ngatërrojnë njerëzit e ndershëm», tha me vete.

Po, si ndenji e u mendua nakëz, u bind se këtu duhej të kishte diçka të vërtetë. Si ishte e mundur që Faslliu s'ish bërë fare për i gjallë, të paktën me ndonjë të falë? Ai Faslli që, edhe kur

s'e linin punët të shihej vetë, dërgonte llogaritar Tosunin të pyeste? Nuk ish pa kuptim edhe çështja që Nexhipi i kish shkuar dy herë me radhë krushkut në shtëpi dhe nuk e kish gjetur. Kurse vajza, që ish ndodhur aty herën e dytë — ai kish dëgjuar zërin e saj tek ndillte pulat në kopshtin prapa shtëpisë — nuk i kish dalë fare në sy. Thellë-thellë, kjo ftohje e kish fillimin që nga ajo ditë kur u inaugurua, në fshatin e Faslliut, nisja e punimeve të hidrocentralit. Si që e mundur që Faslliu nuk erdhi fare gjithë atë ditë të takohej me krushkun? Lëre pastaj ta ftonte për drekë a për darkë, ose të paktën për një kafe, siç e kërkonte zakoni.

Dhe grihej përbrenda e vriste mendjen Nexhipi se ku e kishte burimin kjo e keqe. Mos kishte bërë as vetë, padashur, ndonjë gafë që t'i kishte qëndruar rëndë krushkut? Jo! Mos kish dalë nga familja e tij ndonjë fjalë e pamatur për Faslliun ose për të bijën? Prapë jo. E shoqja e kish aq në sevda sa edhe ai vetë si familjen ashtu edhe çupën e Faslliut. Sa për të birin, plakut s'i shkonte kurrë ndër mend që ai të mos ish i gëzuar për festesën e tij me një vajzë si Festimen, që e kishte në sevda gjithë bota. «Tjetër që është i turpshëm e nuk shfaqet dot. Këtë zakon e kishim të gjithë kur ishim të rinj», thoshte me mendjen e tij plaku.

«Çështja duhet shpjeguar me vetë të zotin e punës, Faslliunë, vendosi më në fund. Po prapë, sedra e një njeriu që mendon se është në të drejtën e tij, nuk e linte të bënte tutje. Unë s'i kam ndonjë faj. Pse t'i përulem?»

Mendja, megjithatë, s'i rrinte në një vend. «Cili të jetë ky njeri i ndyrë që hedh gurin e

fsheh dorën për të prishur dy familje të nderuara? Bëmë gjithë atë luftë dhe derdhëm gjithë atë djersë që njerëzit të mund të ndreqnin jetën e tyre, të jetonin si njerëz, të donin e të respektonin njëri-tjetrin, të mos detyroheshin t'i shtrinin dorën më të fuqishmit ose të bënë gjëra të ulëta për të siguruar bukën e gojës. Dhe kësaj ia arritëm me mundime të mëdha e me sakrifica. Secili e ka në dorë tani të rrojë si zot me djersën e tij. Përse të ketë të tillë malukatë që s'gëzojnë dot jetën pa hidhëruar jetën e të tjerëve?»

Iu kujtuan ato që kish lexuar para ca kohësh në një revistë nga tonat. «Ndërgjegja e njeriut, shkruante revista, s'është si ekonomia që mund të ndreqet vetëm me disa pesëvjeçarë. Për të ndrequr ndërgjegjen, koha nuk matet me vite, por me shekuj».

Aso kohe Nexhipi nuk ua kishte vënë veshin këtyre fjalëve, bile i kish marrë për ëndrra nga ato që hedhin në kartë disa shkrintarë, kurse tani po i mbushej mendja që këto ishin të vërteta. Por nuk pajtohej fare me ato që shkruante më poshtë revista se, namëta, në luftën për të ndrequr ndërgjegjen e njeriut, nuk hyka shumë në punë fuqia, domethënë shkopi, po të bindurit e njeriut me anën e fjalës.

«Ç'më fjalë, more! nevríkosej e shfrynte mbi njeriun që shkruante kështu. Ku dëgjon me fjalë nepërka? I duhet shtypur koka asaj, koka».

Kooperativistët, që e kishin mësuar çështjen dhe e merrnin me mend se ç'gjëmë ishte kjo për Nexhip Ramizin, i qanin hallin plakut me vete të tyre pa i hedhur atij asnjë fjalë dhe kaq e vërtetë ishte kjo, sa Nexhipi ishte i bindur se

fshati nuk dinte gjë. Kjo e ngushëllonte gjer në një farë shkalle, se, ndryshe është kur të tilla halle i di vetëm ti, i zoti, dhe ndryshe kur ato kanë marrë dheun. Zaten, Nexhipi aty e priste të keqen më të madhe, te thashethemet e njerëzve që do ta detyronin të mos u dilte më në sy.

Po «s'ka pyll pa derra» i thonë një fjale. Edhe në fshatin e Nexhipit u gjendën të tillë.

Fjala që ish hapur në fillim si me të drojtur, u trash e u ngatërrua nga gojët e këqija. Pati edhe ndonjë «gjarpër ndën gur», siç i quante Nexhip Ramizi njerëzit e thashethemeve, që shpifte nga koka lloj-lloj ndyrësish për vajzën e kryetarit tonë.

— Do të ketë bërë ndonjë proçkë ajo qyqe dhe i ati. që e di mirë se Nexhip Ramizi nuk pranon në shtëpi të tij nuse të tillë për djalin, prish fejesën përpara se Nexhipi të bëjë të tijën.

— Prit kur të pëlcasë sherri tani edhe midis dy kooperativave — ëndërronte ndonjë nga ata që s'i gjente rehat shpirti në punën kolektive. — Se ajo çupa e Faslli Gurit është shumë punëtore dhe kooperativës së saj nuk i intereson ta largojë nga gjiri.

Shtesat e shpifjet zinin vend nganjëherë edhe te njerëz të ndershëm. Këtyre u vinte keq për Nexhipin që ish një nga burrat më të nderuar të kooperativës dhe, me qëllim të mirë, shkëmbejnë ndonjë mendim midis tyre, po e kishin vështirë ta bisedonin çështjen me vetë të zotin e hallit. Dhe heshtnin, ndërsa gojët e liga vazhdonin punën e tyre.

Një nga këto thashetheme, që ish më e turpshmjia nga të gjitha, shkoi gjer në vesh të sekretar-

rit të partisë. Ky e dinte prej kohësh se si qëndronte çështja. Kishte biseduar, bile, me organizatën e rinisë dhe ajo kish marrë përsipër ta gjen-te fjalën me djalin e Nexhipit, Xhevahirin, të cilin e kish anëtar të saj, nga më të mirët. Xhevahiri, si i ri me mendimet e kohës, kishte ngrënë arësye dhe, jo vetëm që s'kish pasur ndonjë kundërshtim ta quante të prishur fejesën, po i kish dhënë fjalën organizatës se do të ndihmonte me gjithë zemër ish—të fejuarën e tij të realizonte dëshirën e saj. Dhe këtë premtim ai kish kohë që po e zbatonte. Vetëm se e kish pasur vështirë dhe prapë s'do të ishte i zoti t'ia thoshte vetë babait këto gjëra. Në këtë pikë Xhevahiri s'i paskësh lënë gjë Festimes.

— Ja themi ne! — u zotua përgjegjësi i rinisë.

Dhe me të vërtetë ia thanë. Përgjegjësi i rinisë me dy a tre shokë të organizatës që Nexhip Ramizi i njihte për djem të gjykuar e seriozë, i shkuan drejt e në shtëpi. Në krye të tyre ishte vetë sekretari i partisë si shok me autoritet të madh në gjithë kooperativistët dhe veçanërisht te Nexhipi.

E gjetën plakun tek jepte e merrte me punët e zakonshme të shtëpisë që dihej se kishin lidhje me përgatitjet e martesës së afërme të të birit dhe u erdhi keq që do t'i prishnin atë ëndërr të tij të bukur. Por ja që rrugë tjetër nuk kishte. «Me plagën që duhet operuar s'bëhet shaka», thoshte sekretari i partisë.

E hoqën Nexhipin mënjanë dhe ia thanë aty për aty të gjitha. Atij sa nuk i ra pika. I shikonte në sy me radhë me një vështrim habie

sikur nuk donte të besonte në ato që i thoshin dhe nuk hapte gojë, por herë pas here fshinte me kurrizin e dorës djersët që i mbulonin ballin.

Me fjalë të matura e të arësyeshme, shokët u përpoqën t'i mbushnin mendjen se jetojnë në të tjera kohë, se bashkë me kohën kanë ndryshuar edhe zakonet dhe se kjo që i ngjau atij me Faslli Gurin nuk ishte turp, siç mund të quhej një herë e një kohë, po një e drejtë e vajzës së Faslliut, e cila tani që u rrit ish në gjendje të gjykonte.

— Dhe gjykimi i saj tani që u rrit — hapi më në fund gojën e foli Nexhipi — qenka që familja ime dhe djali im s'janë të përshtatshëm për të. Marshalla i qoftë!

— Nuk është aty fjala, xha Nexhip — ia ktheu sekretari i partisë. — Fjala është te ndjenjat e vajzës, te ëndrrat e saj...

Plaku uli sytë e diç mërmëriti me vete. Nga damarët e ballit që i rrihnin dhe nga duart që s'i rrinin në një vend, dukej që ai s'pajtohej fare me mendimet e djemve. Përkundrazi, e quante këtë çështje si turpin më të madh që i bëhej familjes së tij dhe të gjithë urrejtjen dhe zemërimin e tij e kish më shumë te Faslli Guri se sa tek e bija.

Dëgjohej qartë herë pas here emri i Faslliut tek e përmendte me përbuzje e neveri.

— Faslli Guri është vetë i huaj në këtë çështje — desh ta qetësonte sekretari i partisë.

Nexhipi e vështroi me inat.

— Faslli Guri, thuaj, jo Faslli Guri!.. Një burrë që s'bën dot zap të bijën. Ja ç'na paska qenë zotëria e tij. Po fajet i ka edhe kjo kokë që...

Ai i ra kokës me grusht dhe diçka desh të

shtonte, po përgjegjësi i rinisë, që kishte heshtur gjer atëhere, ia preu fjalën:

— Na thuaj zotrote, atëhere, xha Nexhip, ç'qëndrim do të mbaje sikur ta kish bërë yt bir me vajzën e Fasllit atë që bëri ajo me tët bir?

— Do t'i këputja zverkun me duart e mia, këtë do të bëja! — u përgjegj me nervat të ngritura plaku duke mbledhur duart grusht dhe duke i rrotulluar sikur po i këpuste vërtet zverkun ndonjë zogu.

— Një fjalë goje! — qeshi përgjegjësi i rinisë.

— Ta këputnim ne ty më përpara — u nxitua e foli, i zemëruar, njëri nga dy të rinjtë e tjerë që kish shoqëri të veçantë me djalin e Nexhipit, Xhevahirin, dhe si gjithë rinia e kooperativës, mbante anën e këtij.

Nexhip Ramizi rrëshqeu sytë dhe ngriu në vend si ato statujat e gurta në mes të pjacës që shikojnë gjithnjë në një drejtim. Pastaj ngriti duart lart e, duke lëvizur me mundim buzët e thara, mezi arriti të thoshte:

— Ashtu, ë? Atëhere, është e kotë të bisedojmë. Ju bëni tuajën dhe unë timen.

Këto tha dhe u ngrit e iku duke i hedhur me zor këmbët që mezi e mbanin.

Sekretari i partisë i shkoi prapa.

* * *

Faslliu i mësoi shumë shpejt të gjitha ç'ishin thënë e biseduar me krushkun. Ata të kooperativës fqinjë kishin një organizim të mirë edhe për çësh-

tjet që s'kanë të bëjnë me ekonominë dhe kulturën. Si e gjetën, pas shumë përpjekjesh, fjalën me Nexhip Ramizin, që kish premtuar se do ta bënte zemrën gur e do t'i kalonte si t'i kalonte edhe ata pak vjet që i kishin mbetur, kishin thirrur Rıza Hodon tonë dhe kishin biseduar me të gjatë e gjerë.

Rizai këtë kish pritur që ta mbyllte një herë e mirë çështjen e fejesës së Festimes me kryetar Faslliun. Në fillim Faslliu e ndjeu veten ca si të lehtësuar që krushkut ia kishin dhënë të tjerët lajmin e hidhur dhe nuk ish më i detyruar t'ia jepte af vetë me gojën e tij. Po pastaj, kur i shohshiti mirë gjithë ato fjalë të rënda që kish nxjerrë nga goja krushku kundër tij, iu thye zemra dhe, për herë të parë, mendoi keq për të. «Budallail shau me vete. U dashka trazuar uji që të shohësh se ç'pislleqe ka përbrenda»...

Sipas tij, krushku kish të drejtë të pikëllohej për fatkeqësinë që i ra, (për këtë vetë Faslliu i kishte qarë hallin me vete kushedi sa herë) por ai s'duhej të arrinte gjer në atë shkallë sa të villote nga goja fjalë të atilla rrugaçësh që s'i kanë hije burrit plak.

«Fund i fundit, përpiquej ta nxirrte veten të larë Faslliu, ç'marrëzi bëra unë që të më quajë hu zotëria e tij? Marrëzinë që e kisha fjetur mendjen tek ime bijë, s'i vura veshin me kohë dhe s'u përpoqa ta ktheja nga udha që kish zënë? Bukur fort! Po ai, që na e quajtkë veten tani me një barrë mend, ç'bëri? Ku i kish sytë e veshët zotëria e tij kur i biri i bënte sehër së fejuarës tek vente e vinte me tjetrin, tek gajasej e fliste vesh në vesh me të, dhe, në vend që të merrte masa, u buzëqeshte e u hiqte kapelën? I kish te prega-

titjet për dasmën që do të bënte. Ja ku i kish veshët e sytë zotëria e tij. Domethënë edhe ai si baba, e kish fjetur mendjen tek i biri dhe nuk hapí një herë gojën e të pyeste se si i kishte punët ky djalë me të fejuarën. U kujtove vonë, zoti krushk! "Ha tani edhe zotrote nga gjella që gatuum bashkë dhe mos lih kot si qentë në hënë." //

Urrejtja e Faslliut sa vinte e shtohet dhe tani ai mendohej se si të gjente dobësi të tjera në jetën dhe në punën e krushkut. Le të thoshte ç'të donte, pastaj, Riza Hodoja, që e kishte porositur të mos i ngiste urët me të. Sipas Rizait, krushku, fund i fundit, nuk përfaqësonte në këtë grindje veçse veten e tij, kurse Faslliu ish edhe anëtar partie, edhe kryetar kooperatife, dhe si i tilë duhej të qëndronte larg zënkave e thashethemeve.

Rizai kishte të drejtë, po ec të shuajë zemërimin e Faslliut në ato fjalë të palyra të krushkut që e "gërryenin si me ksistër në shpirt." «Apo ka pak mëkate ai guak», shfrente me vete inatin e tij mbi krushkun Faslliu. Dhe, mëkati i parë që i kujtohej, mëkat që ai vetë s'do ta kishte bërë kurrën e kurrës, ish ai i të 10.000 lekëve para të thata që Nexhip Ramizi i kish paguar Tosunit për lajmësinë. Ish një vjeggë kjo, ku Faslliu mund të kapej fare mirë për ta nxjerrë veten shumë më të pafajshëm se krushku në çështjen e asaj së shkrete fejese.

Sidoqoftë kësaj pune tani i ish dhënë fund dhe Faslliut s'i mbetej tjetër veçse t'i shtrohej më me zell punës si kryetar të nderuar që e kish kooperatifa e tij, pa sa për Nexhip Ramizin, do t'i dilte domosdo rasti që t'ia dëftente vendin gjersa kështu i kërkonte mushka drutë. //

Ish më të ngrysur dhe ai sapo ish kthyer nga takimi me Rizain. Në shtëpi nuk ish ndezur as zjarri, as drita. Faslliut nuk i jepej fare për këto punë. Me këto merrej vetëm Festimja, po ajo s'ish kthyer akoma nga puna dhe Faslliu ishte ulur përpara derës, mbi një gur të gdhendur ku Festimja vinte zakonisht magjen kur lante plaçkat.

E kish humbur mendjen pas gjithë atyre që kish dëgjuar nga Rizai dhe s'po i zinte veshi një trokitje të lehtë në portën gjysmë të hapur të oborrit. E dëgjoi kur porta trokiti për të tretën herë, pak më fort; hodhi sytë andej dhe iu duk si e pabesuar kur pa në prak të portës nënë Zelkën që s'i kish shkelur kurrë në derë, me gjithë miqësinë e saj të ngushtë me Festimen.

E drojtur dhe e thyer, më shumë nga brengat se nga pleqëria, plaka kishte zgjatur gjysmën e trupit këtej portës dhe po priste.

Ç'e kish shtytur vallë plakën të vinte te kryetari? Eh! Ku ta dish? «Njeriu është një minierë, që nuk zbulohet lehtë», kish lexuar diku Faslliu.

U ngrit përnjëherësh dhe i doli plakës përpara:

— Urdhëro, nënë Zelka, urdhëro! Ç'e mirë të solli këtej?

Dhe, duke i zgjatur duart, e ndihmoi që të hynte në oborr.

Plakës i dridhej buza e s'po i bënte dot dy fjalë bashkë. E kishte prekur shumë kjo sjellje e kryetarit dhe, nga mallëngjimi, në vend që t'i shfaqte gëzimin e saj me fjalë, filloi të qante.

— Folë, moj, ç'ka ngjarë? — u shqetësua Faslliu dhe mendja i shkoi te ndonjë e keqe që mund t'i kish ndodhur së bijës.

Plaka fshiu lotët e mezi filloi të fliste.

— Jo, bir. S'ka ngjarë gjë prej gjëje. Po ja... si të të them? Diç më ka rënë në vesh për Festimen tënde dhe zotrote e di që unë...

Ajo s'e mbaroi dot fjalën dhe prapë u rrëmbush në lot.

— E di, e ke si çupën tënde — i dha kurajë Faslliu — dhe ajo të ka në vend të nënës.

Ai e mori plakën për krahu, e shpuri gjer te guri i lëvereve ku kish ndenjtur vetë pak më parë dhe e detyroi të ulej.

Plaka mori frymë:

— E di perëndia, bir. Ajo më nxjerr mallin e së mjerës vajzë. Dhe unë s'dua të më dalë shpirti pa e parë Festimen në fatin e saj.

— Do ta shohësh së shpejtë — i bëri qejfin Faslliu.

— Do ta shoh, po ka të parë e të parë — tha plaka. — Kam dëgjuar që zotrote...

Tjetër për tjetër nga ku kishin arritur punët, nënë Zelka kish mësuar vetëm një gjë, që Faslli Guri ose do ta martonte vajzën atje tek e kishte fejuar vetë, ose do të bënte gjëmën.

Faslliu nuk ia tregoi plakës të gjitha hollësitë e çështjes. I tha vetëm se nuk ishin të vërteta ato që kish mësuar ajo dhe se ai nuk do të vendoste asgjë pa marrë pëlqimin e vajzës, bile edhe të vetë nënë Zelkës.

Plakës i shkëlqyen sytë, i shtrëngoi dorën me të dy duart kryetarit dhe u largua me ballin lart e buzën në gaz si ajo Zelkë Lika e 30 e ca vjetve të shkuar.

Kapitulli VII

Gjer në mes të prillit fryu nja tri herë jugë e ranë ca shira, por ato qenë të buta, të thuash sa për të ruajtur vlagën e dheut dhe për të bërë të buisnin gjethet, barin e lulet. Kjo që si e porositur nga rinia, që diti ta shfrytëzonte kohën e mirë për të kapërcyer edhe parashikimet më të guximshme, sikundër, thoshte shpesh Gëzim Pronjoja. Më tri javë prill pothuajse kishin marrë fund të gjitha punimet, me përjashtim të ca vogëlimave që s'kërkonin as tri ditë punë. Ato ditë na kish ardhur nga komiteti ekzekutiv i rrethit edhe lajmi që të shkonim e të tërhiqim të pesë copët qyngje të hekurta, për të cilat ish interesuar Mjaf-timja në Tiranë. Nga ana tjetër edhe turbina e gjeneratori që na kishin shqetësuar muaj me radhë, ishin nisur e po vinin. S'na mbetej tjetër veçse të caktonim ditën e inaugurimit. U bisedua gjatë bile se ç'ditë do të bëhej inaugurimi. Disa mendonin që të bëhej më 9 Maj, ditën e fitores mbi fashizmin; të kësaj mendjeje ishim sidomos ne, brezi i luftës, por Gëzimi nguli këmbë për më shpejt. Më në fund u pranua me vota të përbashkëta dhe me duartrokitje propozimi i xha Alushit

e i traktorist Petraçit që dorëzimi dhe inaugurimi të bëheshin më 1 Maj, ditën e festës ndërkombëtare të klasës punëtore.

Një ditë e paharruar gëzimi përpara asaj të inaugurimit ishte dita kur arritën në fshat turбина, gjeneratori e qyngjet. E mbaj mend si taní, ish pasdreke, një pasdreke e butë prilli me atë qiell të bukur e me ato lule që kundërmonin erë. Në kanal kish pllakosur gjithë kooperativa për tu dhënë dorën e fundit punimeve. Ish fjala më tepër për spastrime e zbukurime. Mua më takoi të isha në një front me Bejkushin që më ish ngjitur shumë për zemre tani dhe kisha qejf të rrija me të, kurse Alushi e kish punën pak më poshtë me ata të kabinës së elektrikut që ish më të mbaruar. Pas ndonjë ore e ca Alushi la punën e më ftoi dhe mua që të dridhnim nga një cigare.

— Dale, se s'kam mbaruar punë — i thirra fort unë me qëllim që të më dëgjonte Bejkushi. Demek shihmë edhe ti, shoku Bejkush, se sa i disiplinuar jam në punë unë, Kalemí.

Po Bejkushit s'ia hedh dot. Është më shejtan nga Festimja ai në këto raste. Sillu si të duash përpara tij, ai t'i gjen të gjitha ç'ke në bark. Më shikoi ëmbël e tha:

— Lëri ato, xha Kalem. S'janë fjalët që dëshmojnë disiplinën e njeriut, po janë rezultatet e punës së tij.

Më zuri ngushtë dhe u detyrova t'i thosha të drejtën se ku e pata qëllimin që thirra aq fort.

Lashë pastaj kazmën e vrapova për tek Alushi që po më priste.

— Të gëzon zemra! — nisi muhabetin e tij të zakonshëm Alushi duke shikuar kanalën që

nxinte e gjarpëronte dredha-dredha nga përroi gjer në të hyrë të fshatit, si xhade automobili e asfaltuar. Bukuri të madhe i jepte sidomos gropa rrumbullake e rezervuarit e shtruar me pllaka të gurta, të ngjitura njëra me tjetrën me çimento nga ajo më e mira. Edhe «Shkëmbi me hundë», që kish ndërruar tani formë, me kabínën e elektrikut pranë, të bënte tjetër përshtypje. Nga kabina, tutje në drejtim të fshatit, vinin me radhë shtyllat e elektrikut me tel e me filxhanë të bardhë.

— Si mos të të gëzojë? — i dhashë të drejtë unë. — I ndërroi faqja fshatit fare... Dhe desha t'i përmendja të kaluarën e kësaj cope vend kur e mbulonin gorricat e shkëmbinjtë, po nuk arrita. Një grup shokësh, pesë a gjashtë veta, me Gëzim Pronjon në krye, po vinin ca si të nxituar nga fshati për në kanal.

Gëzimi kishte dy ditë që nuk shihej në fshat dhe ish e ditur që ai nuk largohej lehtë, veçse për punëra të rëndësishme.

— Ç'të ketë ndodhur? — pyeti plaku me sytë nga unë dhe u ngrit e bëri tutje.

Pas tij vrapova dhe unë.

Gëzimí, sa na pa që po nxitonim drejt tij, thirri:

— E rregulluam, xha Alush, e rregulluam!

— Çfarë rregulluat, more? — i ktheu plaku me tjetër çehre.

— Punën e turbinës e të qyngjeve, de. Gjë e vogël të duket? I suallëm me kamfon matanë fshatit, gjer aty ku është çarë xhadeja. Ja edhe shokët teknikë që kanë ardhur t'i montojnë.

Ai na njohu me ta një e nga një. Ishin pesë vetë, që të pesë të rinj, të veshur me tuta punëto-

ri. Dy prej tyre sillnin në krahë nga një vegël të rëndë, kurse të tjerët kishin vendosur rrjesht nëpër xhepat e mëdha të tutave lloj-lloj darash e pincash të vogla.

Xha Alushi u shtrëngoi duart me radhë dhe i përqafoi.

— Tani na duhen nja tridhjetë a dyzet veta nga më të fortët që t'i shkarkojmë dhe t'i sjellim gjer këtu — vazhdoi Gëzimi.

— Punë që ndreqet ajo — qeshi i gëzuar plaku pa ua shqitur sytë teknikëve, që sigurisht, i kujtonin të 35 vjetët e jetës së tij në minierë.

Pas dhjetë minutash një karvan i gjatë vullnetarësh u nis për te vendi ku kishin qëndruar kamionët me material. Shumica, sipas porosisë së Gëzimit, kishte marrë me vete litarë të trashë, dërrasa, qysqira dhe vegla të tjera që do të shërbenin për transportimin e materialit, bile edhe kazma e vare, të cilat për mendimin tim s'kish pse të hynin në punë. Në kanal, për të vazhduar punimet, kishin mbetur, me urdhër të Gëzimit, vetëm Festimja e Bejkushi me nja pesë skuadra.

Duke kaluar nëpërmes fshatit, Gëzimi me një grup të rinjsh që ishin në krye, ia morën këngës. Vura re xha Alushin që mundohej edhe ai të këndonte bashkë me rininë, po vetëm nëpër buzët, se nuk dinte as këngën, as fjalët e saj.

Fëmijë e pleq, si ata që u ndodhën në kanal me punë ashtu dhe të tjerë që s'di si kishin mbetur nëpër shtëpira, dolën të gjithë dhe vrapuan pas neve.

U desh të ndërhynin vetë Rizai e Faslliu në njërën anë e Gëzimi me tre-katër të rinj në tje-

trën, që njerëzit e tepërt të shpërndareshin, dhe të fillohej puna. Shkarkimi që e s'që i vështirë, po të mbarturit e materialit gjer te «Shkëmbi me hundë» s'tregohet dot me gojë. Turbina nuk ish vetëm turbinë, po sillte me vete edhe gjeneratorin që kish shkuar e lënë turbinën nga rëndësia. Dhe as turbina me gjeneratorin, as qyngjet veç e veç secilën, nuk i lëviznin dot nga vendi dhjetë njerëz bashkë. Le pastaj të mendoje që t'i ngreje në krahë.

Rruga gjer në fshat s'ish e gjatë, po ish mjaft e përpjetë dhe me shumë gurë e gropa. Kjo kish qenë edhe arsyeja që kishim ndërprerë, një vit më parë, punën e xhadesë. Që menduar në fillim që ajo të kalonte drejtpërdrejt nëpër këtë copë të përpjetë duke prerë kështu shumë shkurt, po pastaj u pa që kjo s'ish punë që bëhej. Sipas inxhinierëve, xhadeja s'mund të arrinte brenda në fshat veçse duke i ardhur rreth e rrotull një bregu me ca kthesa e dredha, që ne s'ua kishim ngenë hëpërhë. Dhe e lamë çështjen e xhadesë për herë tjetër. Kjo që gabim, sigurisht, po kush mendonte atëhere se do të na duhej kaq shpejt?

— Ja ç'do të thotë të mos i shikosh gjërat në perspektivë — thoshte Gëzimi.

Që pa mbaruar shkarkimi, një pjesë e vullnetarëve nisi të zgjeronte e të sillte në një farë te-
rezie atë copë rrugë, nëpër të cilën do të kalonin materialet. Pjesa tjetër u nda në aq skuadra sa ishin qyngjet me turbinën e gjeneratorin. Në këtë punë litarët luajtën rol të madh, se pa ato s'ish e mundur të ecej. Po, përveç litarëve, u përdorën edhe qysqitë, që i shtronin për së gjeri nën qyngje e turbinë, të cilat i tërhiqnin pastaj me

litar dhjetë ose njëzet veta bashkë. Edhe këtu, Gëzimi, sado që kullonte në djersë nga të lodhurit, s'përtoi të na përmendte përsëri atë dietarin e Greqisë së vjetër që kishte shpikur levën; bile, këtë radhë bëri edhe shaka duke na siguruar se ai nuk ka qenë monarko-fashist.

Isot dhe britmat e vullnetarëve që i jepnin kurajë njëri-tjetrit, dëgjoheshin gjer larg dhe ngritën në këmbë edhe ata të kanalit që, bashkë me Bejkushin e me Festimen, lanë punën e u vërsulën në ndihmë.

Në fillim, Gëzimit iu duk e tepërt kjo që bënte Bejkushi e Festimja me mendjen e tyre. Po pastaj e pa edhe ai vetë që s'i kish bërë mirë llogaritë. Shokët e shoqet që tërhiqnin qyngjet me litar mundoheshin aq shumë sa, pas shtatë a tetë hapave, duhej domosdo të çlodheshin e të fshinin djersët që u shkonin lumë. Sa i hynë sulmit Bejkushi e Festimja me skuadrat e tyre, puna filloi të ecte më mirë. Vala e isove, e përzier me thirrjet «ndal», «tërhiq», «uleni», «ngriheni», dalldisi me ushtimë të madhe dhe mua e xha Alushit, që na gjëmonte në vesh si thirrja «para, partizanë» e kohës së luftës, na u mbushën dy a tri herë sytë me lot. Edhe ne mundoheshim t'u jepnim nga një dorë të rinjve, po kjo ish sa për t'u bërë qejfin. Nganjëherë u prishnim edhe punë duke i mbajtur me muhabet,

Ja ku kishim përpara Xhevahirin, që na bëri të shkuleshim së qeshuri, se kish harruar të hiqte nga supi çantën me ilaçe, e cila e pengonte shumë kur tërhiqte litarin. Ai ngriti kokën e na shikoi i habitur dhe, vetëm kur e kuptoi se pse qeshnim, ia dha gazit bashkë me ne. Kaq e kish humbur

mendjen pas punës. Pakëz më tej Tosuni, zhveshur gjer në brez, dukej si ai kau i shëndoshë i parmendës tek tërhiqte me një fuqi që të habiste dy litarë bashkë nga ata të turbinës. Ne s'ia kishim njohur Tosunit këtë cilësi dhe ai na e shpjegoi se e paskësh fituar nga ushtrimet e shumta që kish bërë në tërheqjen e litarit në shkollë e në ushtri. Xha Alushi, nga kënaqësia, i harroi fare ato mosmarrëveshjet e vjetra me llogaritarin dhe, herë pas here, i zgjaste nga një cigare të dredhur, të cilën ia vinte në buzë dhe ia ndizte vetë ngaqë Tosuni s'donte të humbte kohë.

U ndamë nga Tosuni dhe po bënim tutje nëpër skuadrat e tjera. Kudo po ajo punë. Njerëzit sa s'thyheshin në mes duke tërhequr me sa fuqi që kishin gjithë atë farë hekuri; thirrjet e tyre dhe krisma e qyngjeve që rrëshqitnin përmbi qyngje të merrnin veshët. Një punë që s'të mbushej mendja t'i dilje mbanë.

Xha Alushi mbajti këmbët e më shikoi i menduar:

— Më duket se po rëndon më shumë bishti nga sqepari — tha.

— Pse? — u hodha unë.

— Paska qenë më e vështira e të gjitha punëve kjo e transportimit, që ne e quanim tabako për hundë.

Unë u bëra pak më të qeshur dhe shpura gishtin te buza.

— Shsht, se mos të dëgjon Gëzimi!

Tej-tëhu po vinte vërtet Gëzimi Rizain dhe ne e premë fjalën. Ata ishin nervozë me njerëzit e tepërt që, pa u parë, ishin derdhur përsëri nëpër këmbët e

me qëllim të mirë sigurisht, por që më shumë pengonin se ndihmonin.

— Respektoni rregullin, shokë! — thërriste Rizai. — Mos na detyroni të përdorim diktaturën e proletariatit. Le ta lëmë për armiqtë e klasës atë...

U desh ca që të vihej prapë rregull. Gëzimi e Rizai prapsën një pjesë të madhe të njerëzve duke lënë nëpër vende të caktuara vetëm ata që duheshin. S'i thamë gjysmë fjalë, po, përkundrazi, i rrahën krahët nënë Zelkës e tufës së kalamajve, që sillnin ujë.

Ish ngrysur dhe hëna sapo kish nxjerrë kokën majë malit. Megjithatë ish shpejt të thoshe se puna po mbaronte. Kishin mbetur edhe nja njëqind metra të mira që kolona të arrinte në fshat.

— Po pastaj? — pyeti xha Alushi.

E kish fjalën tek e përpjeta tjetër e udhës nga fshati gjer te «Shkëmbi me hundë», një e përpjetë më thikë se kjo që po kalonim.

— Pastaj vetëm Petraqi me traktor në bëftë punë — iu përgjegj pa kthyer kokën Rizai, që sapo kishte filluar t'i vinte në ndihmë skuadrës që tërhiqte gjeneratorin.

Petraqi, vërtet! Tani i ramë mendjes unë e xha Alushi që traktorist Petraqi s'ish parë fare gjithë atë pasdreke. Si ish e mundur?

— Do t'i ketë ndodhur ndonjë avari me traktorin dhe mundohet ta rregullojë — tha Rizai.

U dha shenja që të ndërrohej turni. U tërhoqën mënjanë, të lodhur e të dërsitur, ata që kishin punuar gjer tani dhe vendin e tyre e zunë të tjerë. Rizai, sikur këtë kish pritur, lëshoi litarin dhe iu drejtua Gëzimit:

— Sikur po e teprojmë — tha. — Shokët kanë punuar tërë ditën. Si mendon ti?

— Të vazhdojmë edhe ca — që i mendimit: Gëzimi. — Gjer aty ku fillon e përpjeta tjetër.

«Iso! Forca! Jepi!» oshëtinë edhe një copë herë thirrjet dhe kërcitën me tërsëllëm qysqitë nën peshën e rëndë të qyngjeve e të turbinës.

— Ndal! — thirri fort Rizai sapo qyngji i parë arriti aty ku fillon e përpjeta e madhe dhe i ra disa herë qyngjit me qysqi ashtu siç i bihet çangës.

Kolona u ndal dhe tërë ajo zhurmë që kish tundur dheun gjer atë minutë u shua përnjëherësh. Vullnetarët filluan të vishnin xhaketat osetrikot që i kishin hequr gjatë punës. Në dritën e hënës, që ish ngritur goxha sipër malit, llamisnin rrëke djerse mbi ballët dhe flokët e tyre.

— Ju marrsha të keqen, o djem! Ju marrsha të keqen, o vajza! — thërriste xha Alushi që ishte i bindur tani se edhe kësaj pune do t'i dillej në krye. Faslliu e shikonte me bisht të syrit dhe qeshte nën buzë si me pahir. Ja kish zili plakut atë natyrë gazmore dhe i vinte keq për vete që po e ngryste jetën me brenga e me mendime.

Në këto e sipër u dëgjua nga ana tjetër e fshatit një e gjëmuar motori që sa vinte rritej.

— Po vjen Petraqi me traktor! — thirri dikush.

Petraqi i kish futur traktorit marshin e fundit dhe arriti pas pak minutash. Shfrynte e shkroftënte nga inati që s'erdhi dot në kohë për të ndihmuar. I kish ndodhur tamam ashtu si kish menduar Rizai.

— Mos u mërzit! — e qetësof ky. — Të bie radha nesër ta tregosh trimërinë bashkë me këtë kapedanin tënd — dhe përkëdheli me një rën dorë traktorin, kurse me tjetrën i tregoi Petraqit të përpjetën thikë.

Kapitulli VIII

Erdhi edhe 1 Maji. «1 Maji i luleve, 1 Maji i kuq i punëtorisë», ashtu si e qendisin me ato fjalët e tyre të bukura vjershëtorët. Si e qendisur me rreze drite dhe me blerim ish vërtet ajo ditë. Në fshat ngrihemi zakonisht që me të aguar, bashkë me shpezët, po atë ditë s'mbeti njeri pa u ngritur që me yjet. Dy ditë më parë teknikët kishin vënë në provë hidrocentralin dhe e kishin gjetur në rregull, por provën e kishin bërë për vete të tyre, pa ne, fshatin. Ishte ndodhur aty vetëm Rizai, Faslliu e Gëzimí. Këta na i thanë përshtypjet e tyre, por ndryshe është me të thënë e ndryshe kur e sheh vetë me sy.

«Shkëmbi me hundë» dhe gjithë vendi rreth e rrotull ish stolitur me flamurë të vegjël, me lule, me parulla dhe me fotografi të udhëheqësve. Më e madhja në fotografitë ish ajo e shokut Enver me ngjyra, të cilën nuk di se nga e kishte sjellë Gëzimí.

Edhe tribuna që kishin ngritur qëllimisht të rinjtë në hije të rrapit pak më tej, tamam si ato tribunat e shesheve ku zhvillohen festat lokale, ish veshur me gjethe e me pëlhurë të kuqe, kurse anën

e përparme të saj e zbukuronin dy sixhade të mëdha me lule nga ato që punohen këtu në vend dhe disa qëndisje vajzash. Njoha sixhadenë e shoqes Mjaftime, që s'e kish nxjerrë ndonjëherë nga shtëpia dhe një qëndismë të Festimes. Në qëndismë dukej një grup vajzash tek hapte tokë të re duke shkukur nga rrënjët disa trungje pemësh të vjetra të prera prej kohësh dhe nën to lexoheshin fjalët:

*Me Enverin, me Partinë
socializmit do t'ia mbërrijmë.*

Sheshi ish mbushur që në mëngjez me njerëz, që s'kishin bisedë tjetër në gojë veçse atë të historisë së hidrocentralit si nisi e si mbaroi. Të vegjëlit, me ata zërat e tyre si cicërime e dallëndysheve që na fluturonin mbi kokë, ishin grumbulluar rreth e rrotull rezervuarit që ish mbushur gjer në grykë me ujë e që kaltëronte si liqen i vogël, dhe ishin gati të hidheshin me not, po nuk i linte roja, një pionier me uniformë dhe me një kordheltë të gjerë, flakë të kuqe, në njërin krah.

Prapa tribunës, në hijen e errët të rrapit, ca djem e vajza rregullonin tryezat, ku do të hanin drekë të ftuarit dhe vullnetarët. Drekën e kishin propozuar Rizai e Gëzimi, po shoku Faslli, që ish shumë i mërzhitur ato ditë, mezi kish dhënë aprovimin e tij si kryetar duke nxjerrë si arsye çështjen që me fondet e kooperativës nuk bëhet shaka. Pak më tej, bënte prova në fisarmonikë traktorist Petraqi me korin e të rinjve e të rejave, kurse, në anën tjetër të tribunës, në një vend që binte në sy, Xhevahiri me disa shokë nxitohej të

rregullonte një ekspozitë me fotografi nga jeta e kooperativës sonë. Ekspozita fillonte me ca kasolle të vjetra nga ato më të këqijat, që disa nga ne i kishin në vend të shtëpive gjer para çlirimit, dhe do të vinte gjer në ditët e sotme, por s'kishte mbaruar akoma.

Tutje e tëhu lëviznin kooperativistë të tjerë, gra e burra, dy nga dy ose grupe-grupe. Disa i vinin rrotull hidrocentralit dhe shfaqnin habinë e tyre se si ai do ta kthente ujin në dritë, të tjerë shikonin me kënaqësi rezervuarin që, pasi të ushqente hidrocentralin, do të ujiste edhe kopshtijt e fshatit, edhe ato arat nën fshat, që s'kishin parë ujë në jetën e tyre.

«Eh! Si do të rriten perimet e pemët frutore! Si do të nxijë mësri me katër a pesë masurë dhe si do të tërbohët fasulja!» thirra si i fantaksur unë. Xha Alushi që ma di sëmundjen më shikoi dhe qeshi:

— Tunde tani, qerrata, se të erdhi koha!

Ishim që ishim, vendosëm të bënim një shëtitje buzës së kanalit gjer në burim, domethënë te përroi. Këtë shëtitje, zaten, kishin filluar ta bënin edhe të tjerë më përpara, se dheun që ish bërë përg dikur buzës së kanalit e kishte shtruar e ngjeshur me tokmak rinia dhe ai ishte kthyer tani në një xhade, mbi të cilën ta kishte ënda të ecje. Më të dy anët e kanalit të rinjtë kishin mbjellë me kohë filiza plepash që ishin zënë dhe kishin çelur tani fletë të vockëla.

— Ja një punë me mend — tha xha Alushi.
— Pema e forcon shumë tokën. Sidomos në anën e sipërme të kanalit, plepat do të shërbejnë edhe

sí prítë për zallin e gurët që zbresin në kohë shirash nga rrëza e shkëmbit.

U kthyem në sheshin e festës tamam në kohë. Sheshi ish mbushur plot dhe njerëzit ishin në lëvizje të madhe. Grupit të korit me fisarmonikën e Petraçit në mes s'ia priste kënga këngën. Po vinte kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, i shoqëruar nga Gëzimi dhe nga shokët kryesorë të kooperativës.

Prapa tyre vënia duke qeshur e biseduar të ftuarit nga kooperativat fqinje, në mes të tyre edhe babai i Xhevahirit, Nexhip Ramizi, që, ndryshe nga të tjerët, rrinte me kokën ulur dhe s'kish më atë fytyrën e qeshur të një viti më parë.

Duke hipur në tribunë, Gëzimi na bëri shenjë mua e Alushit që të ngjiteshim. Na u bë qejfi shumë, e para, se kjo tregonte respektin që kanë të rinjtë për ne, pleqtë, dhe e dyta, se aty do të gjenim rastin të shkëmbenim ndonjë fjalë me kryetarin e komitetit, që vizitonte për herë të parë fshatin tonë. Po kësaj nuk ia dolëm dot. Aty kishte aq shumë të ftuar e të deleguar sa s'të vinte raddha, jo të flisnje, po as të takoheshe me kryetarin. Dhe mirë kishin bërë që kishin ftuar pothuaj gjithë fshatin, se të gjithë kishin punuar. Ja ku kishim pranë, për shembull, nënë Zelkën. Pse të mos ftohej e gjora? Ajo ishte dërmuar në aksionin e hidrocentralit. Dhe e bëri këtë, jo se priste për vetë ndonjë të mirë nga hidrocentrali. As që i mbushesh mendja plakës se si mund të kthehej uji në dritë. Po e bëri vetëm e vetëm për të kënaqur rininë ose, më mirë të themi, Festimen e Faslliut. Jo vetëm kaq, po qe e vetmja që bëri një gjë që

s'na kish shkuar ndër mend ne, të tjerëve: Sa i thanë që ishte e ftuar për drekë në inaugurimin e hidrocentralit, veçoi një rën nga të tri pulat që kish dhe ia dërgoi kryesisë së kooperativës, si dhu-ratë qe fjala, po qëllimi i saj ish që të lehtësonte kooperativën në shpenzimet e festës.

Ashtu si vitin e kaluar, kur do të fillonin punimet e hidrocentralit, edhe tani në inaugurimin e tij, fjalimin e mbajti Gëzimi. Pas tij përshëndeti me pak fjalë, po të goditura, kryetari i komitetit ekzekutiv, që e çmoi kooperativën tonë si një nga kooperativat malore më të përparuara të rrethit. Më në fund, në emër të vullnetarëve fqinjë, mbajti një fjalim të bukur Xhevahir Ramizi.

Që të tre nuk lanë pa përmendur, me fjalët më të mira, interesimin dhe kujdesin e madh që kishte treguar në këtë aksion historik kryetari i kooperativës sonë, Fasllë Guri.

Kjo i gëzoi të gjithë, po në mënyrë të veçantë na gëzoi ne, vërsnikët e Fasllit, që jemi rritur me të dhe kemi hequr së bashku, një jetë të tërë, të mira e të këqija.

Mirëpo, kur hodhëm sytë nga Faslliu me qëllim që ai të na shikonte dhe ne t'i jepnim nga larg nga një të puthur me shenja, vumë re që ai s'e kishte fare mendjen aty. Përkundrazi, të jepte përshtypjen e njeriut që është në hall të madh e s'di se nga t'ja mbajë. Mbante kokën mënjanë dhe sytë i kish të mbyllur përgjysmë sikur druhej të shikohej me njerëzit.

Që nga larg i shquhej një damar i ballit tek i rrihte me teftik.

— S'më pëlqen kjo punë — i thashë në vesh xha Alushit. — Mos na bëjë ndonjë sherr me krushkun kryetari dhe atëhere na rroftë gazi.

— S'është e mundur — mërmëriti plaku. Veçse të ketë shkalluar nga mendja.

— Mirë thua ti, po...

Xha Alushi pa shokët e tjerë që po drejtoshin nga ekspozita e fotografive që kish rregulluar Xhevahiri pak më parë dhe s'më la të vazhdoja fjalën.

U nisëm edhe ne pas të tjerëve.

Në mes të dhjetë a pesëmbëdhjetë fotografive që kish gjithsej ekspozita, shquheshin mirë vetëm dy më të mëdhatë: njëra ish ajo e Festimes me Bejkushin që ish botuar vitin e kaluar në gazetë; tjetra, ballë për ballë me të parën, ish e Xhevahirit që qeshte dhe shikonte nga ata të dy, sikur po u uronte fejesën.

— Sikur e paska bërë me qëllim qerratai — mendova unë dhe i rashë lehtë me bërryl xha Alushit.

Fotografitë duhej të kishin tërhequr edhe vërejtjen e të tjerëve që shikonin më dendur andej dhe veçanërisht të Faslliut me krushkun që nxinin që të dy në fytyrë dhe s'këmbenin asnjë fjalë, sado që nja dy herë u takoi të ishin fare pranë njeri-tjetrit.

Sa mbaruam së vizituar ekspozitën, filloi një lëvizje tjetër. Gëzimi kishte kërkuar nga kryetari i komitetit ekzekutiv që ky të priste shiritin e hi-

drocentralit. Shkuam pas tyre të gjithë dhe, pas nesh, populli që mbushte sheshin.

Kryetari u drejtua për te hidrosentrali, mori gërshërët dhe, duke thirrur midis duartrokitjeve të forta: «E trashëgoqshim për jetë!», preu shfiritin. Atë çast, dy nga teknikët, që ishin vendosur njëri lart te gryka e rezervuarit e tjetri poshtë te kabina, diçka lëvizën. Në minutë turbina e gjeneratorit filluan të rrotulloheshin me zhuvmë dhe uji që derdhej me teftik përpiqej e ngrihej si i ndërkryer në një mal shkumësh të bardha që lëshoheshin tutje me rrëmuje.

Unë e Alushi e kishim humbur fare mendjen pas kësaj çudie dhe s'po shihnim ç'bëhej rreth e rrotull nesh. Dëgjuam vetëm një si bubullimë të madhe duartrokitjesh e thirrjesh «Parti-Enver» që na bëri të lëviznim nga vendi. Pamë atëhere të rinjtë që i hidheshin njëri-tjetrit për qafe, tërë gaz e britma urimesh, ndërsa traktorist Pe-traqi po e tërbonte fare fisarmonikën dhe kori i vajzave e i djemve ia kish filluar një kënge të re që kish ngritur Bejkushi atë ditë dhe që ne e dëgjonim për herë të parë:

*Lumthi ne për këtë ditë,
fshati ynë u bë me dritë...*

Njerëzit, sheshi, tribuna dhe gjithë gjërat që na rrethonin, edhe pse ishin në hije, kishin marrë ngjyrë tjetër, të feksur si nga rreze të forta dielli. Vetëm atëhere unë e xha Alushi e kuptuam se ç'kish ndodhur, ishin ndezur llambat elektrike që, si diej të vegjël njëri pas tjetrit çanin e ndritnin në drejtim të fshatit.

Ndonjë gjysmë ore më pas, në hijen e dendur të rrapit ku ndriçonin tani shumë llamba elektrike me ngjyra lloj-lloj të varura aty-këtu nëpër dega, ishim shtruar e hanim drekën.

Në krye të tryezës kishin zënë vend, si zakonisht, kryetari i komitetit me udhëheqjen e kooperativës dhe me teknikët e mysafirët e ftuar. Faslli Gurit i kish takuar të rrinte gju më gju me krushkun, po akoma s'kish këmbyer fjalë me të. Dukej që ish mjaft i turbulluar dhe, për të humbur gjurmët, herë pas here kthehej nga Rizai që e kish më të djathtë dhe i bënte ndonjë pyetje.

Në një radhë me autoritete e mysafirë, rrinte edhe nënë Zelka, që kish lënë mendjen pas dritave me ngjyra, kurse, menjëherë pas tryezës kryesore, vinte ajo e vullnetarëve të dalluar. Festimja e Bejkushit rrinin pranë njëri-tjetrit njësoj si në atë fotografinë e ekspozitës. Dy karrige më këtej zinte vend Xhevahiri. Tutje nga mesi kishte zënë një karrige edhe llogaritar Tosuni.

Si u ngritën shëndetet e para dhe u shkëmbyen ca fjalime, këtë radhë shumë të shkurtëra, traktorist Petraqi me korin dhanë një program me këngë të ndryshme. Pas këtij programi, të rinjë të reja kooperativistë, grupe-grupe, ua filluan këngëve sipas qejfit.

Ne të tryezës së parë ia pleksëm muhabetit me njëri-tjetrin, përveç krushkut e Faslliut, që rrinin të dy si mbi gjemba. Kjo ra në sy të shumicës nga ne, po më tepër ra në sy të Festimes, që, bënte, ç'bënte, kthente ndonjëherë kryet me marifet nga

pleqtë dhe shikonte. Kuptohej që diç e brente përbrenda, megjithëse qeshte e këndonte bashkë me të tjerët.

Papritur, ra një farë heshtje. Festimja, sikur këtë rast kishte përgjuar, ua bëri me shenjë shokëve e shoqeve që kishte përreth dhe ia mori këngës vendshe:

*Vajz' e nënës moj,
e bukurë je,
ditën e diel, pasdreke,
vajte komuné...*

Kënga, në fillim e shtruar, shkoi duke u ngritur dhe përngjante aq shumë në avazin e asaj zambares kur ia merr me të qarë, sa nuk mbeti njeri pa u prekur. Dhe nuk ish vetëm avazi, po ishin edhe fjalët që të mallëngjenin. Me gojën kyçur e me kryet zgjatur për të dëgjuar mirë fjalët, shumica e njerëzve që s'e kishte dëgjuar ndonjëherë këtë këngë, ia kishin mbërthyer sytë Festimes. Verdhur e vrejtur në fytyrë, sikur nuk ish më Festimja gazmore e disa minutave më parë, ajo ia hidhte këngës me të dredhura që të rrëqethnin:

*Të pyeti kryetari.
«Nuk e dua» the...*

Kur priste ajo këngën, dëgjohej më qartë, si gurgullima e ujit nëpër gurë, zëri i Bejkushit, që ia kthente, dhe isoja e të tjerëve që ia mbanin.

Festimja vazhdoi:

*Vrave veten edhe burrin,
kryetarin tre...*

Fjalët e fundit u pasuan nga një iso e fortë, e zgjatur, e dhjetëra të rinjve që ishin grumbulluar ca nga ca rreth Festimes.

«S'është këngë për sot kjo, mendova unë. Bëri gabim Festimja». Po xha Alushi ishte i tjetër mendje:

— Ka qëllimet e saj ajo, mos u mërzit — tha, pa ia hequr sytë vajzës.

Kënga u pre përnjëherësh dhe, ashtu si ngjet zakonisht pas këngësh të këtilla, njerëzit mbetën një copë herë si të shurdhër, të heshtur e të mendumar.

Gézimi u mat t'i thoshte diçka kryetarit të komitetit, ndoshta për t'i shpjeguar historinë e këngës që bëri aq shumë përshtypje, por atë çast, nga fundi i tryezës sonë, u dëgjua një psherëtimë e thellë dhe ca të ngashëryera si të një njeriu që ndjen nevojë të qajë fort, po nuk e lënë rrethanat.

Të gjithë kthyem sytë andej dhe pamë nënë Zelkën tek i dridhej buza e i pikonin lotët si breshër nëpër faqet e saj të ffishkura.

— Ç'është? Ç'pati? — pyeti i pikëlluar kryetari i komitetit dhe u ngrit t'i shkonte plakës pranë.

Në të gjitha tryezat filluan komentet e pëshpëritjet me zë të ulët. Vetëm Faslliu heshte dhe s'i ngrinte sytë nga pjata e paprekur që kish përpara. Pranë tij krushku ish ngritur me këmbë e dëgjonte me vëmendje historinë e këngës që po i shpjegonte Gézimi kryetarit të komitetit.

— Ngjarja ka ndodhur në fshatin tonë që në kohën e mbret Zogollit. Vajza, për të cilën bën fjalë kënga, ishte vajza e vetme e nënë Zelkës... Thonë se ish vajza më e bukur e fshatit, po nuk pati fatin siç pati bukurinë. Siç thotë edhe vetë kënga, ajo vrau burrin që desh t'i jepte e ëma dhe kryetarin e komunës që mbronte me forcë këtë zakon barbar. Vrau më në fund edhe veten... Fjalët e këngës janë po ato fjalë, me të cilat nënë Zelka, e penduar, e qau të bijën 30 vjet më parë kur ndodhi tragjedia.

Fjalët e Gëzimit i dëgjuan edhe të tjerë. Pëshpërtjtet, pak nga pak, kishin pushuar fare. Kryetari i komitetit dhe krushku ishin ulur. Edhe nënë Zelka ishte qetësuar tani dhe po fshinte lotët me cep të shamisë.

Në mes të heshtjes që pllakosi përsëri, Nexhip Ramizi lëvizti karrigen nga vendi, brofi në këmbë dhe, me një gotë raki në dorë, të mbushur plot, iu kthye Faslliut:

— Ngrei sytë, shoku Fasli Guri, dhe vështromë drejt! Ta pimë këtë shëndet për çiftin e ri që kemi kundrejt. për Festimen tënde me Bejkush Alemin, të cilin e ka zgjedhur ajo vetë. Ktheje!

Me fund! Të na rrojë sa malet Partia, që futi dritë edhe në mendjet tona!..

Nexhip Ramizi s'kishte mbaruar mirë fjalën. kur shpërthyen si breshër i rrëmbyer tej e përkëtej duartrokitjet e të thirrurat që vazhduan me minuta të tëra.

Me duar që i dridheshin nga mallëngjimi, po me syrin të çelur, i çliruar nga ajo brengë e madhe që i rëndonte prej kohësh në kraharor, Fasli Guri e ktheu gotën me fund. Ashtu i kthyem edhe ne

me fund, po më përpara nga të gjithë e ktheu Xhevahiri, që shkoi e përpoqi gotën edhe me Festimen e Bejkushin.

Ua nisëm pastaj, herë grupe-grupe e herë të gjithë bashkë, këngëve e valleve më të bukura dhe më gazmore që d'nim. Dhe kjo vazhdoi gjer afër darkës

Kur u shpërndamë, dielli nuk dukej më, por punën e tij vazhdonin ta bënin tani dritat elektrike.

EPILOG

Ngjarjet që ju tregova, siç e thashë që në fillim, janë të tre-katër vjetve të shkuar. Kurse do të më duhej një tregim tjetër më i gjatë sikur të merresha me ato që kanë ndodhur sidomos në këta dy vjetët e fundit, gjë që s'e bëj dot hëpërhë.

Do t'ju them vetëm se kooperativa jonë s'është më e veçuar si atëhere, por e shkrirë në kooperativën e përbashkët të katër fshatrave, ku shoku F'slli zë vendin e nderuar të nënkryetarit. Përparimet e mëdha të fshatit tonë në gjirin e kooperativës së bashkuar, provuan edhe një herë të vërtetën e asaj fjalës së njohur popullore që thotë se bashkimi bën fuqinë. Që ta themi shqip, kemi ecur përpara si rinia «me hapa vigane». Tjetër që s'jemi të kënaqur me kaq, se u mësuan me të mira dhe të mirat nuk paskan fund.

Nuk po ju jap hollësira për veprat e reja që kemi ndërtuar. Do të dëshiroja që të vinit vetë t'i shikonit, qoftë edhe vetëm për një ditë a dy, si turistë. Nuk do ta ndjenit udhën, se tani automobili, një autobus nga ata fringot me 45 vende, vjen gjer brenda në fshat, te sheshi përpara vatrës së kulturës që kemi rindërtuar nga themeli dhe me

të cilën kemi të drejtë të mburremi. Do t'ju presëm me gjithë zemër dhe do t'ju gostisim sipas zakonit të vjetër, me gjërat më të reja: raki rrushi nga ajo që prodhon tani me bollëk punishtja jonë e re, fruta nga bloku i pemëve që kam selitur unë me brigadën time dhe mjaltë zoge në hoje, që do ta zgjedhim, si për mysafirë, në njëqind e ca zgjoje moderne.

Më vjen keq vetëm për një gjë. S'do të dëgjoni dot këngët e bilbilave e të thëllëzave që i keni aq qejf ju, qytetarët. S'do t'i dëgjoni, se nuk do t'ju lënë dyzet e ca radiot e fshatit që i mbajnë hapur nga mëngjezi gjer në mbrëmje.

FUND

Maj-Gusht 1969

1947-1948
1949-1950
1951-1952
1953-1954
1955-1956
1957-1958
1959-1960
1961-1962
1963-1964
1965-1966
1967-1968
1969-1970
1971-1972
1973-1974
1975-1976
1977-1978
1979-1980
1981-1982
1983-1984
1985-1986
1987-1988
1989-1990
1991-1992
1993-1994
1995-1996
1997-1998
1999-2000
2001-2002
2003-2004
2005-2006
2007-2008
2009-2010
2011-2012
2013-2014
2015-2016
2017-2018
2019-2020
2021-2022
2023-2024
2025-2026
2027-2028
2029-2030
2031-2032
2033-2034
2035-2036
2037-2038
2039-2040
2041-2042
2043-2044
2045-2046
2047-2048
2049-2050
2051-2052
2053-2054
2055-2056
2057-2058
2059-2060
2061-2062
2063-2064
2065-2066
2067-2068
2069-2070
2071-2072
2073-2074
2075-2076
2077-2078
2079-2080
2081-2082
2083-2084
2085-2086
2087-2088
2089-2090
2091-2092
2093-2094
2095-2096
2097-2098
2099-2100

1947-1948
1949-1950
1951-1952
1953-1954
1955-1956
1957-1958
1959-1960
1961-1962
1963-1964
1965-1966
1967-1968
1969-1970
1971-1972
1973-1974
1975-1976
1977-1978
1979-1980
1981-1982
1983-1984
1985-1986
1987-1988
1989-1990
1991-1992
1993-1994
1995-1996
1997-1998
1999-2000
2001-2002
2003-2004
2005-2006
2007-2008
2009-2010
2011-2012
2013-2014
2015-2016
2017-2018
2019-2020
2021-2022
2023-2024
2025-2026
2027-2028
2029-2030
2031-2032
2033-2034
2035-2036
2037-2038
2039-2040
2041-2042
2043-2044
2045-2046
2047-2048
2049-2050
2051-2052
2053-2054
2055-2056
2057-2058
2059-2060
2061-2062
2063-2064
2065-2066
2067-2068
2069-2070
2071-2072
2073-2074
2075-2076
2077-2078
2079-2080
2081-2082
2083-2084
2085-2086
2087-2088
2089-2090
2091-2092
2093-2094
2095-2096
2097-2098
2099-2100